



European
Union
Kosovo

ANALIZA E NEVOJAVE PËR KAPACITETET E QENDRAVE PËR PUNË SOCIALE NË KOSOVË NË FUSHËN E PROMOVIMIT DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE



SOS FSHATRA TË
FËMIJËVE
KOSOVË



HANDIKOS
SHOQATA E PARAPLEGJINËVË DHE E PARALIZËS SË FËMIJËVE TË KOSOVËS
ASSOCIATION OF PARAPLEGICS AND PARALYSED CHILDREN OF KOSOVO

Tetor 2020

ANALIZA E NEVOJAVE
PËR KAPACITETET E QENDRAVE PËR PUNË SOCIALE NË KOSOVË
NË FUSHËN E PROMOVIMIT DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Projekti: “Avancimi i kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve”

Projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë. Implementuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në partneritet me HANDIKOS

Tetor 2020

Hulumtuesit:

Petrit Sopjani

Slavica Milojevic

Prof. Lulzim Dragidella

Analiza teknike e mbështetur nga:

Diadora Cermjani

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë dhe nuk i paraqet domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Ju lutemi të citoni si:

Analiza e Nevojave për Kapacitetet e Qendrave për Punë Sociale në Kosovë në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë – Hulimtim (2020), Prishtinë.

Kontaktet:

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Rr. 1 Tetori, Velania, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Email: info@soskosova.org

Tel: +383 (0) 38 749 887

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtesat	
1. Përmbledhje ekzekutive.....	06
2. Hyrje.....	15
3. Metodologjia.....	16
Mostra.....	16
Burimet e të dhënave.....	16
Kufizimet.....	17
Konsideratat etike.....	17
4. Ligjet dhe analiza institucionale.....	18
5. Statistikat dhe analiza e Pyetësorëve me drejtorët e QPS-ve.....	27
6. Intervistat me drejtorët komunal për mirëqenie sociale.....	38
7. Diskutimet e grupit të fokusit.....	41
8. Intervistat me familjet e fëmijëve që marrin shërbime sociale.....	46
9. Konkluzionet.....	47
10. Rekomandimet.....	50
11. Shtojcat:.....	52
<i>Lista e të intervistuarve</i>	
<i>Shabllonet e intervistave.....</i>	<i>53</i>
<i>Organet qeveritare të cilat veprojnë në ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.....</i>	<i>69</i>
<i>Lista e Referencave.....</i>	<i>72</i>

SHKURTESAT

SMBSh	Skemat e Mbështetjes të Bazuara në Shtete
OShC	Organizata e Shoqërisë Civile
QPS	Qendra për Punë Sociale
DShMS	Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale
DMS	Drejtoria për Mirëqenie Sociale
IEDDNj	Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
HANDIKOS	Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KOMFK	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë
MASh	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum Mirëkuptimi
OJQ	Organizata Joqeveritare
OFPKP	Organizata për fëmijët pa kujdes prindëror
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SC	Save the Children Kosovë
SFFK	SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
ZShS	Zyrtar për Shërbime Sociale
TMR	Tryeza të Rrumbullakta Multidisiplinare për Mbështetje në Menaxhimin e Rasteve
UNCRC	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Historiku i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Kosovë

Si një nga akterët kryesor dhe përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen¹ e Fëmijëve, Qendra për Punë Sociale (më tej QPS) është mandatuara si organ kryesor i autoriteteve komunale për të ofruar kujdes social, mbrojtje sociale dhe këshillim në rrethanat kur një fëmijë ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare. Janë 40 QPS në Kosovë, të mandatuara gjithashtu për të koordinuar dhe organizuar sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijëve brenda komunës. Pozicioni i QPS-ve, siç ceket në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, kërkon kapacitete të fuqishme profesionale dhe organizative të QPS-ve për të marrë sipër pozitën që iu është dhënë atyre në mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijëve.

Kjo analizë mbi nevojat dhe kapacitetet e QPS-ve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve është pjesë e projektit «Avancimi i kapacitetit për të drejtat e fëmijëve», financuar nga Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut - Skemat Mbështetëse të Bazuar në Shtete - SMBSH dhe zbatuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në partneritet me HANDIKOS-in - Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është që të kontribuojë drejt fuqizimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në shërbimet sociale dhe Organizatat e Shoqërisë Civile të cilat ofrojnë shërbime për fëmijë.

Objektivi i përgjithshëm i hulumtimit ishte mbledhja e informatave dhe të dhënave përkatëse, praktike të mira dhe sfidave që do të "kontribuonin në fuqizimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shërbimet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët".

Metodologjia

Metodologjia e aplikuar për këtë analizë përfshin një qasje të kombinuar të metodave për t'i përfshirë instrumentet e zhvilluara. Hulumtimi është ndarë në tri metoda të ndërlidhura kërkimore: (a) analiza e shqyrtimit të dokumenteve, (b) mbledhja e të dhënave sasiore, bazuar në Pyetëtorin e hartuar për këtë qëllim, dhe (c) analiza cilësore e të dhënave, përfshirë diskutimet të Fokus grupeve dhe intervistat gjysmë të strukturuar me ofruesit e shërbimeve, përfaqësuesit e Drejtorive Komunale dhe me përdoruesit e shërbimeve (fëmijët dhe familjet e tyre).

Baza ligjore që do të mbështesë këtë hulumtim do të jetë në përputhje me Ligjin mbi Mbrojtjen e Fëmijëve 06/L-084, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023, si dhe Planin e Veprimit, Programin për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe gjithashtu duke iu referuar ligjeve të tjera të cilat i përcaktojnë kompetencat e QPS-ve, si Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji për Familjen, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

¹ LIGJI NR. 06/L-084 Mbi mbrojtjen e fëmijëve. GAZETA ZYRTARE E KOSOVËS/Nr. 14/17 KORRIK 2019, PRISHTINË. I disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Kufizimet

Situata e pandemisë COVID 19 ka ndikuar në shqyrtimin e mundësive të tjera alternative të kontaktit me QPS dhe të anketuarve të tjerë.

Në raste të rralla, kishte QPS që funksiononin pa drejtorë për shkak të ndryshimeve të personelit, me drejtorë të përkohshëm, ose drejtorë të sapoemëruar. Në këtë situatë ishte e vështirë për t'i siguruar të gjitha të dhënat e kërkuara. Në mënyrë alternative, është tentuar të sigurohet informata nga Zëvendësdrejtorët (kur ishte e zbatueshme), nga përgjegjësi i shërbimeve sociale në QPS ose nga drejtoria përkatëse komunale.

Rezultatet kryesore të analizave të nevojës

Analiza e rishikimit dhe shqyrtimit të dokumenteve ka treguar se ekziston një infrastrukturë e kënaqshme legjislative, përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, etj. për shërbimet e QPS-ve në mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë akoma ekziston nevoja në të ardhmen për përmirësim të disa ligjeve sekondare, veçanërisht të akteve nënligjore. Gjithashtu, ka indikacione se zbatimi i ligjeve ka ngecur në nivele të ndryshme të zbatimit që zakonisht kushtëzohen nga: mungesa e stafit, profilet profesionale të ofruesve të shërbimeve, shërbimet adekuate dhe të paqëndrueshme, financimi i dobët dhe i papërshtatshëm, planifikimi dhe koordinimi i fragmentuar dhe i pavendosur.


Përgjegjësia për sigurimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve kryesisht i është caktuar QPS-ve. Sidoqoftë, institucionet e nivelit qendror janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave standarde dhe krijimin e mekanizmave për t'i mbrojtur fëmijët. Nga ana tjetër, komunat kanë rol dhe përgjegjësi specifike, si dhe të përcaktuara brenda kornizës legjislative në lidhje me mirëqenien sociale dhe veprimet specifike drejt mbrojtjes të fëmijëve (kryesisht të zbatuara përmes QPS-ve). Gjithashtu, OJQ-të e licencuara kanë një rol në rrjetin e sigurisë për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo krijon një rreth të ndërlidhur që ndajnë përgjegjësitë dhe supozohet se mbështesin njëra-tjetrën në arritjen e standardeve minimale të kujdesit për grupet e cenuara dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Përgjegjësitë e komunave dhe roli i tyre në mbrojtjen e fëmijëve² përcaktohet në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, si dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. Në të dy ligjet vërehet se secila komunë është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtjen dhe ri-integrimin e mbrojtjes të fëmijëve brenda territorit të saj, sipas standardeve dhe politikave të Qeverisë ose ministrive përkatëse. Në këtë rast, komunat janë të obliguara të ndërmarrin hapa për të identifikuar natyrën dhe shtrirjen e nevojës për mbrojtje të fëmijëve brenda territorit të tyre, për të përgatitur plane vjetore dhe fonde të duhura për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, dhe gjithashtu komunat janë të obliguara që përmes drejtorive përkatëse të caktojnë të paktën një zyrtar për mbrojtjen e fëmijëve, i cili është i/e obliguar të bashkëpunojë, shkëmbejë informata dhe të dhëna me Zyrën për Qeverisje të Mirë.

Ndonëse kompetencat janë decentralizuar nga niveli qendror në atë komunal, financimi i paqëndrueshëm i shërbimeve sociale dhe familjare e vështirëson përfundimin e procesit të decentralizimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se QPS ka raportuar se deri më tani fusha e shërbimeve sociale dhe familjare nuk është trajtuar si përparësi nga autoritetet komunale. Sigurisht, një situatë e tillë sfiduese kërkon koordinimin dhe bashkëpunimin e shumë palëve dhe ofruesve të shërbimeve për të marrë sipër kujdesin bazuar në nevojat individuale dhe për të siguruar zgjidhje në një mënyrë të integruar dhe të koordinuar për fëmijët dhe familjet me nevojë sociale. Rrjetëzimi, koordinimi dhe integrimi ndërmjet akterëve kryesorë dhe partnerëve shihet si çelës për ngritjen e cilësisë të shërbimeve sociale.


² Ibid. Neni 14.

Sidoqoftë, zhvillime të reja pritet të ndodhin këtë vit dhe më tej, pasi që koncepti i dokumentit për hartimin/ndryshimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare ishte miratuar nga Qeveria e Kosovës. Rezultatet e marra nga grumbullimi i të dhënave dhe analizat në 34 QPS paraqitën një pasqyrë të shërbimeve sociale për fëmijë, të cilat i posedojnë QPS-të dhe për të cilat QPS-të kanë nevojë. Lidhur me **shërbimet** ekzistuese **të cilat i adresojnë fëmijët në nevojë dhe nevojën për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror për fëmijët dhe familjet e tyre**, të dhënat tregojnë se në 58,3% të komuniteteve lokale në të cilat veprojnë QPS-të (21 nga 34 QPS të cilat u përgjigjën në këtë pyetje përmes Pyetësorit) shërbimet specifike për fëmijët nuk ekzistojnë, por ekziston nevoja për lloje të ndryshme të shërbimeve siç janë: shërbimet e këshillimit për fëmijët me probleme të sjelljes dhe prindërve të tyre, kujdesi në shtëpi, shërbimet e kujdesit ditor si dhe strehimi i mbështetur për fëmijët me aftësi të kufizuar ose fëmijët pa kujdes prindëror. Në 21% (7 nga 34 QPS të cilat u përgjigjën në këtë pyetje përmes Pyetësorit) ekzistojnë shërbime për fëmijë, por nuk janë të mjaftueshme sipas nevojës. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të ceket se 8% (3 nga 34) të QPS-ve mendojnë se nuk ka nevojë për disa shërbime, përfshirë ata që janë të mendimit se nuk ka nevojë për ndonjë shërbim, por gjithashtu edhe ata që mendojnë se nuk ka nevojë për ndonjë shërbim përveç shërbimeve tanimë ekzistuese. Në të dy rastet është mendimi i cili duhet të merret në konsideratë kur zhvillohen kapacitetet për një kujdes më të mirë të fëmijëve, pasi opinioni i tyre mund të jetë shumë i rëndësishëm për të ndikuar në zhvillimin e shërbimeve në komunitetet lokale.



[Pajisjet teknike dhe materialet e nevojshme për punë profesionale në QPS nuk janë të mjaftueshme, pasi të dhënat tregojnë se nga 34 QPS, 21 QPS (58.3%) raportuan se ndërtesa ku ato veprojnë është pjesërisht e pajisur teknikisht; 9 QPS (25,0%) punojnë në ndërtesa të cilat janë plotësisht të pajisura teknikisht; dhe 2 QPS (5.5%) veprojnë në ndërtesa të cilat janë pa kushte teknike, siç janë zyra të mira, të pastra, të pajisura për punë me fëmijë dhe familjet e tyre, pa kompjuter dhe lidhje interneti, pa asnjë automjet të nevojshëm për vizita në terren).

Mundësia e qasjes e QPS-ve për punë me fëmijët dhe familjet e tyre është e ndryshueshme në komuna të ndryshme. Siç paraqesin të dhënat, 17 nga 34 QPS (rreth 47%) janë pjesërisht të arritshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.



isht të arritshme për fëmijët me aftësi të kufizuara - zakonisht ata shpjeguan se ka hapësirë të përshtatshme për të punuar me fëmijë të shurdhër dhe me shikim të dobët, si dhe me fëmijë me aftësi të kufizuara mendore, por nuk kanë hapësirë për të punuar me fëmijë të cilët përdorin mjete ndihmëse ortopedike ose karrige me rrota, gjithashtu, diskutimet tregojnë se ekziston një nevojë e madhe për t'i

ndryshuar qëndrimet e punonjësve në lidhje me kuptimin e qasjes, në mënyrë që t'i bëjnë ata të vetëdijshëm se mundësia e njohjes dhe dinjitetit të secili fëmijë është ndër të drejtat themelore të fëmijëve, sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Kur flitet për mbrojtjen e grupeve më të rrezikuara të fëmijëve siç janë fëmijët me aftësi të kufizuar, mundësia e qasjes është parakushti kryesor për mbrojtjen e tyre.

Struktura e punonjësve të QPS-ve sipas arsimimit, gjinisë dhe moshës duket mjaft pozitive, veçanërisht për shkak të moshës të Zyrtarëve për Shërbime Sociale. Gjegjësisht, nga gjithsej 190 të punësuar në 34 QPS në Kosovë, 63 prej tyre janë të grupmoshës 30 - 40 vjeçare. Sa i përket kualifikimit akademik, profesioni dominues është fakulteti juridik - 62 nga 190 të gjithë zyrtarët e shërbimit në 36 qendra për punë sociale; 46 prej tyre janë me trajnim akademik si punonjës social; 18 prej tyre kanë kualifikim akademik në psikologji; 24 prej tyre kanë kualifikim akademik në pedagogji; 36 prej tyre kanë kualifikim akademik në sociologji dhe 7 prej tyre janë të profileve të tjerë të ndërlidhur - të tilla si ekonomia, edukimi, shkencat politike dhe biologjia.


Numri i rasteve të shqyrtuara nga QPS-të gjatë vitit 2019 ishte gjithsej 34986. Nga këto, 8456 janë raste që lidhen me fëmijët, nga të cilat 1669 raste kishin të bënin me fëmijët me aftësi të kufizuar, 1408 raste kishin të bënin me fëmijë me probleme të sjelljes dhe 2863 raste të fëmijëve që vinin nga familjet jo funksionale.

Situata në lidhje me **ndërtimin e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të shërbimeve sociale** duhet të hulumtohet në të ardhmen, sepse nga 34 QPS të cilat u përgjigjën në Pyetësor, 26 QPS raportuan se gjatë tri viteve të fundit ishin organizuar 152 trajnime dhe seminare, me numrin e përgjithshëm prej 109 punonjësve të trajnuar. Në mungesë të informatave nga 4 QPS të tjera të cilat nuk u përgjigjën fare në Pyetësor, duhet theksuar se ekziston nevojë jashtëzakonisht e madhe për trajnime shumë më të specializuara/akademike dhe shumë më tepër punonjës të përfshirë në zhvillimin profesional për zyrtarët e shërbimeve sociale.

QPS-të kanë raportuar mbi **nevojën e tyre për forma të tjera të zhvillimit profesional** në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe interesi për lloje të ndryshme të mbështetjes është i ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet mbikëqyrjes, mentorimit dhe nevojës për mbështetje teknike (njohuri dhe aftësi specifike si hulumtimi, raportimi, monitorimi etj.). Është shumë e rëndësishme të theksohet se 14 nga 34 QPS (38,9%) të cilët raportuan kanë nevojë për mbështetje në matjen e nevojave specifike për trajnime. Gjithashtu 12 nga 34 QPS (33.3%) raportuan një nevojë për diç tjetër dhe shumica e tyre përfshijnë mbështetjen materiale ose ndihmën në pajisje teknike.

Duke raportuar **mbi shpeshësinë dhe cilësinë e bashkëpunimit mbi mbrojtjen e fëmijëve në nivelin lokal**, QPS raportoi se bashkëpunimi më i mirë është ndërmjet sistemit të kujdesit shoqëror, me institucione të tjera sociale, përfshirë OJQ-të të cilat merren me fëmijë. Vetëm 12 QPS nga 34 QPS (33.3%) raportuan se bashkëpunimi me qeverinë lokale ishte shumë i suksesshëm. Duhet të merret në konsideratë se janë 4 nga 34 QPS (11,1%) të cilat nuk kanë bashkëpunim të suksesshëm me administratat e tyre lokale komunale.

Lidhur me Nenin 15 të Ligjit mbi Mbrojtjen e Fëmijëve, kur u pyetën **nëse e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve**, 3 QPS nga 34 (8.3%) raportuan pozitivisht se kanë filluar procedurat për emërimin e zyrtarit, 12 QPS nga 34 (33.3%) raportuan që nuk kanë emëruar akoma por kanë planifikuar dhe 19 QPS nga 34 (52.8%) kanë raportuar se nuk e kanë caktuar zyrtarin. Sa i përket arsyes, ata ende nuk e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, 19 nga 34 QPS (52.7%) kanë dhënë si arsye faktin se ata nuk kanë numër të mjaftueshëm të të punësuarve.



35% e QPS-ve
raportuan
bashkëpunimin

Së fundmi, janë analizuar **mendimet e drejtorëve të QPS-ve mbi atë se çfarë duhet** bërë për të përmirësuar më tej QPS-të në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Gjithsej 26 nga 34 QPS (72,2%) raportuan se numri i të punësuarve në QPS për punë me fëmijë dhe të rinj duhet të rritet. Ajo që është shumë e rëndësishme për të theksuar është që shumica e tyre e njohin nevojën për një numër më të madh trajnimesh për punonjësit në fushën e mbrojtjes të fëmijëve si bazë për zhvillimin e kujdesit për fëmijë në të ardhmen. Gjithashtu 25 nga 34 QPS (69.4%) njohin rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë akterëve socialë në komunitet për të mirën e fëmijëve, dhe i shohin fushatat e përqendruara tek fëmijët dhe të drejtat e tyre si një nga mjetet të cilat mund të kontribuojnë në mendimet e përgjithshme duke rritur mirëkuptimin për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të fëmijëve në mesin e popullatës së përgjithshme, veçanërisht duke rritur ndërgjegjësimin në lidhje me fëmijët nga grupet në situata më të pafavorshme.

Intervistat me drejtorët komunal theksuan perceptimin e përgjithshëm se njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet ekzistuese të profesionistëve në komunë, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kategorizohen si të dobëta deri te niveli i mesëm.

Konsiderohet se ka shumë pak profesionistë të komunave, mjaftueshëm të trajnuar për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Ekziston një kufizim në numrin e stafit, moshës të shtyrë dhe të pamotivuar për shkak të pagave të vogla - kryesisht jo të gatshëm për të mësuar dhe përfshirë teorinë bashkëkohore sociale në punën e tyre praktike, pa kuptim të qartë të rëndësisë së dokumenteve ndërkombëtare në lidhje me disa grupe specifike të përfituesve, të tilla si Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Kryesisht profili administrativ i përshkrimit të punës. Nuk ka planifikim të duhur dhe ekziston metodologji të vjetruar të strukturave organizative dhe funksionimit. Buxhet i ndarë i kufizuar për projekte më të mëdha dhe blerje të shërbimeve. Ndarja akoma e paqartë e detyrave ndërmjet MPMS, Komunës dhe QPS-ve. E gjithë kjo reflekton në gatishmërinë dhe aftësitë mjaft të kufizuara për punë në promovim, por edhe në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Gjatë **tri diskutimeve të fokus grupeve** pjesëmarrësit treguan se ekzistojnë mbi 25 kategori të ndryshme të fëmijëve me mbi 80 lloje të shërbimeve që u ofrohen fëmijëve nga QPS-të. Shumica e shërbimeve janë të rregulluara mirë dhe të strukturuar me udhëzime të qarta legjislative. Shërbimet janë kryesisht këshillime dhe referime të ofruesve të tjerë të shërbimeve. Gjithashtu, veprimet e masave mbrojtëse zhvillohen në bashkëpunim me familjen, shkollën, policinë, gjykatat dhe partnerë të tjerë të shtetit dhe shoqërisë civile.

Ankesat kryesore të Zyrtarit të Shërbimeve Sociale për zyrat e QPS -së përbëhen nga: zyrat zakonisht ndahen ndërmjet dy ose më shumë QPS -ve, pa privatësi kur pranojnë klientë dhe flasin me ata për çështjet delikate dhe të ndjeshme. Nuk ka vende adekuate për takime dhe intervista me fëmijë. Nuk ka vende të specializuara për takimin e fëmijëve me prindër të cilët po kalojnë nëpër procedura të shkurorëzimit. Në shumë QPS ka gjithashtu mungesë të hapësirës të pritjes dhe/ose një karrigeje për t'u ulur dhe pritje.

Një numër i madh i shërbimeve dhe ndihmës ende menaxhohet nga niveli qendror (MPMS). Ekziston parakusht i nevojshëm për një koordinim më të mirë ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. *Të gjitha shërbimet profesionale janë të decentralizuara në nivelin lokal, ndërsa nuk ka kapacitet profesional dhe struktura të financuara për t'i trajtuar të gjitha kërkesat. Profili profesional dhe përvoja e punës e zyrtarëve për punë sociale nuk janë gjithmonë adekuate dhe të përgatitura mirë për raste komplekse të fëmijëve në nevojë.*

Konkluzionet

1. Nga shqyrtimi i të gjitha ligjeve përkatëse lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, mund të konkludohet se ekziston një kornizë e kënaqshme legjislative për Qendrat për Punë Sociale, si dhe palët e tjera të interesit, të cilët i rregullojnë mekanizmat dhe shërbimet në mbrojtjen e fëmijëve. Ka procese të vazhdueshme të rishikimeve legjislative në disa segmente të ligjeve që do të mundësojnë dispozita më të mira për mbrojtjen e fëmijëve.
2. Më tej në shqyrtimin legjislativ dhe të paraqitur në disa intervista me QPS-të dhe në drejtoritë komunale të mirëqenies sociale, ka disa zbrazëtira në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në legjislacionin sekondar dhe aktet nënligjore të cilat duhet të: rregullojnë dhe ofrojnë udhëzime të qarta për rolin dhe përgjegjësinë e veprimeve ndërmjet palëve të interesit (në veçanti ndërmjet administratës qendrore dhe lokale, si dhe brenda nivelit komunal), llojit dhe frekuencës së shërbimeve të mbrojtjes sociale, modaliteteve të financimit, raportimit dhe monitorimit (sigurimit të cilësisë).
3. QPS-të si ofrues të shërbimeve ngritën shqetësime në lidhje me standardet minimale për kujdesin dhe procedurat e ofrimit të shërbimeve të zhvilluara nga MPMS. Ato argumentuan posaçërisht për udhëzimet e pamjaftueshme dhe të paqarta të dhëna në disa dokumente standarde minimale dhe forma të tjera mbështetëse për masat e mbrojtjes të fëmijëve për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar.
4. Përkundër tendencave ndërkombëtare mbi rritjen e fuqisë punëtore të punës sociale, përkundrazi, numri i punonjësve socialë në Kosovë është zvogëluar pasi shumë pozita të lira në QPS (për shkak të pensionimit, vdekjes ose dorëheqjes) në shumë QPS nuk janë zëvendësuar me personel të ri. Gjithashtu, nga QPS-të është raportuar se ka mungesë të profileve profesionale të stafit siç janë punëtorët social, psikologët dhe pedagogët special apo specialistë për këshillim për të punuar me raste komplekse. Gjithashtu ka ankesa për mungesë të stafit ndihmës (nëpunës administrativë në QPS-të më të mëdha, stafit për pastrim dhe stafit të sigurimit në ndërtesa). Vetëm në disa QPS është raportuar për angazhim/punësim periodik të personelit dhe shërbimeve profesionale për raste specifike.
5. Në të gjitha analizat gjatë gjithë procesit të hulumtimit nuk ka indikacione për iniciativa si angazhimi i vullnetarëve që mund të mbështesin për ta ulur barrën e disa detyrave administrative brenda QPS-ve, ose për të kryer ndonjë punë parandaluese me fëmijët në komunitet. Nuk ka dëshmi as për iniciativa dhe as për bashkëpunim me ndërmarrjet shoqërore (edhe pse ka shumë pak aktive në Kosovë). Gjithashtu, ka shumë pak stimulim për t'iu qasur, inkurajuar dhe angazhuar punonjësit e sektorit privat dhe të komunitetit në mbështetje të kategorive të cënueshme dhe familjeve të fëmijëve në rrezik.
6. Metodologjitë e vjetruara të qasjes organizative në mbikëqyrje, ndarja e ngarkesës të punës dhe menaxhimi i çështjeve brenda QPS-ve kanë nevojë për përmirësim. Rastet e reja u ndahen punonjësve social me sistem rotacioni (në disa raste pavarësisht nga profili specifik profesional, viti i përvojës dhe ngarkesa e punës së punonjësve social); punonjësit social nuk janë të specializuar në një ose në kategori të grupeve, d.m.th. fëmijë dhe të rinj, të moshuar, familje dhe shëndetësi, etj. Punëtorët social mund të angazhohen në kategori të ndryshme të rasteve në të njëjtën kohë. Nuk ka praktika të vendosura të kolegjiemeve profesionale ndërdisiplinare për menaxhimin e çështjeve komplekse brenda QPS-ve.
7. Ka qenë e pamundur të identifikohen të gjitha trajnimet e ofruara për të gjitha QPS-të. Nuk ka pasur të dhëna të qarta, gjithëpërfshirëse të trajnimit dhe asnjë vlerësim të duhur të nevojave për trajnimin e kryer në raportet e kaluara ose për ato të fundit për të gjitha QPS-të në Kosovë. Ka pasur dëshmi të shpërndara se personeli i QPS-ve ka marrë trajnime të specializuara që synojnë kategoritë më të rrezikuara të fëmijëve (QPS-të kanë emëruar personel sipas rasti të cilët janë pajisur me trajnime të ndryshme 1-2-ditore dhe ose punëtori, por jo me module të specializuara akademike që mund t'i certifikojnë ata me ekspertizë në temë të veçantë); p.sh. punë me fëmijë dhe të rinj, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë që abuzojnë me substanca, fëmijë nga familjet jofunksionale, etj.
8. Analiza e nevojave sociale dhe çdo planifikim tjetër i shërbimeve si: masat parandaluese për kategoritë në rrezik, planifikimi buxhetor, koordinimi, partneriteti dhe iniciativat e lobimit në nivelin komunal nuk zhvillohen në baza të rregullta (vjetore), as në QPS dhe as në DMS.

- Në QPS nuk ka mekanizma të qëndrueshëm dhe të duhur të monitorimit për të mbështetur planifikimin dhe analizën e nevojave për kategoritë në rrezik, gjithashtu duke monitoruar frekuencën dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve për fëmijët. Në atë kontekst nuk ka ndonjë planifikim specifik buxhetor për fëmijët në nevojë as në QPS dhe as në DMS.
9. Partneriteti i QPS-ve me organizata-institucione të tjera në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve nuk është gjithmonë i koordinuar dhe efikas (veçanërisht për masat parandaluese dhe referim) ndërmjet QPS-ve dhe policisë, shkollave, gjykatave, ofruesve të tjerë të shërbimeve përfshirë OJQ-të. Jo gjithmonë ka kanale të qarta të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit.
 10. Në pjesën më të madhe infrastruktura e ndërtesave së QPS-ve raportohet të jetë në gjendje të dobët: mungesë e hapësirës dhe zyrave të përshtatshme, TI e vjetruar dhe ose jofunksionale dhe pajisje të tjera komunikimi, mobile të vjetra dhe shumë pak ambiente miqësore për fëmijët. Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe sigurimin në kohë të komoditetit për fëmijët në nevojë për shërbime të QPS-së.
 11. Mungesa e mjeteve të transportit dhe komunikimit në QPS: transporti i punonjësve social për vizita në terren është një neglizhencë tjetër serioze nga komunat si organ i drejtpërdrejtë i mbikëqyrjes dhe menaxhimit të QPS-ve. Ka raportime nga QPS-të se ata kanë vështirësi në plotësimin e kërkesave ligjore për vizitat në terren të familjeve në nevojë. Në raste të veçanta të fëmijëve në rrezik që kërkojnë vizita shumë të shpeshta dhe ndonjëherë me urgjencë.
 12. Të gjitha transaksionet financiare janë të centralizuara në ministri dhe në nivelin komunal. QPS nuk posedon llogari të vet bankare, prandaj nuk mund të ndajnë fonde për shpenzime të urgjencës në rastet e fëmijëve në nevojë urgjente për ushqim, rroba dhe gjëra higjienike. QPS nuk mund t'i mbledhë as taksat dhe tarifën e paguara nga qytetarët për shërbimet administrative të sigurimit të dokumenteve të ndryshme në lidhje me statusin e familjes dhe varësinë e tyre, shërbime të ofruara nga QPS. Gjithashtu, është e pamundur për të aplikuar për fonde dhe projekte nga donatorët e jashtëm, përveç statusit ligjor si institucion publik.
 13. Në QPS ofrohen ekskluzivisht këshillime dhe shërbime referimi. QPS-të nuk kanë kapacitete (personel dhe buxhet) për shërbime të tjera direkte për fëmijë dhe të rritur/familjet në nevojë. Në rast nevojë për p.sh. strehim, ushqim dhe mbështetje tjetër urgjente për klientë, QPS-të nuk kanë kapacitete dhe asnjë stimulim financiar për të ofruar.
 14. Në disa raste dhe të ilustruara me raste konkrete, QPS -të u shprehën mbi alternativat shumë të ulëta të kapaciteteve të strehimit për fëmijët në nevojë. Ekziston vetëm një OJQ Strehimore për fëmijët në rrezik me kapacitete shumë të kufizuara. Shumë pak familje kujdestare në komuna dhe familje pothuajse jo ekzistuese të strehimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Strehimoret për viktimat e dhunës në familje pranojnë nëna dhe fëmijët e tyre (djem vetëm deri në moshën 12 vjeçare). Situata është shumë e rëndë për strehimin e çdo rasti të djemve më të moshuar se 12 vjeç. Nuk ka strehim të përkohshëm për strehimin afatshkurtër të fëmijëve në situatë të vështirë.
 15. Në disa rezultate të nxjerra nga analiza, është treguar se skemat e ndihmës sociale për familjet në vështirësi ekonomike, si dhe ndihma financiare për aftësinë e kufizuar dhe skemat e tjera të ndihmës financiare janë shumë të ulëta dhe nuk i mbulojnë nevojat themelore për ushqim dhe gjërat jo-ushqimore e kërkuara për përdorim ditor.
 16. Skemat sociale menaxhohen kryesisht nga MPMS të nivelit qendror. Sidoqoftë, QPS-të konsiderojnë se ekziston një buxhet mjaft i ulët në nivelin lokal për mbulimin e kostove të funksionimit të QPS-ve, personelit dhe nevojave të tjera emergjente për klientët që i bëjnë të disponueshme shërbimet për fëmijët në nevojë dhe gjithashtu kategoritë e tjera.
 17. Në të gjitha instrumentet kërkimore, pyetësorët dhe intervistat ka pasur tregues minimal të veprimeve parandaluese për mbrojtjen e fëmijëve, as nga QPS-të dhe as nga palët e tjera të interesit. Masat parandaluese gjithashtu nuk janë të mundshme për shkak të ngarkesës së punës të zyrtarëve të shërbimit social dhe qasjes statike dhe metodologjisë të bazuar në zyrë të punës brenda QPS-së.
 18. QPS-të dhe Zyrtarët e Shërbimit Social konsiderojnë veten si të lënë pas dore dhe të nënvlerësuar nga autoritetet në nivelin qendror dhe kryesisht në nivelin komunal për punën që bëjnë. Situata e QPS-ve dhe në veçanti statusi i Zyrtarëve të Shërbimit Social është kërkuar që të rishikohet dhe përmirësohet në shumë aspekte: si pozita në katalogun e profesioneve dhe nivelin e pagave. Gjithashtu, rregullimi i pagesës të orëve shtesë dhe ndërrimeve të natës

- për Zyrtarët e Shërbimit Social. Ka ngatërresa nëse këto ndryshime duhet të fillojnë nga niveli qendror apo komunal.
19. Ka pak dëshmi se QPS-ja ka përvojë dhe strategji për të komunikuar me mediat lokale dhe për t'i përdorur ato për shpërndarjen e informacioneve për masat parandaluese dhe, ose informacionet për shërbimet e ofruara dhe mekanizmat e referimit për të gjitha shërbimet dhe në veçanti për mbrojtjen e fëmijëve.
 20. Monitorimi i ndjeshëm dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë në nivelin qendror dhe komunal me qasjen mbështetëse/këshilluese dhe rekomanduese për QPS-të. Nuk ka asnjë dëshmi të mekanizmave shumë të nevojshëm që do të sigurojnë mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës për QPS-të. Gjithashtu, nuk ka dëshmi të mekanizmave të vetë-monitorimit brenda QPS-ve dhe listave të kontrollit të sigurimit të cilësisë. Të gjithë përfituesit preken nga një qasje e tillë, por më së shumti fëmijët.
 21. Në të shumtën e rasteve, QPS-ja nuk raportoi në pyetësorë një numër të saktë të fëmijëve nën juridiksionin e komunës ku vepron QMS-ja. Gjithashtu, asnjë shënim mbi numrin e fëmijëve në rrezik brenda zonës së tyre të përgjegjësisë.
 22. Në përgjithësi ekziston një zbrastje e madhe në disponueshmërinë e të dhënave të ndara dhe lehtësisht të arritshme në lidhje me rastet dhe ndihmën e ofruar. Gjithashtu, shumë pak informata dhe raporte në lidhje me të dhënat e punonjësve të QPS-ve në nivelin qendror.
 23. Në shumicën e QPS ve nuk ka kuti për ankesa dhe/ose mekanizma të qartë për t'i drejtuar klientët për ankesa dhe procedura eventuale.

Rekomandimet

- a) Meqenëse numri i zyrtarëve të shërbimit social është shumë më i ulët sesa që rekomandohet për numrin e banorëve, këshillohet që të rritet numri i zyrtarëve të shërbimit social në komuna. Të sigurohet punësimi i personelit të ri me profile të larmishme profesionale me kualifikim të shumëllojshëm akademik siç parashihet me ligj (5 kualifikime akademike), si dhe sigurimin e trajnimeve të specializuara të akredituara për zyrtarët e shërbimit social, duke mundësuar sigurimin e shërbimeve për kategori specifike në nevojë brenda QPS-ve, në veçanti për mbrojtjen e fëmijëve (përndryshe të punësohet/angazhohet personel i jashtëm i specializuar sipas nevojës).
- b) Infrastruktura e zyrës ka nevojë për përmirësim të madh. Ndërtoni ose merrni me qira më shumë hapësira për zyra të reja dhe ose riparoni zyrat ekzistuese të QPS-ve: duke siguruar qasje të plotë për të gjithë klientët (përfshirë personat me aftësi të kufizuar paraplegjik) dhe mundësoni hapësirë të mjaftueshme/të përshtatshme për personelin dhe klientët për të bashkëvepruar dhe për të siguruar/marrë shërbime. Caktoni dhe pajisni vende miqësore për intervista për fëmijë dhe bashkime familjare dhe lokale këshillimi. Kjo do të mundësojë shërbime më të qëndrueshme dhe cilësore duke siguruar plotësimin e nevojave të secilit fëmijë, sigurimin e ambienteve të sigurta dhe të rehatshëm, dhe respektimin e integritetit dhe konfidencialitetit.
- c) Në bashkëpunim me Universitetin e shtetit, Fakultetin Filozofik - Departamentin për Punë Sociale, në koordinim të MPMS-së dhe akterëve të tjerë, përfshirë agjencitë donatore, të krijohet një program gjithëpërfshirës i trajnimit akademik për trajnimin në punë të Punonjësve Social. Programet duhet të parashohin rritjen e cilësisë dhe shumëllojshmërisë të shërbimeve; mbi trajnimin për punë për t'i rritur kapacitetet ekzistuese të zyrtarëve të shërbimit social tashmë të punësuar në QPS; gjithashtu, zyrtarë të shërbimit social të angazhuar në shoqërinë civile; si dhe studentë të gatshëm të specializohen më tej në tema specifike. Program trajnimi modular me kurrikula të certifikuara dhe të akredituara në specializime të ndryshme të punës me kategori specifike si: Fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët që abuzojnë me substanca, fëmijët viktimë të dhunës seksuale, fëmijët viktimë të dhunës në familje, fëmijët e abuzuar dhe të lënë pas dore, fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët në situatë rruge, fëmijët refugjatë dhe aftësi të tjera specifike të këshillimit si: menaxhimi i çështjeve, bashkëpunimi ndër-institucional për koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, masat parandaluese për fëmijët në rrezik, mekanizmat e identifikimit dhe referimit, këshillimi ligjor, etj.

- d) Meqenëse Zyrtarët e Shërbimit Social shpesh janë të mbi-ngarkuar me punë dhe jo gjithmonë profesionalisht të specializuar për ndërhyrje komplekse, rekomandohet të merret parasysh struktura menaxheriale e personelit QPS-ve dhe metodologjia e menaxhimit të rasteve. Gjithashtu, për një punë më të mirë në ekip profesional, formoni ekipe profesionale të grupeve për fëmijë, familje dhe të moshuar, gjithashtu edhe nënkategori të tjera. Ndryshoni menaxhimin e rasteve komplekse përmes qasjes multidisiplinare dhe kolegjiut të ofruesve të shërbimeve të ekspertëve brenda QMS-ve, si dhe brenda komunës 'Tryezat e Rrumbullakëta Multidisiplinare për Mbështetje në Menaxhimin e Rasteve' siç kërkohet me ligjin e ri për Mbrojtjen e Fëmijëve – Neni 21).
- e) Përpjekjet e koordinuara të MPMS-së dhe komunave duhet të planifikojnë rritjen e kapaciteteve të strehimoreve dhe qendrave ditore të kujdesit për kategori të ndryshme të fëmijëve në nevojë. Komunitat më të mëdha duhet të koordinojnë dhe mundësojnë strehimin e fëmijëve nga komunitat më të vogla fqinje (strehimi regional dhe shërbimet e kujdesit ditore ose këshillimit nga ofruesit e OJQ-ve duhet të inkurajohen dhe të mbështeten financiarisht nga komunitat e ndryshme, pavarësisht se ku ndodhet strehimorja). Kjo do t'i mundësojë QPS-së zgjerimin e shërbimeve të strehimit për fëmijët dhe të sigurojë mbrojtje adekuatë për kategoritë e fëmijëve në rrezik.
- f) Ofrimi i shembujve të formateve dhe trajnimeve të planifikimit për 'Raportin e Anketimit të Analizës së Nevojave Sociale' pranë autoriteteve komunale dhe planifikimin strategjik dhe planet vjetore të punës - identifikimin dhe shënjestrimin e kategorive dhe shërbimeve të nevojshme. Në veçanti, identifikimin e kategorive të fëmijëve në rrezik dhe burimet e nevojshme për QPS-të në ndërmarrjen e veprimeve të kërkuara dhe sigurimin në kohë të masave parandaluese.
- g) Të merret parasysh rritja e buxhetit për mirëqenien e fëmijëve në përgjithësi dhe për fëmijët në nevojë për shërbime sociale. Zbatimi i formulës së re të propozuar të buxhetimit për mirëqenien sociale në komuna. Sigurimi i udhëzimeve dhe trajnime për buxhetin bazuar në analizën e nevojave shoqërore dhe shërbimet e kërkuara për fëmijët. Kostot për veprimet e QPS-ve në lidhje me masat e mbrojtjes të fëmijëve të jenë të përfshira në planifikimin e ri të buxhetit.
- h) Vendosja dhe mirëmbajtja e mekanizmave funksional të ndryshëm komunal që do të sigurojnë bashkëpunim më intensiv ndërmjet agjencive të institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile përgjegjëse në veprimet e mbrojtjes të fëmijëve. QPS-të duhet të marrin një rol më proaktiv në koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve në nivelin komunal. Në shumicën e rasteve, QPS të duhet të kenë rol udhëheqës në thirrje për takime koordinuese, iniciativa të planifikimit komunal, mbikëqyrjen e shërbimeve të OJQ-ve, komunikimin me media në çështje të ndryshme që lidhen me veprimet e mbrojtjes të fëmijëve dhe të sigurojë përfshirjen dhe veprimet në kohë të akterëve të tjerë përkatës. QPS-ja është e mandatuar ligjërisht për veprime të tilla, por duhet të mbështetet nga komuna me veprime konkrete dhe staf.
- i) Përcaktimi i metodologjisë së monitorimit dhe mjeteve të vetë-vlerësimit brenda strukturave të QPS-ve dhe mekanizmave komunal dhe/ose qendror të cilat do të garantojnë sigurim cilësor të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve të dhëna nga QPS-të dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve. Mbikëqyrja dhe mbështetja nga MPMS dhe drejtoria komunale për mirëqenien sociale në arritjen e standardeve minimale të kujdesit duhet t'u ofrohet QPS-së dhe Zyrtarëve të Shërbimit Social në raste të ndërlikuara.
- j) Ndërtimi i kapaciteteve të QPS-ve për të komunikuar në mënyrë të duhur dhe në kohë me mediat dhe paraqitjet e tjera publike duke siguruar që komuniteti të kuptojë dhe veprojë në favor të identifikimit të hershëm dhe referimit të rasteve që rrezikojnë mirëqenien e fëmijëve, të promovojë masa parandaluese në komunitet, të veprojë në mënyrë mbrojtëse për përfaqësim të sigurt të fëmijëve dhe familjeve të tyre.
- k) Krijimi i mekanizmave të qarta dhe lehtësisht të qasshme të ankesave për klientët dhe përfaqësuesit e tjerë të fëmijëve dhe ose individ/të pavarur, në mënyrë që t'i paraqesin ankesat dhe sugjerimet e tyre.
- l) Fuqizimi ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të rinj për mbledhjen gjithëpërfshirëse dhe të veçuar të të dhënave. Gjithashtu, të sigurohet përdorimi i të dhënave për strategji të ndryshme dhe planin e punës të veprimeve, si dhe alokimin e buxhetit dhe burimet njerëzore të nevojshme.

2. HYRJE

Në Kosovë, fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 24 vjeçare përbëjnë rreth 47%³ të popullsisë dhe për këtë arsye, është me rëndësi thelbësore që të investojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre. Për shkak të Ligjit të ri mbi Mbrojtjen e Fëmijëve, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2019, rëndësia e mirëqenies të fëmijës njihet si jetike, kështu që ky ligj synon të përcaktojë mekanizmat efektiv, funksionimin e institucioneve të obligueshme dhe të marrë masa konkrete për parandalimin, përgjigjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Ekziston një pritje e madhe se miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji sigurisht që do të sjellë risi në shumë aspekte, por që zbatimi i tij kërkon koordinim me institucionet përgjegjëse në të dy nivelet e qeverisjes, qendrore dhe lokale.

Një nga akterët e njohur si vijë e parë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve është Qendra për Punë Sociale (më tej QPS). Në Kosovë janë 40 QPS të mandatuara për të ofruar shërbime sociale dhe familjare, si dhe për të koordinuar dhe organizuar sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijëve brenda komunës. Pozicioni i QPS-ve, siç ceket në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, kërkon kapacitete të fuqishme profesionale dhe organizative të QPS-ve për të marrë sipër pozitën që iu është dhënë atyre në mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijëve.

Duke marrë parasysh se QPS-të kanë rol vendimtar për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023 dhe planin e veprimit, është e qartë se hapi i parë në sigurimin e parakushteve të nevojshme për funksionimin e tyre në këtë drejtim është analiza e nevojës për kapacitetet për të marrë këtë rol në mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë mënyrë, kjo analizë e përqendruar në nevojat dhe kapacitetet e QPS-ve, në fushat e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve është pjesë e projektit "*Avancimi i kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve*", financuar nga Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut - Skemat e Mbështetjes të Bazuar në Shtete-SMBSH dhe të implementuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë në partneritet me HANDIKOS-in - Shoqata e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve të Paralizuar të Kosovës. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të kontribuojë drejt fuqizimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në shërbimet sociale dhe Organizatave të Shoqërisë Civile që ofrojnë shërbime për fëmijët. Përmes objektivave specifik, projekti synon: të rrisë aftësitë dhe njohuritë e QPS-ve dhe OShC-ve për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijës; sigurimin e shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre përmes ofrimit të shërbimit psiko-social, këshillimeve individuale dhe grupeve dhe rehabilitimit; promovimin dhe inicimin e qasjes multidisiplinare për të drejtat e fëmijëve dhe rritjen e kapaciteteve të qendrave të rehabilitimit me bazë në komunitet.

Rezultatet nga rishikimi dhe shqyrtimi i dokumenteve dhe rezultatet në terren, japin një gamë të gjerë shpjegimesh të praktikave ekzistuese si dhe një rekomandim të qartë se çfarë duhet të bëhet në zhvillimin e ardhshëm të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë.

3 Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrimi, 2011, e disponueshme në https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata__09%20Population__Population%20Structure/Population%20by%20census%20year%20and%20age%201961-2011.px/?rxid=6c75a9aa-627c-48c6-ae74-9e1b95a9c47d më 24/9/2020

3. METODOLOGJIA

Mostra dhe burimet e të dhënave

Metodologjia e përdorur për këtë analizë përmban një qasje të kombinuar të metodave për të përfshirë instrumentet e zhvilluara.

Baza ligjore që do të mbështesë këtë hulumtim do të jetë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve 06/L-084, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023, si dhe Planin e Veprimit, Programin për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe gjithashtu duke iu referuar ligjeve të tjera që përcaktojnë kompetencat e QPS-ve si Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

Në mënyrë që të arrihen objektivat, hulumtimi u bazua në pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë nevojat e punonjësve të QPS-së në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në komunat përkatëse lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
- Cilat janë kapacitetet e QPS-së i përket burimeve njerëzore, profesionale, financiare dhe teknike për të ofruar shërbime cilësore në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
- Cilat janë sfidat me të cilat përballen punonjësit e QPS-së në zbatimin e protokolleve të punës varësisht nga karakteristikat e tyre demografike?
- Çfarë e bën më efektiv procesin e sigurimit të shërbimeve sociale dhe familjare?
- Cilat janë mundësitë për ndërtimin e kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve efikase dhe cilësore ndaj nevojave të grupeve të cenushme?
- A ka ndryshime në ofrimin e shërbimeve sociale bazuar në përvojën e tyre të punës, ku ata punojnë dhe gjininë e tyre?

Hulumtimi është ndarë në tri metoda hulumtimi të ndërlidhura:

- a) *analiza e shqyrtimit të dokumenteve* - rishikimi dhe analiza e dokumenteve ekzistuese dhe materialeve përkatëse që përqendrohen në të drejtat e fëmijëve, sistemin e mbrojtjes sociale, mekanizmat institucional në mbrojtjen e fëmijëve, raportet dhe statistikat aktuale. Analiza e raporteve dhe gjetjeve specifike për shërbimet e mbrojtjes të fëmijëve mundësoi një pasqyrë fillestare të zbatueshmërisë së shërbimeve sociale të ofruara nga QPS-ja, sfidat, mangësitë dhe pengesat, si dhe praktikrat e mira dhe rrëfimet e suksesit.
- b) *grumbullimi i të dhënave sasiore* - për këtë qëllim janë zhvilluar një sërë instrumentesh, përfshirë Pyetësorin për QPS në mënyrë që të matet efikasiteti i shërbimeve ekzistuese të QPS-së si dhe nevojat për avancimin e këtyre shërbimeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe normat e pranuar ndërkombëtarisht. Pjesa me shumë rëndësi e Pyetësorit adresoi nevojën e profesionistëve të QPS-ve për zhvillimin e ardhshëm profesional në çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Nga të gjitha 40 QPS-të në Kosovë, 34 u përgjigjën në pyetësor.
- c) *analiza e të dhënave cilësore* - verifikimi i gjetjeve me intervista dhe diskutime të grupeve të fokusit, si me profesionistë me përvojë nga QPS-të, ashtu edhe me profesionistë nga qeveritë lokale përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.
 - Diskutime në grupe të fokusit: Në mënyrë që të merren informata të plota nga i gjithë territori, grupet e fokusit me ofruesit e shërbimeve u organizuan në 3 regjione të ndryshme⁴, përfshirë grupin e fokusit me profesionistë me përvojë nga QPS-të të cilat përfaqësojnë komunat me shumicë serbe (përmes internetit). Pjesëmarrësit: punonjësit social, drejtorët e QPS-ve; 6-8 pjesëmarrës për një fokus grup. Tema e

⁴ Tri grupe të fokusit: një me QPS-në nga rajoni i Prishtinës dhe një me QPS-në nga rajoni i Prizrenit. Gjithashtu, një grup i fokusit me QPS-në nga komunat që përfaqësojnë shumicën serbe (përmes online).

diskutimit ishte vendosur në tri çështje kryesore: a) Perceptimi i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve të ofruar nga QPS-ja; b) Sfidat në shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve të ofruar nga QPS-ja dhe koordinimi i partneritetit; dhe c) Rekomandimi për modifikim në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve në QPS (çfarë duhet të ndryshojë dhe nga kush). Koha : 60 minuta secili grup, mbajtur më 8 dhe 9 shtator 2020.

- Intervistat me përfaqësuesit e Drejtorive Komunale u bënë me përfaqësues nga 9 komuna me përmasa të ndryshme.
- Gjithashtu, u zhvilluan tri intervista gjysmë të strukturuar me familjet e fëmijëve të cilët janë përdorues të shërbimeve sociale.

Kufizimet

Situata me pandemi COVID 19 ka ndikuar në shqyrtimin e mundësive të tjera alternative të kontaktit me QPS-të dhe të anketuarit e tjerë.

Në raste të rralla, kishte QPS që funksiononin pa drejtorë për shkak të ndryshimeve të personelit, me drejtorë të përkohshëm, ose drejtorë të sapoemëruar. Në këtë situatë ishte e vështirë për t'i siguruar të gjitha të dhënat e kërkuara. Në mënyrë alternative, është tentuar të sigurohet informata nga Zëvendës drejtorët (kur ishte e zbatueshme), nga përgjegjësi i shërbimeve sociale në QPS ose nga drejtoria përkatëse komunale.

Konsideratat etike

Gjatë tërë procesit të analizës, për të gjithë pjesëmarrësit janë respektuar normat e konfidencialitetit të identitetit dhe informatave të marra nga të intervistuarit/të anketuarit. I gjithë ekipi i hulumtuesve ka zbatuar standarde të larta për mbrojtjen e fëmijëve të cilët janë në përputhje me normat lokale dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së fëmijëve.

Meqenëse ekzistojnë QPS të cilat veprojnë në komunitetet me shumicë të popullsisë serbe, instrumentet për grumbullimin e të dhënave, si dhe diskutimi në fokus grupe është organizuar në gjuhën serbe. Është bërë me qëllim që të shmanget pengesa gjuhësore për pjesëmarrësit dhe që ata të mund të shprehin lirshëm mendimin e tyre.

4. LIGJET DHE ANALIZA INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË KOSOVË

Shërbimet e mbrojtjes sociale në Kosovë rregullohen me ligje specifike dhe ndahen ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal/komunal. Ato menaxhohen nga organizatat dhe institucionet e përcaktuara me ligje dhe akte nënligjore specifike për përfshirjen e personave në nevojë për shërbime sociale. Ndonjëherë disa shërbime ofrohen nga OJQ-të dhe akterët tjerë të shoqërisë civile të licencuar për shërbime specifike dhe kategori sociale në rrezik. Në nivelin komunal shërbimet ofrohen kryesisht përmes Qendrave për Punë Sociale. Me qëllim të analizimit të kapaciteteve të Qendrave për Punë Sociale (QPS), disa ligje kyçe, dokumente strategjike, mekanizma dhe procedura institucionale të cilat sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndryshme të diskriminimit dhe shfrytëzimit, dhe garantojnë interesin më të mirë të fëmijëve në Kosovë.

Korniza ligjore

Ligjet të cilat janë renditur më poshtë⁵ paraqesin bazën ligjore të aktiviteteve të QPS-ve dhe përcaktojnë veprimet e tyre për mbrojtjen e fëmijëve:

- Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve
- Ligji nr. 2004/32, Ligji për Familjen i Kosovës dhe Ligji nr. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës
- Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare
- Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale
- Kodi Nr. 06/L-006, Kodi i Drejtësisë për të Mitur
- Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit
- Ligji Nr. 04 / L -032 mbi Arsimin para-Universitar
- Ligji mbi Financat të Pushtetit Lokal⁶

Nga analiza e kornizës ligjore në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, si dhe pyetësorëve dhe intervistave që u zhvilluan me Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe drejtoritë komunale përgjegjëse për mirëqenie sociale, mund të konkludohet se Kosova ka një bazë të kënaqshme të legjisllacionit që rregullon fushën e mbrojtjes të fëmijëve. Në lidhje me këto ligje janë edhe një numër aktesh normative si legjisllacion sekondar (administrativ, udhëzime dhe udhëzues, rregullore, standarde të shërbimeve, etj.), të cilat mbështesin zbatimin e ligjeve. Derisa i diskutuam ligjet dhe aktet nënligjore me palët e interesit dhe ofruesit e shërbimeve ne ishim të bindur se ata janë shumë të vetëdijshëm dhe të informuar mbi legjisllacionin për mbrojtjen e fëmijëve dhe në përgjithësi standardet e mirëqenies sociale. Gjithashtu, e kanë të qartë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në lidhje me ligjet dhe kërkesat e standardeve profesionale. Sidoqoftë, gjatë hulumtimit, nga informatat e mbledhura që rezultojnë nga shumë burime ka indikacione se zbatimi i ligjeve ka ngecur në nivele të ndryshme të implementimit që zakonisht kushtëzohen me: mungesë të stafit, profile profesionale të ofruesve të shërbimeve, shërbime adekuate dhe të paqëndrueshme, shërbime të dobëta dhe financim joadekuat, planifikim dhe koordinim të fragmentuar dhe të pavendosur. Në disa intervista me drejtoritë komunale u shfaq se mirëqenia sociale nuk është e privilegjuar, nuk ka ndonjë vullnet të qëndrueshëm politik dhe ka mungesë të caktimit të prioritetëve dhe avancimit të programeve të mirëqenies sociale të cilat ndikojnë në krijimin e zbrazëtirave në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve.

Pas një procesi shumë të gjatë të konsolidimit dhe diskutimit ndërmjet palëve të interesit, përfundimisht Kosova miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik të

⁵ Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Ligji nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës dhe Ligji nr. 06/L-077, Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe Ligji Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2460>

Kodi Nr. 06/L-006, Kodi i Drejtësisë për të Mitur, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18019>

Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8875>

⁶ Ligji për Financat e Pushtetit Lokal: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/10/Law-On-Local-Government-Finance.pdf>

viti 2019. Miratimi i këtij ligji krijon një vizion të ri për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është që t'i mbrojë fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit ose çdo forme tjetër që rrezikon jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, trajnimin dhe zhvillimin e fëmijës, garantimin, dhe të sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës. Gjithashtu, ky ligj synon të përcaktojë mekanizmat efektiv, funksionimin e institucioneve të obligueshme dhe të marrë masa konkrete për parandalimin, reagimin dhe mbrojtjen e fëmijës.

Për të rritur efikasitetin dhe zbatueshmërinë e ligjeve që ndërlidhen me përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve, Zyra e Qeverisjes së Mirë në kuadër të Zyrës të Kryeministrit, si autoritet qendror që është i mandatuar të koordinojë këtë proces, ka përpiluar Programin për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve 2019 -2021.

Programi bazohet në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023, i cili synon t'i mbrojë të gjithë fëmijët nga të gjitha format e dhunës, për të garantuar mirëqenien dhe përmirësimin e cilësisë të jetës së çdo fëmije⁷. Ky program parasheh, gjithashtu, fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të garantuar me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Ky ligj parasheh konsolidimin e udhëzimeve konkrete që synojnë harmonizimin e sistemit të planifikimit, koordinimin e punës në nivel institucional, shmangien e fragmentimit dhe dublikimit ndërmjet nivelit të politikës qendrore dhe proceseve të planifikimit financiar. Rrjedhimisht, me fillimin e zbatimit të këtij ligji, pritet të intensifikojë veprimet konkrete të të gjithë akterëve kryesorë profesionist në sektorët e shërbimeve sociale, të shëndetësisë, drejtësisë dhe arsimit, për t'iu përgjigjur dhe ta çojë përpara sistemin e mbrojtjes të fëmijëve në fushën e parandalimit, trajtimit dhe veprimit.

Duke pasur parasysh se ky ligj ishte miratuar vitin e kaluar dhe duke i marrë parasysh zhvillimet e fundit politike dhe pandeminë Covid-19, zbatimi i tij në të ardhmen mbetet të shihet; varësisht nga angazhimi i institucioneve përgjegjëse, nivelit të financimit dhe përfshirjes të akterëve përkatës, shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit.

Një ligj tjetër i rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijëve dhe që lidhet drejtpërdrejt me punën e Qendrave për Punë Sociale është *Ligji për Familjen*, i cili është në proces të shqyrtimit dhe ndryshimit dhe pritet të dorëzohet për aprovim në Kuvendin e Kosovës . Ky ligj përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet në nevojë në Kosovë. Ndër tjerash, ligji përcakton rolin e akterëve kryesorë në nivelin qendror dhe komunal për ofrimin e shërbimeve familjare dhe sociale. Në kuadër të ligjit aktual të familjes, një nga parimet kryesore përcakton parimet e rregullimit të familjes me theks të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe shkollimin deri në moshën 18 vjeçare si përgjegjësi e të dy prindërve. Nenet e tjera gjithashtu cekin se fëmijët duhet të gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi, përfshirë shfrytëzimin ekonomik, shfrytëzimin, trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe nga çdo veprimtari që mund të jetë e dëmshme për shëndetin ose arsimimin e tyre. Ky ligj gjithashtu përcakton përfundimin e mbikëqyrjes prindërore ose rrethanat kur e drejta për kujdesin prindëror mund të refuzohet, të tilla si: në rastet kur prindërit abuzojnë me të drejtat e tyre prindërore ose i neglizhojnë obligimet e tyre prindërore.

Përderisa ligji është në shqyrtim, pritet që ligjet e reja të harmonizohen dhe plotësohen me dispozitat ligjore të bazuara në Ligjin mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe gjithashtu në ligjet e reja do të përfshihen rekomandimet e propozuara nga akterët kryesorë institucional në këtë fushë, si dhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Ligjet duhet të jenë interaktive dhe të ndjekin parimin e plotësimin ndërmjet tyre.

Duhet gjithashtu të theksohet se aktualisht shërbimet sociale janë në një fazë të rëndësishme të zhvillimit, ku theksi vihet në plotësimin e nevojave aktuale të grupeve të cënueshme në shoqëri, përmirësimin e cilësisë të shërbimeve dhe përshpejtimin e decentralizimit të menaxhimit financiar dhe administrativ të shërbimeve sociale në nivelin komunal.

Ligji tjetër themelor mbi veprimin e Qendrave për Punë Sociale, përkufizimin e veprimtarisë të tyre dhe lidhjen me mbrojtjen e fëmijëve është *Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare*. Ky ligj përcakton

⁷ Programi për zbatimin e Ligjit mbi Mbrojtjen e Fëmijës 2019-2021, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit

dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet në nevojë në Kosovë bazuar në interesat më të mira të fëmijës, e cila duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme. Ligji, gjithashtu përcakton rolin e akterëve kryesorë në nivel qendror dhe komunal në ofrimin e shërbimeve familjare dhe sociale. Këto shërbime siç përcaktohet me ligj⁸ duhet të jenë në bashkëpunim me familjet, komunitetin, organizatat joqeveritare dhe organet tjera, të cilat ofrojnë kujdes social, këshillim social dhe, në rrethana të jashtëzakonshme, ndihmë materiale për fëmijët dhe familjet e tyre që janë në nevojë dhe që jetojnë në territorin e saj, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre për këto shërbime dhe aftësinë e komunës për t'i përmbushur ato në mënyrë të arsyeshme. Autoriteti kryesor për sigurimin e mbrojtjes sociale dhe mirëqenies të qytetarëve të tyre është Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përmes QPS-së. Pamundësia e këtyre drejtorive për të siguruar cilësinë e nevojshme të shërbimeve mund të ndikojë drejtpërdrejt në mirëqenien e përfituesve të shërbimeve sociale.

Ky ligj gjithashtu mandaton Qendrat për Punë Sociale si organe kryesore të autoriteteve komunale për të siguruar kujdes social, mbrojtje sociale dhe këshillim në rrethanat kur një fëmijë ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare. QPS-të janë përgjegjëse për identifikimin dhe sigurimin e shërbimeve për grupet në nevojë, dhe në këtë drejtim nga diskutimet me përfaqësuesit e QPS-ve, si dhe në shumë raporte të botuara nga institucionet lokale dhe OJQ-të, shumë mangësi në kapacitetin e QPS-ve janë theksuar për të përmbushur mandatin e tyre, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për të vlerësuar situatën e të gjithë fëmijëve dhe familjeve në komunat e tyre dhe shërbimet e tyre nuk i arrijnë të gjitha familjet në nevojë.⁹

Ballafaqimi me të gjitha këto sfida sigurisht vjen si rezultat i decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare që nuk u zbatua me sukses, dhe kjo ka sjellë keqkuptime në ndarjen e kompetencave, por edhe menaxhim të dobët të shërbimeve sociale dhe familjare. Duhet të kujtojmë se procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale filloi në vitin 2009, por përkundër përpjekjeve për ta finalizuar atë, ky proces mbetet një nga sfidat kryesore në sektorin e mirëqenies sociale.

Megjithëse kompetencat janë decentralizuar nga niveli qendror në atë komunal, financimi i paqëndrueshëm i shërbimeve sociale dhe familjare e vështirëson përfundimin e procesit të decentralizimit, duke siguruar kështu shërbime sociale cilësore dhe të qëndrueshme për qytetarët që kanë nevojë për mbrojtje sociale. Sigurisht, një situatë e tillë sfiduese kërkon koordinimin dhe bashkëpunimin e shumë palëve dhe ofruesve të shërbimeve për të marrë sipër kujdesin bazuar në nevojat individuale dhe për të siguruar zgjidhje në një mënyrë të integruar dhe të koordinuar për fëmijët dhe familjet në nevojë sociale.¹⁰ Rrjetëzimi, koordinimi dhe integrimi ndërmjet akterëve kryesorë dhe partnerëve shihet si çelës për ngritjen e cilësisë të shërbimeve sociale. Sidoqoftë, zhvillime të reja priten të ndodhin këtë vit dhe më gjerë pasi koncepti dokumenti për hartimin e *Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare* është miratuar nga Qeveria e Kosovës në shkurt të viti 2019.

Duke qenë se shumica e fëmijëve në rrezik vijnë nga rrethanat dhe kushtet e vështira ekonomike familjare, *Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë* dhe *Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale* që synon të ofrojë një rrjet të sigurisë shoqërore brenda sistemit të mbrojtjes sociale në Kosovë dhe lehtësimin e varfërisë duke ofruar ndihmë për familjet e varfra dhe të cenushme. Përkatesisht, ky ligj përcakton skemën e ndihmës sociale të Kosovës me qëllim të mbrojtjes dhe kujdesit për familjet në rrezik në aspektin social. Rregullon sigurimin e ndihmës financiare për familjet e pranueshme në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe brenda burimeve të alokuara për këtë qëllim. Skema e ndihmës sociale operon përmes dy kategorive: kategoria e parë është për anëtarët e familjes në varësi të cilët nuk janë në gjendje të punojnë; ndërsa kategoria e dytë është për familjet ku të paktën një anëtar është në gjendje të punojë dhe ku ose një fëmijë nën moshën 5 vjeçe dhe/ose një jetim nën moshën 15 vjeçare është nën kujdesin e përhershëm të familjes.¹¹ Familjet e të dy kategorive duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të pasurive dhe të ardhurave në mënyrë që të marrin mbështetje siç përcaktohet me ligj, që personat e kualifikuar për të aplikuar duhet të jenë shtetas të Kosovës, ose jo-shtetas duke

8 Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

9 Koncepti dokumenti për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40521>

10 Ibid.

11 Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë.

përfshirë shtetas të huaj me leje qëndrimi, azilkërkues, refugjatë ose persona që kanë mbrojtje të përkohshme ose plotësuese. Në këtë aspekt, konsiderohet se skema aktuale nuk ofron mbrojtjen e nevojshme për familjet e fëmijëve që punojnë për shkak të një numri arsyes bazuar në kriterin e moshës duket e padrejtë, dhe që mund të jetë një faktor lëvizës për fëmijët që punojnë në rrugë ose duke kërkuar bamirësi. Së dyti, skema aktuale nuk i adreson në mënyrë adekuate të gjitha familjet e fëmijës të cilat punojnë sikur mos të ishin shtetas, atëherë ata nuk do të kenë qasje në skemë. Së treti, procesi i aplikimit është shumë i ndërlikuar dhe grupet specifike të marginalizuara si pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, persona me aftësi të kufizuar ose persona që janë anal-fabetë mund të kenë vështirësi në përfshirje në skemë për shkak të mungesës të regjistrimit ose mungesës të dokumenteve të nevojshme¹².

Gjithashtu Kodi Nr. 06/L-006 *Kodi i Drejtësisë për të Mitur* rregullon veprimin ndaj të miturit si kryerës i veprës penale, fëmijëve të përfshirë dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, organeve që kryejnë procedura penale dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve penale, veprat penale dhe mbrojtjen e të miturve dhe fëmijëve që janë viktimat dhe të dëmtuar nga vepra penale. Shpesh kur një i mitur është i përfshirë në një vepër penale mund të rezultojë që sistemi i mbështetjes nga familja, shoqëria ose institucionet nuk ka arritur t'i ndihmojë ata, dhe se pavarësisht nga vepra që kanë kryer ata duhet të respektohen si qenie njerëzore dhe se sistemi përgjigjet në një mënyrë efikase dhe në kohë. Në mënyrë që t'i përgjigjet situatës përmes ndërjegjësimit dhe veprimeve parandaluese në këtë aspekt, është e nevojshme që ndërhyrja jonë si shoqëri të përqendrohet në realizimin e të drejtave të tyre themelore për një jetë dinjitoze dhe të barabartë me të gjithë bashkëmoshatarët e tyre, për të krijuar mundësi dhe raste për ri-integrim në familje dhe shoqëri duke i përfshirë ata në programet e riedukimit dhe trajnimit që përqendrohen në potencialin dhe aftësitë e tyre për t'u bërë pjesëtarë të dobishëm dhe të vlefshëm të shoqërisë. Qëllimi i *Ligjit Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit* është përcaktimi i dispozitave ligjore përmes të cilave autoriteteve lokale kompetente u jepen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e qenieve njerëzore në të gjitha format; mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike; ndihmën mjekësore; mbështetjen psiko-sociale; sigurimin e kompensimit dhe të drejtave të tjera për të gjithë personat që pretendohet të jenë identifikuar si të trafikuar, pavarësisht nga gjinia, moshja, statusi martesor, gjuha, paaftësia fizike ose mendore, orientimi seksual, kombësia, mendimi ose besimi politik, feja ose besimi, raca, etnia ose shoqëria, prona, lindja ose statusi tjetër, përmes një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe standardeve. Vlen të ceket se çështjet sociale janë të ndërlikura dhe shpesh ndikojnë në fushën e arsimit, në këtë drejtim kërkohet koordinimi i veprimeve ndërmjet sektorëve në fushën e arsimit social dhe arsimor që mund të ndikojë në parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të rreziqeve për fëmijët, si dhe në edukimin dhe ndërjegjësimin e të gjithëve brenda sistemit arsimor për faktorët negativë që mund të ndikojnë në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rrezikojnë mirëqenien, zhvillimin dhe shëndetin e tyre. Në këtë fushë i referohemi *Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar* – i cili rregullon arsimin dhe trajnimin para-universitar nga Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (ISCED) niveli 0 deri 4, përfshirë arsimin dhe trajnimin e fëmijëve dhe të rriturve që fitojnë kualifikime në këto nivele. Vlen të ceket se arsimi para-universitar bazohet në parimet e përgjithshme që asnjë personit nuk duhet t'i mohohet e drejta për arsim, se arsimi para-universitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe trajnuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. Këta akterë kryesorë janë të obliguar të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të projektuara për tu siguruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për arsimim, në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për zhvillimin e tyre të përparuar arsimor dhe shoqëror. Ata gjithashtu janë të obliguar të marrin parasysh normat e pranuar ndërkombëtarisht për arsimin e të gjithëve, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të cënueshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore. Duhet të theksohet se sipas ligjit për arsimin para-universitar, shkollimi është i detyrueshëm për të gjitha moshat nga 6 deri në 15 vjeçare, dhe se ky ligj garanton arsim të barabartë për të gjitha komunitetet në Kosovë, vazhdimi i arsimit të obliguar nga nxënësit është një përgjegjësi primare e prindit dhe në të kundërtën është shkelje e ligjit. Nëse nxënësi pa ndonjë arsye nuk regjistrohet, nuk ndjek shkollën ose ndërpret shkollimin e detyrueshëm, prindërit e tij

¹² Avdiu, Natyra, 2014, Analizë e situatës të fëmijëve në lëvizje, TdH, Prishtinë, https://childhub.org/sq/system/tdf/library/attachments/2014_kosovo_situation_analysis_albanian.pdf?file=1&type=node&id=8159

dënohen për kundërvajtje nëse mungesa është rezultat i veprimit të paramenduar ose neglizhencës të prindërve. Në raste të tilla, komuna e njofton Ministrinë me shkrim¹³.

-Bazuar në analizën e mësipërme të ligjeve aktuale, por edhe situatën aktuale të familjeve ose fëmijëve në nevojë sociale mund të theksojmë se mbështetja e grupeve më të cenueshme në Kosovë karakterizohet nga shumë sfida, kryesisht për shkak të mungesës të vullnetit politik për të siguruar një model të qëndrueshëm të financimit dhe menaxhimit të shërbimeve sociale, dhe më tej për shkak të mosfunksionimit të një mekanizmi të duhur për planifikimin, monitorimin dhe inspektimin; mungesa e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës fizike të ofrimit të shërbimeve sociale dhe mungesa e investimeve në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Situata ngec veçanërisht në nivelin lokal me disa lloje ndërmjet komunave.

Korniza aktuale ligjore nuk garanton plotësisht financimin e shërbimeve sociale, ndarjen e përgjegjësive ndërmjet nivelit qendror dhe komunal, monitorimin dhe inspektimin e cilësisë të shërbimeve sociale, duke parandaluar kështu përfundimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë. Aktualisht, nuk ka asnjë mekanizëm për ndarjen e drejtë të buxhetit për shërbim social për shkak të mungesës të një formule të financimit për shërbimet sociale (megjithëse ekziston një dokument zyrtar i sapo hartuar i cili pritet të zbatohet¹⁴).

Megjithëse ekziston një shkallë e lartë e cenueshmërisë sociale në Kosovë, mirëqenia sociale nuk është një çështje e cila konsiderohet përparësi në agjendën politike. Kjo vlen si për nivelin qendror ashtu edhe për atë komunal. Korniza e planifikimit të buxhetit nuk e obligon komunën të përcaktojë një buxhet të caktuar vetëm për shërbime sociale¹⁵. Në këtë aspekt, nevojitet gjithashtu sqarimi i kompetencave për institucionet përgjegjëse; krijimi i një granti specifik për shërbimet sociale dhe familjare, kostoja e shërbimeve sociale, forcimi i QPS-së, bashkëpunimi me OJQ-të, etj.

Deri më tani, fusha e shërbimeve sociale dhe familjare nuk është trajtuar si përparësi nga autoritetet komunale. Ka pasur fonde të mjaftueshme të alokuara dhe të planifikuara për të mbuluar koston e standardeve minimale për sigurimin e shërbimeve sociale, megjithëse Ligji për Financat të Pushtetit Lokal rregullon çështjen e financimit të komunave bazuar në Kapitullin IV, Nenin 65, pikën 1 dhe Kapitullin X, Nenin 124, pikën 5 të Kushtetutës së Kosovës. Në këtë kontekst, ekziston nevoja për të përcaktuar burimet financiare që janë në dispozicion të komunave në Kosovë, përfshirë të hyrat vetanake komunale, grantet dhe burimet e tjera financiare të nevojshme për ushtrimin e kompetencave komunale.

Koncept dokumenti për financat e qeverisjes vendore parasheh një grant specifik për shërbimet sociale si një zbritje nga granti i përgjithshëm dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të jetë e obliguar të përcaktojë kriteret ose formulën për financimin e këtij granti specifik, i cili do të jetë i llojit të hapur, i njëjtë me grantin specifik për arsimin dhe grantin specifik për shëndetin.

Ky financim i shërbimeve sociale do të bëhet në përputhje me mundësitë buxhetore por duke siguruar standarde minimale të këtyre shërbimeve. Granti specifik për shërbimet sociale - parashihet të jetë një grant i sistemit të hapur dhe do të përfshijë financimin e shërbimeve sociale, rezidenciale dhe ditore, bazuar në standardet minimale për shërbime sociale të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.¹⁶

13 Ligji Nr. 04 / L -032 Ligji për arsimin para-Universitar

14 Koncept dokumenti për financat në administratën lokale, Ministria e Financave, mars - shtator 2018: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/15-52-14-23082018/Koncept%20Dokumenti%20për%20Financat%20e%20Pushtetit%20Lokal.docx>

15 KONCEPT DOKUMENTI PËR FINANCAT NË ADMINISTRATËN LOKALE, përgatitur nga Ministria e Financave. <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40447>

16 Ibid.

Roli dhe mandati i institucioneve në nivel qendror dhe lokal



të implementuara përmes QPS-së). Gjithashtu, **OJQ-të e licencuara** kanë një rol në rrjetin e sigurisë për mbrojtjen e fëmijëve.

Kjo krijon një rreth të ndërlidhur që ndajnë përgjegjësitë dhe supozohet se mbështesin njëra-tjetrën në arritjen e standardeve minimale të kujdesit për grupet në nevojë dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Përveç përgjegjësisë ligjore të këtyre institucioneve, atyre u kërkohet gjithashtu të sigurojnë cilësi të programeve që mbështesin fëmijët dhe familjet e tyre, mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë parandalimin e kanosjeve për jetën e tyre, dhunën, neglizhimin, abuzimin, keqtrajtimin, braktisjen dhe shfrytëzimin. Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare¹⁷ i miratuar në vitin 2005 përcakton rolet dhe përgjegjësitë e Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe komunave në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale. Sipas ligjit, përgjegjësia e përgjithshme për organizimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë i takon Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ndërsa Departamenti për Politika Sociale dhe Familje është organi kryesor brenda MPMS-së që është përgjegjës për shërbime sociale.

Roli i kujdestarit përcaktohet gjithashtu me legjislacion në Ligjin për Familjen¹⁸ dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve¹⁹.

Shërbimet sociale dhe familjare përcaktohen me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, të tilla si siguri i drejtpërdrejtë i kujdesit shoqëror, këshillimi dhe/ose në rrethana të jashtëzakonshme, ndihma materiale për përfitimin e njerëzve në nevojë. MPMS-ja është përgjegjëse për zhvillimin e politikave sociale dhe planeve strategjike duke siguruar që të gjithë qytetarët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale. Nga ana tjetër, përgjegjësitë e komunave dhe roli i tyre në mbrojtjen e fëmijëve përcaktohet në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare. Në të dy ligjet vërehet se secila komunë është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtjen dhe ri-integrimin e mbrojtjes të fëmijëve brenda territorit të saj, sipas standardeve dhe politikave të Qeverisë ose ministrive përkatëse. Në këtë rast, komunat janë të detyruara të ndërmarrin hapa për të identifikuar natyrën dhe shtrirjen e nevojës për mbrojtjen e fëmijëve brenda territorit të tyre, për të përgatitur plane vjetore dhe fonde të dhura për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, dhe gjithashtu komunat janë të obliguara që përmes drejtorive përkatëse, të caktojnë të paktën një zyrtar për mbrojtjen e fëmijëve, i cili është i/e obliguar të bashkëpunojë, shkëmbejë informata dhe të dhëna me Zyren përkatëse për Qeverisje të Mirë. Në pajtim me Ligjin për Familjen, Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin për Vetë-qeverisjen Lokale dhe memorandumet e mirëkuptimit të nënshkruara ndërmjet MPMS-së,

17 Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

18 Ligji për Familjen i Kosovës, Neni 6. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2410>

19 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Neni 27. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrisë të Financave (MF), në janar të vitit 2009 duke nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) ndërmjet palëve, duke i transferuar përgjegjësitë menaxheriale të Qendrave për Punë Sociale (QPS) nga MPMS te komunat.

Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka një mandat nga qeveritë komunale të jetë përgjegjëse për çështjet komunale të mirëqenies sociale dhe menaxhon Qendrat për Punë Sociale (QPS). Sipas kësaj marrëveshje, shërbimet sociale janë nën përgjegjësinë komunale nën menaxhimin e Drejtorive Komunale të Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale (DKShMS), ndërsa skema e zgjeruar sociale mbetet e centralizuar, shërbimet e strehimit kanë mbetur nën kontrollin qendror të DMS-së në MPMS.

Kuadri legjislativ mandaton Qendrat për Punë Sociale si organe kryesore të autoriteteve komunale për të ofruar kujdes social, mbrojtje sociale dhe këshillim në rrethanat kur një fëmijë/i rritur ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare. Referencat për kompetencat e Qendrave për Punë Sociale gjenden në disa ligje, përfshirë: Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligjin e Familjes, Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

QPS-të janë përgjegjëse për identifikimin dhe sigurimin e shërbimeve për grupet në nevojë. Mandati i tyre rekomandon që nëse QPS "ka baza për të dyshuar se një qytetar fëmijë, ose i gjetur në territorin e tyre si i braktisur, fëmijë pa kujdes prindëror, në vuajtje ose në rrezik të, ndonjë forme të dhunës fizike ose mendore, ndëshkimit ose abuzimit, neglizhencës ose trajtimit neglizhent, përfshirë abuzimin seksual, ndërsa në kujdesin e prindit ose kujt do tjetër që kujdeset për fëmijën, QPS duhet të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të siguruar mirëqenien e një fëmije, për të raportuar çështjen në departamentin përkatës dhe brenda 24 orëve të zhvillojë një vlerësim profesional të nevojave për mbrojtjen e fëmijës. Një pjesë integrale e sistemit të mbrojtjes të fëmijëve është raportimi i detyrueshëm dhe detyrimi i profesionistëve për të bashkëpunuar me QPS-të. Në të njëjtën kohë, QPS-të vetëm nuk mund dhe nuk përbëjnë sistemin e mbrojtjes të fëmijëve në Kosovë. Në mënyrë që të reagojnë dhe të ndërmarrin hapa për të mbrojtur fëmijët që punojnë, institucioneve të tjera u kërkohet gjithashtu të marrin udhëheqjen, megjithëse ka raste kur ata janë të detyruara të përfshijnë QPS-të.

Ndonëse këto qendra janë të mandatuara të ofrojnë shërbime që mund të konsiderohen të nevojshme për të siguruar mirëqenien e individëve dhe familjeve, në praktikë, megjithatë, ato kanë vështirësi në ushtrimin e mandatit të tyre. Këto vështirësi vijnë kryesisht nga mungesa e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për të vlerësuar situatën e të gjithë fëmijëve dhe familjeve në komunat e tyre dhe shërbimet e tyre nuk i qasen të gjitha familjeve në nevojë. Në mungesë të burimeve dhe mbështetjes, QPS-të janë të mbingarkuara me reagime urgjente, duke i lënë mënjanë shërbimet e parandalimit, shërbimet pasuese dhe arritjen/mirëmbajtjen e ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë. Kjo është për shkak jo vetëm të numrit të pamjaftueshëm të të punësuarve në QPS përveç rasteve në nevojë, por edhe për shkak të mungesës të profilizimit brenda QPS-ve.²⁰

20 Analiza e situatës: Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shëndetit në Kosovë, Save the Children në Kosovë, Qendra Evropiane për hulumtim dhe politikë të mirëqenies sociale (2018).
Në dispozicion: <https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/SHQ%20Analiza%20e%20Situates.pdf>

Institucionet e tjera përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve

Përveç QPS-ve, komunat, MPMS dhe OJQ-të si pjesë e shoqërisë civile, institucionet e tjera përkatëse të cilat përbëjnë rrjetin e sigurisë të mbrojtjes së fëmijëve janë gjithashtu:

- Ministria e Arsimit me drejtoritë e arsimit në komuna përfshirë shkollat dhe kopshtet e fëmijëve.
- Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori: policia me drejtori të ndryshme (policia lokale, dhuna në familje, trafikimi kundër-njerëzor etj.), si dhe gjykatat dhe prokuroritë.
- Zyra për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave (pjesë e zyrës të prokurorit të shtetit)
- Inspektoratet e punës.
- Spitalet dhe qendrat e kujdesit shëndetësor në komuna.
- Shërbimi Sprovues i Kosovës²¹ (Ministria e Drejtësisë)
- Qendra Korrektuese për Gra dhe të Mitur²²

Dokumentet strategjike dhe mekanizmat ndërveprues të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve

Dokumentet strategjike, planet e veprimit dhe ligjet e mbrojtjes të fëmijëve sponsorizohen dhe përpiqen nga autoritetet qendrore dhe ministritë përkatëse kryesore, aspektet sociale të mbrojtjes së fëmijëve drejtohen nga MPMS-ja.

Zyra e Kryeministrit me Zyrën për Qeverisje të Mirë është organi më i lartë i cili zhvillon dokumente strategjike për të gjitha kategoritë shoqërore, përfshirë fëmijët. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka rolin udhëheqës në mbrojtjen sociale të të gjitha kategorive dhe në veçanti të fëmijëve, duke i arritur ato drejtpërdrejt me organe dhe mekanizma të centralizuar ose përmes strukturave komunale, kryesisht Qendra për Punë Sociale. Veprimet rregullohen me ligje dhe organe dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë të punës dhe të koordinimit. Masat e mbrojtjes të fëmijëve mbështeten gjithashtu me veprime dhe caktim të strategjive po ashtu nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera ndër-sektorale që veprimet e të cilave ndërlidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Mekanizmat kyç²³:

Krijimi dhe vendosja e gjithë këtyre mekanizmave në nivelin qendror janë sigurisht shtylla të fuqishme për të siguruar një sistem mbrojtës dhe funksional në mbrojtjen e fëmijëve, por në praktikë rezulton se ato nuk janë gjithmonë plotësisht funksionale dhe se ka një mungesë të një koordinimi efektiv, mekanizëm ndërmjet nivelit lokal dhe qendror i cili u mundëson atyre që së bashku të hartojnë politika për veprimet përkatëse që do të fuqizonin funksionalizimin e këtyre mekanizmave. E njëjta situatë pasqyrohet në nivelin lokal me ekzistimin e shumë organeve koordinuese të përbërë nga të njëjtët profesionistë, të cilët kanë krijuar mbivendosje, barrë dhe ngatërrim në lidhje me shërbimet. Prandaj, është i nevojshëm menaxhim më i mirë i këtyre organeve në një mekanizëm të strukturuar në mënyrë që të sigurohet efikasiteti në koordinimin e veprimeve ndërmjet akterëve qendror dhe lokal.

Pavarësisht nga të gjitha veprimet dhe përpjekjet për të ndërtuar një sistem mbrojtës për të gjithë fëmijët dhe në veçanti, fëmijët që konsiderohen më të rrezikuar dhe të drejtat themelore të të cilëve vazhdojnë të shkelen, institucionet në nivelin qendror dhe lokal ende përballen me sfida financiare dhe mangësi në burime njerëzore, si dhe mangësi të konsiderueshme teknike dhe profesionale. Si rezultat, ata nuk arrijnë të reagojnë përmes mekanizmave ekzistues për të përmirësuar situatën dhe mirëqenien e fëmijëve për të cilët ata janë të mandatuar. Kjo është për shkak të mungesës së vendosmërisë dhe mospërputhjes për t'i zbatuar strategjitë sociale dhe funksionimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve dhe në shumë raste devijim i fondeve publike të kryera për këtë qëllim.

21 Shërbimi Sprovues i Kosovës: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,19>

22 Qendra Korrektuese për Gra dhe të Mitur: <https://shkk.rks-gov.net/en/institucionet-single/2224>

23 Shih gjithashtu në shtojcë përshkrimin e hollësishëm të mekanizmave kryesor.


Organet qeveritare të cilat veprojnë në ushtrimin e të drejtave të fëmijëve²⁴

Me "Organ Qeveritar" nënkuptohet mekanizmi i themeluar nga Qeveria për të shqyrtuar ose vendosur çështjet, të cilat Qeveria i vendos nën kompetencat e organeve qeveritare. Qeveria gjithashtu përcakton përbërjen dhe mandatin e një organi qeveritar me vendim për krijimin e këtij organi. Në aspektin e krijimit të Organeve Qeveritare, dhe që kryesisht kanë mandat të veprojnë në ushtrimin e plotë të të drejtave të fëmijëve, janë bërë disa përparime shumë domethënëse, duke bërë të mundur krijimin e disa mekanizmave të tillë, si: (a) Komiteti Ndër-ministror për të Drejtat e Fëmijëve, (b) Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda dhe të Rrezikshme të Fëmijëve, (c) Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar, (d) Këshilli për Mbrojtjen dhe Drejtësinë e Fëmijëve, (e) Komiteti Kosovar për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës, (f) Koordinator Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, (g) Komitetet Lokale të Veprimit për Monitorimin e Punës të Fëmijëve, (h) Grupet Qeveritare të Punës në Institucionet e Kosovës.

²⁴ Përmbledhje e Ligjeve që Mbrojnë të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë. Autore: Qëndresa Ibra-Zariqi, janar 2012 http://tdh-europe.org/upload/document/5123/1411_Summary_Of_Laws_That_Protect_Children_original.pdf


5. STATISTIKAT DHE ANALIZAT E PYETËSORËVE ME DREJTORËT E QPS-ve

1. Të dhëna demografike të të anketuarve (udhëheqësve) nga Qendrat për Punë Sociale



1.1. Pothuajse të gjithë të anketuarit kanë qenë në pozitën e drejtorit/udhëheqësit të Qendrës për Punë Sociale. Nga 34 të anketuar, 28 janë burra (83.3%) dhe 6 prej tyre (16.7%) janë gra.

1.2. Të gjithë ata (100%) kanë përfunduar arsimin e lartë.




1.3. Nga 32 të anketuar që iu përgjigjën kësaj pyetje, 15 prej tyre (46.9%) kanë njohuri akademike në drejtësi, 5 prej tyre (20%) kanë njohuri akademike në ekonomi, 4 (12.5%) kanë njohuri akademike në pedagogji, 3 (9.4%) kanë njohuri akademike në psikologji, 2 (6.3%) në sociologji, ndërsa pjesa tjetër i përket profesioneve të tjera, të tilla si biologjia, shkenca politike, edukimi dhe pedagogjia

2. Karakteristikat sociale dhe gjeografike të vetëqeverisjes lokale (komunave) të mbuluara nga QPS

2.1. Nga 40 Qendra për Punë Sociale që ekzistojnë në 38 komuna të Kosovës, 34 prej këtyre qendrave iu përgjigjën pyetësorit. Numri i përgjithshëm i banorëve nga këto komuna është 1,411,022 banorë, nga të cilët 83,186²⁵ fëmijë janë nën juridiksionin e qendrave përkatëse. Ndërkohë, numri i punëtorëve profesionistë të punësuar në Qendrat për Punë Sociale në raport me numrin e banorëve në 36 komunat pjesëmarrëse, është 175 punëtorë profesionistë në total.

2.2. Numri i banorëve nën juridiksionin e Qendrës për Punë Sociale	2.3. Numri i fëmijëve nën juridiksionin e Qendrës për Punë Sociale	2.4. Numri i punonjësve profesionistë të punësuar në QPS në raport me numrin e banorëve në komunë
1411022	83186	175

2.2. Për sa i përket karakteristikave ekonomike, rezultatet tregojnë se nga 34 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 11 QPS (40.3%) janë të vendosura në komuna ku banorët jetojnë kryesisht nga bujqësia; 1 QPS (3.6%) është e vendosur në një komunë ku banorët janë të punësuar në ndërmarrjet prodhuese; 11 QPS (40.3%) janë të vendosura në komuna ku shumica e popullsisë në moshë pune është e papunë; ndërsa 5 QPS (17.9%) kanë theksuar se banorët e komunës së tyre mbahen ekonomikisht në një formë tjetër, kryesisht përmes bizneseve private.



2.6. Economic characteristics

2.3. Ndërkohë, analiza e karakteristikave gjeografike tregon se 8 QPS (28.6%) jetojnë në komuna kryesisht malore; 6 QPS (21.4%) jetojnë në komuna kryesisht fushore; dhe 14 QPS (50%) jetojnë në komuna të përziera. Është e rëndësishme të nënvizohet se karakteristikat ekonomike ndikojnë në shumë kapacitete të familjeve për t'u kujdesur për fëmijët dhe kanë nevojë për një shërbim më të fortë social dhe të mbrojtjes së fëmijëve në mënyrë që të mbështesin familjet me fëmijë. Në të njëjtën kohë, komunitetet jo të zhvilluara mirë ekonomikisht kanë më shumë vështirësi në zhvillimin e shërbimeve sociale dhe çfarëdo mënyre tjetër të mbështetjes që u nevojitet familjeve.

2.4. Të dhënat statistikore tregojnë se në 18 komuna²⁶ ka 521 institucione dhe organizata që merren me fëmijë. Në 26 komuna ka 670 shkolla, institucione shkollore dhe institucione të tjera arsimore. Për më tepër, në 25 komuna ka gjithsej 175 institucione të kujdesit mjekësor. Gjithsej 29 institucione gjyqësore ndodhen në 23 komuna, 15 institucione të kujdesit social (17 komuna), 6 institucione për fëmijë pa kujdes prindëror (17 komuna), 14 institucione për fëmijë me aftësi të kufizuara (23 komu-

²⁵ Ky numër vlerësohet si shumë më i lartë sesa tregohet nga pyetësori i marrë. Sidoqoftë, kjo tregon që QPS nuk i kanë azhurnuar të dhënat statistikore të numrit të fëmijëve nën juridiksionin e tyre.


²⁶ Të dhënat statistikore tregojnë se të kuptuarit e profesionistëve nga QPS-të në lidhje me institucionet e tjera që merren me fëmijë

na), 9 institucione për fëmijë me probleme (19 komuna), 34 institucione për familje strehuese (24 komuna), 17 qendra të kujdesit ditor për fëmijë me aftësi të kufizuara (23 komuna), 45 organizata joqeveritare (OJQ) që punojnë me dhe për fëmijë dhe bashkëpunojnë me qendrat për punë sociale (24 komuna), dhe së fundmi, 26 organizata të Kryqit të Kuq (27 komuna).



2.5. Në vijim, rezultatet tregojnë një përmbledhje të shërbimeve sociale për fëmijë, të cilat i posedojnë qendrat dhe për të cilat kanë nevojë qendrat.


nuk është konsistent, kështu që të dhënat e mbledhura konsiderohen të paplota.




2.10. 1. Counseling services for children with behavioral problems and their parents

Lidhur me nevojën për shërbime këshillimi për fëmijët me probleme të sjelljes dhe prindërit e tyre, nga 34 QPS që u përgjigjën, 18 QPS (50%) raportuan se nuk ekziston një shërbim i tillë, por që ekziston një nevojë e madhe për të; 11 QPS (30.5%) raportuan se ky shërbim këshillimor siç është këshillimi për familjet në nevojë ekziston, por nuk është i mjaftueshëm; 2 QPS (5.5%), raportojnë se shërbimi ekziston dhe është i mjaftueshëm; ndërsa vetëm 1 QPS (2.7%) raportuan se ky shërbim këshillimor nuk ekziston dhe nuk është i nevojshëm.

Për më tepër, në shërbimet e kujdesit shtëpiak, nga 34 QPS që u përgjigjën, 21 QPS (58.33%) raportuan se një shërbim i këtij lloji nuk ekziston, por është jashtëzakonisht i nevojshëm; 5 QPS (13.9%), raportojnë se shërbimi ekziston por nuk është i mjaftueshëm; për 3 QPS (8.3%), ky shërbim as nuk ekziston dhe as nuk është i nevojshëm; dhe vetëm 1 QPS (2.7%) raportoi se shërbimi i kujdesit në shtëpi ekziston dhe është i mjaftueshëm.




2.10. 2. Home care



2.10. 3. Care of daily stay for children in need


Shërbimi i tretë për të cilin u pyetën drejtorët e qendrave përkatëse janë shërbimet e kujdesit ditor për fëmijët në nevojë. Nga 31 QPS të cilët u përgjigjën në këtë pyetje, 21 QPS (37.7%) u përgjigjën se një shërbim i tillë nuk ekziston në qendrën e tyre, por është i nevojshëm; 7 QPS (21.6%) kanë raportuar se shërbimi ekziston por nuk është i mjaftueshëm; ndërsa 3 QPS (9.1%) raportuan se shërbimi nuk ekziston dhe nuk është i nevojshëm.



2.10. 4. Supported housing for children with disabilities or children without parental care (eg small communities such as dormitories)

Kur u pyetën në lidhje me shërbimet që ofrojnë strehim të mbështetur për fëmijët me aftësi të kufizuara ose fëmijët pa kujdes prindëror, nga 29 QPS të cilët u përgjigjën, 20 (68.9%) QPS raportuan se shërbimi nuk ekziston por është i nevojshëm; 4 QPS (13.8%) raportuan se shërbimi nuk ekziston dhe nuk është i nevojshëm; 3 QPS (10.3%) raportojnë se shërbimi ekziston në qendrën e tyre por nuk është i mjaftueshëm; dhe vetëm 1 QPS (3.4%) raporton se shërbimi ekziston dhe është i mjaftueshëm.


Së fundmi, janë analizuar shërbimet shtesë arsimore të ofruara për fëmijët në nevojë. Nga 30 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 16 QPS (53.3%) raportuan se shërbimi nuk ekziston dhe është i nevojshëm; 12 QPS (40%) raportojnë se shërbimi ekziston por nuk është i mjaftueshëm; dhe vetëm 2 QPS (6.7%) kanë treguar që shërbimi nuk ekziston dhe nuk është i nevojshëm.



2.10. 5. Additional educational services for children in need


3. Infrastruktura, pajisjet teknike dhe logjistike të QPS-së

3.1. Pjesa e tretë e pyetësorit përbëhej nga analiza e infrastrukturës, pajisjeve teknike dhe logjistike të QPS-ve. Nga 31 QPS që janë përgjigjur në këtë pyetje, 18 QPS (54.8%) operojnë në ndërtesën e cila është në pronësi të QPS; 11 QPS (35.5%) kryejnë aktivitetet e tyre në ndërtesën e cila është në pronësi të komunës; 2 QPS (6.1%) punojnë në një ndërtesë me qira; ndërkohë, 2 (3.2%) prej tyre operojnë në një zyrë të vogël.




3.1. The building in which the CSW operates is:

3.2. Ndërtesat e 18 prej 31 QPS-ve (58.1%) janë të vendosura në qendër të qytetit/komunës; 10 QPS (29%) operojnë në ndërtesa që janë në qendrën më të gjerë të qytetit/komunës; dhe 5 QPS (12.9%) operojnë në ndërtesa të vendosura larg qendrës së qytetit/komunës.




3.2. The building in which the CSW operates is located at:

3.3. Më tej, nga 32 QPS që iu përgjigjën kësaj pyetjeje, 22 QPS (65.6%) raportuan se ndërtesa ku ata veprojnë është pjesërisht e pajisur teknikisht (kanë zyra dhe telefona, por jo kompjuterë dhe internet; 10 QPS (28.1%) punojnë në ndërtesa që janë të pajisura plotësisht teknikisht dhe 2 QPS (6.3%) operojnë në ndërtesa që nuk kanë kushte teknike.



3.3. The building in which the CSW operates is:

3.4. Ndërkohë, kur u pyetën në lidhje me posedimin e automjeteve për të kryer punë në terren, nga 34 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 22 QPS (68.8%) raportuan se ata i posedojnë automjetet e tyre; 7 QPS (18.8%) raportuan gjetjen e mënyrave të tjera të transportit, marrjes me qira ose përdorimit të automjeteve të ofruara nga komuna; dhe 5 QPS (12.5%) raportuan se nuk posedojnë asnjë mjet transporti për të dalë në terren.



3.4. To perform field work CSW has vehicles:

3.5. Mundësia e qasshmërisë të QPS-ve për punë me fëmijë dhe familjet e tyre është e ndryshme në komuna të ndryshme, por ekziston një nevojë e madhe për përmirësim, pasi të dhënat tregojnë si më poshtë:

Niveli i qasshmërisë	Nr. i QPS-ve të raportuara
1. Plotësisht e qasshme për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara	13
2. Pjesërisht e qasshme për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara	16
3. Dhoma të veçanta për seanca psikologjike me fëmijë	11
4. Dhoma të veçanta për seanca psikologjike me çifte/terapi familjare	3
5. Ka hapësirë/dhoma për aktivitete me fëmijë	11
6. Pajisur me hapësirë të mjaftueshme për trajnim profesional me stafin	5

Dhoma e arritshme si dhe dhoma e veçantë e pajisur për punë me fëmijë janë parakushti kryesor për të punuar me fëmijët më të pafavorizuar, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.


4. Struktura e punonjësve të QPS-ve sipas arsimit, gjinisë dhe moshës

4.1. Kjo pjesë përfshin të dhëna për strukturën e punonjësve të QPS në lidhje me moshën dhe pozicionin profesional të tyre në QPS.

Nga 34 QPS dhe 372 punonjës, pozitat e Stafit Menaxherial përfshijnë: 1 punonjës nga 20-29 vjeç (grua), 15 punonjës nga 30-40 vjeç (9 burra dhe 6 gra), 13 punonjës nga 40-49 vjeç të moshuar (9 burra dhe 4 gra), 26 punonjës të moshës 50-59 (19 burra dhe 7 gra), 14 punonjës të moshës 60-64 (13 burra dhe 1 grua) dhe asnjë punonjës mbi moshën 65 vjeç.

Pozitat e Zyrtarëve të Shërbimeve Sociale përfshijnë: 15 punonjës të moshës 20-29 vjeç (5 burra dhe 10 gra), 63 punonjës të moshës 30-40 vjeç (23 burra dhe 40 gra), 37 punonjës të moshës 40-49 vjeç (11 burra dhe 26 gra), 45 punonjës të moshës 50-59 vjeç (20 burra dhe 25 gra), 31 punonjës të moshës 60-64 vjeç (19 burra dhe 12 gra), dhe asnjë punonjës mbi moshën 65 vjeç.

4.1. Struktura e punonjësve të QPS-ve lidhur me moshën dhe pozitën e tyre profesionale në QPS										
Moshë	Pozita profesionale në QPS									Gjithsej
	Stafi Menaxherial		Zyrtar i shërbimeve sociale		Administratë		Stafi teknik			
	M	F	M	F	M	F	M	F		
Deri në moshën 29 vjeç	0	1	5	10	0	0	1	1		18
30 – 40	9	6	23	40	4	11	3	4		99
40 – 49	9	4	11	26	11	4	6	5		76
50 – 59	19	7	20	25	9	14	2	9		105
60 – 64	13	1	19	12	17	7	2	3		74
65+	0	0	0	0	0	0	0	0		0
GJITHSEJ	50	19	78	112	41	36	14	22		372



4.2. Nga të gjithë zyrtarët e shërbimit social në 34 QPS, 46 prej tyre janë me formim akademik në punë sociale, 18 prej tyre në psikologji, 24 në pedagogji, 36 në sociologji, 62 në juridik dhe 7 janë të profileve të tjerë si Ekonomi, Shkenca Politike dhe Biologji. Për një mbrojtje më të fuqishme të fëmijëve, është e nevojshme të kenë më shumë staf profesional me formim akademik në pedagogji, punë sociale dhe psikologji.

5. Numri dhe lloji i përgjithshëm i rasteve të shqyrtuara dhe shërbimeve të ofruara nga QPS-të çdo vit

5.1. **Numri i rasteve të shqyrtuara nga QPS-të gjatë vitit 2019** ishte gjithsej 34986 raste. Nga këto, shumica, d.m.th. 23453 ishin raste të lidhura me asistencën sociale - përfitues të skemave sociale, 8456 ishin çështje që kishin të bënin me fëmijët, nga të cilat 1669 raste kishin të bënin me fëmijët me aftësi të kufizuara, 1408 raste kishin të bënin me fëmijët me probleme të sjelljes dhe 2863 raste të fëmijëve që vijnë nga familje jofunksionale. Kur u pyetën për të sqaruar këto të dhëna, zyrtarët e shërbimeve sociale shpjeguan se, në një farë mënyre, më shumë se gjysma e të gjitha rasteve me të cilat kishin punuar gjatë vitit 2019 janë të lidhura me fëmijë (vetëm ata që janë të lidhur me të moshuarit nuk janë) por nuk është e lehtë të klasifikohen në dokumentacion.

5.2. Lidhur me sigurimin e përfitimeve materiale, 23 nga 34 QPS kanë raportuar se ofrojnë ndihmë të tillë, dhe një total prej kësaj ndihme për këto 23 QPS arrin në 11,184 euro²⁷.

5.3. Rezultatet e fituara për numrin e shërbimeve sociale të ofruara dhe numrin e qendrave që ofrojnë këto shërbime nuk mund të merren si të rëndësishme për shkak të informacionit jo të besueshëm që ka marrë QPS.

²⁷ Sidoqoftë, përgjigjet në këtë pyetje konsiderohen statistikisht jo të vlefshme, prandaj nuk duhet të merren parasysh.

6. Kapacitetet profesionale dhe zhvillimi profesional i punonjësve në QPS

6.1. Numri i shërbimeve sociale nga zyrtarët e shërbimit social dhe bashkëpunëtorët që punojnë me fëmijë dhe të rinj arrin në 938 shërbime gjithsej, për 26 QPS.

6.2. Vizitat mujore nga zyrtarët e shërbimeve sociale arrijnë në një mesatare prej 4.14 vizitash në muaj, për 28 QPS, që është shumë më tepër sesa kërkohet ligjërisht një herë në muaj. Sidoqoftë, kjo është e ndryshme për raste specifike p.sh. jo i mjaftueshëm, veçanërisht jo në rast të dhunës në familje ose neglizhencës, por edhe në çdo rast tjetër të fëmijëve në nevojë për mbrojtje emergjente.

6.3. Situata në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të shërbimeve sociale duhet të hulumtohet në të ardhmen me analizë të detajuar të nevojave për trajnim; nga 34 QPS të cilët u përgjigjën në pyetësor, 26 QPS raportuan se gjatë tre viteve të fundit ishin organizuar 152 trajnime dhe seminare, me numrin e përgjithshëm të 109 punonjësve të trajnuar. Sidoqoftë, ekziston një nevojë e madhe për shumë më shumë trajnime dhe shumë më shumë punonjës të përfshirë në zhvillimin profesional për zyrtarët e shërbimeve sociale.

Disa nga programet e trajnimit që janë raportuar nga QPS janë: "Fëmijët në situatë rruge", "Abuzimi i fëmijëve", "Dhuna në familje", "Strehimi familjar", "Mbrojtja e fëmijëve", "Trafikimi i qenieve njerëzore", "Të miturit në konflikt me ligjin", "Roli i qendrave për punë sociale dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të mbrojtjes sociale në zbatimin e mesazheve arsimore", "Trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta", "Kujdesi dhe zhvillimi i fëmijëve në fëmijërinë e hershme", "Fuqizimi i stafit profesional të QPS-së për punë me fëmijë dhe të rinj në kundërshtim me ligjin", "Veprimet e qendrave për punë sociale në organizimin e ndihmës dhe mbështetjes së familjes në rastet e rrezikut të zhvendosjes së fëmijëve", dhe shumë të tjerë.

Siç është raportuar nga përgjegjësit, zbatuesit ose trajnuesit më të shpeshtë janë: Terre des Hommes, GIZ, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, KIPA, OFAP, Save the Children, HANDIKOS, Medica, KOMPf, OSBE, MPMS, MASH, dhe trajnerë të tjerë individualë.

Shumica e trajnimeve zgjatën nga 3 ditë (50%), trajnimet e tjera kishin një kohëzgjatje prej 2 ditësh (25%), dhe 25% e tyre i përkasin kohëzgjatjeve të tjera (1 ditë, 5 ditë, etj.).

QPS-të kanë raportuar për nevojën e tyre për forma të tjera të zhvillimit profesional në fushën e të drejtave të fëmijëve si më poshtë:

Forma të tjera të zhvillimit profesional në fushën e të drejtave të fëmijëve	Nr. i QPS-ve të raportuara nga 34 QPS
Nevoja për mbikëqyrje	12
Nevoja për mentorim	16
Nevoja për mbështetje teknike	11
Nevoja për analizë/matje të nevojave specifike të trajnimit	13
Nevoja për diçka tjetër dhe shumica e tyre përfshijnë mbështetje ose ndihmë materiale	11

Është shumë e rëndësishme të theksohet se 17 QPS të cilët raportuan nevojat për forma të tjera të zhvillimit profesional në fushën e të drejtave të fëmijëve kanë nevojë për një mbështetje në matjen e nevojave specifike të trajnimit.

Qendrat gjithashtu raportuan trajnime për të cilat kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Disa nga këto trajnime janë:

- "Mbrojtja e fëmijëve",
- "Fëmijët dhe puna e madhe",
- "Braktisja",
- "Komunikimi me fëmijët"

- "Identifikimi i abuzimit të fëmijëve"
- "Kontakti me prindër të ndarë",
- "Intervista me fëmijë",
- "Aspekti emocional i fëmijërisë",

7. Bashkëpunimi i QPS-ve me akterë të tjerë në komunitet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Gjatë raportimit mbi shpeshësinë dhe cilësinë e bashkëpunimit për mbrojtjen e fëmijëve në nivelin lokal, QPS-të kanë raportuar se bashkëpunimi më i mirë është ndërmjet sistemit të kujdesit social, me institucione të tjera sociale, përfshirë OJQ-të që merren me fëmijë. Duhet të merret në konsideratë se ka rreth 12% të QPS-ve që kanë bashkëpunim të suksesshëm me administratat e tyre lokale.

Rezultatet e mëposhtme dëshmojnë për nivelin/cilësinë e bashkëpunimit ndërmjet QPS-ve dhe akterëve të tjerë.

7.1. Bashkëpunimi me qeverinë lokale - Nga 34 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 12 QPS (35.3%) raportuan bashkëpunimin me qeverinë lokale si shumë të suksesshëm, 16 QPS (47.1%) raportuan bashkëpunim kryesisht të suksesshëm, 2 QPS (5.9%) raportuan se ata nuk e dinë natyrën e këtij bashkëpunimi dhe 4 QPS (11.8) prej tyre raportuan këtë bashkëpunim si kryesisht të pasuksesshëm.

7.2. Bashkëpunimi me ministritë - Nga 32 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 8 QPS (23.5%) e përshkruajnë bashkëpunimin me ministritë si shumë të suksesshëm, 21 QPS (65.6%) e përshkruajnë këtë bashkëpunim si kryesisht të suksesshëm, ndërsa 3 QPS (9.3%) e përshkruajnë si e të pasuksesshëm.

7.3. Bashkëpunimi me institucionet arsimore - Nga 30 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 14 QPS (46.7%) e kanë konsideruar këtë bashkëpunim si shumë të suksesshëm, 12 QPS (40.0%) kryesisht të suksesshëm, 2 QPS (6.7%) raportuan se nuk e njohin natyrën e këtij bashkëpunimi dhe 2 QPS (6.7%) si kryesisht të pasuksesshëm.

7.4. Bashkëpunimi me institucionet e kujdesit mjekësor - Nga 29 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 14 QPS (48.3%) e konsideruan këtë bashkëpunim si shumë të suksesshëm, 14 QPS (48.3%) e konsideruan atë kryesisht të suksesshëm dhe vetëm 1 QPS (3.4%) e konsideroi si kryesisht të pasuksesshëm.

7.5. Bashkëpunimi me gjyqësorin - Nga 31 QPS që janë përgjigjur në këtë pyetje, 8 QPS (25.8%) e konsiderojnë këtë bashkëpunim si shumë të suksesshëm, 21 QPS (67.7%) e konsiderojnë atë kryesisht të suksesshëm, dhe 2 QPS (6.5%) e konsiderojnë atë si kryesisht të pasuksesshëm.

7.6. Bashkëpunimi me institucionet e kujdesit social - Nga 18 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 7 QPS (38.9%) e konsiderojnë bashkëpunimin me këto institucione si shumë të suksesshëm, 7 QPS (38.9%) e konsiderojnë kryesisht të suksesshëm, 3 QPS (16.7%) nuk e dinë natyrën e këtij bashkëpunimi dhe 1 QPS (5.6%) e konsideron atë si shumë të pasuksesshëm.

7.6.1. Bashkëpunimi me institucionet për fëmijët pa kujdes prindëror - Nga 30 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 11 QPS (36.7%) e përshkruajnë bashkëpunimin si shumë të suksesshëm, 14 QPS (46.7%) si kryesisht të suksesshëm, 4 QPS (13.3%) nuk e njohin natyrën e bashkëpunimit dhe 1 QPS (3.3%) si të pasuksesshëm.

7.6.2. Bashkëpunimi me institucionet për fëmijët me aftësi të kufizuara - Nga 30 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 9 QPS (30%) e konsiderojnë atë shumë të suksesshëm, 12 QPS (40%) si kryesisht të suksesshëm, 6 QPS (20%) raportuan se nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit, 2 QPS (6.7%) e konsiderojnë atë kryesisht të pasuksesshëm, dhe 1 QPS (3.3%) e përshkruan këtë bashkëpunim si shumë të pasuksesshëm.

7.6.3. Bashkëpunimi me institucionet për fëmijët me probleme të sjelljes - Nga 30 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 6 QPS (20%) e konsiderojnë atë shumë të suksesshëm, 10 QPS (33.3%) si kryesisht të suksesshëm, 7 QPS (23.3%) raportuan se ata nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit, 1

QPS (3.8%) e përshkruan atë kryesisht të pasuksesshëm, dhe 2 QPS (7.7%) e përshkruajnë këtë bashkëpunim si shumë të pasuksesshëm.

7.6.4. Bashkëpunimi me familjet strehuese - Nga 31 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 20 QPS (64.5%) e konsiderojnë atë shumë të suksesshëm, 8 QPS (25.8%) kryesisht të suksesshëm, 1 QPS (3.2%) raportoi se nuk e di cilësinë e bashkëpunimit, 1 QPS (3.2%) e përshkruan atë kryesisht të pasuksesshëm, dhe 1 QPS (3.2%) e përshkruan këtë bashkëpunim si shumë të pasuksesshëm.

7.6.5. Bashkëpunimi me qendrat e kujdesit ditor të fëmijëve me aftësi të kufizuara - Nga 26 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 8 QPS (30.8%) e konsiderojnë atë shumë të suksesshëm, 8 QPS (30.8%) kryesisht të suksesshëm, 6 QPS (23.1%) raportuan se ata nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit, 2 QPS (7.7%) e konsiderojnë atë kryesisht të pasuksesshëm, dhe 2 QPS (7.7%) e konsiderojnë këtë bashkëpunim si shumë të pasuksesshëm.

7.6.6. Bashkëpunimi me QPS-të tjera - Nga 32 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 18 QPS (56.3%) e konsiderojnë atë shumë të suksesshëm, dhe 14 QPS (43.8%) e konsiderojnë atë kryesisht të suksesshëm.

7.7. Bashkëpunimi me prokurorët - Nga 26 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 10 QPS (38.5%) e konsiderojnë bashkëpunimin shumë të suksesshëm, 11 QPS (42.3%) kryesisht të suksesshëm, 2 QPS (7.7%) raportuan se nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit dhe 3 QPS (11.5%) e vlerësojnë atë si kryesisht të pasuksesshëm.

7.8. Bashkëpunimi me OJQ-të që punojnë me fëmijët dhe për ta - Nga 29 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 8 QPS (27.6%) e konsiderojnë bashkëpunimin shumë të suksesshëm, 15 QPS (51.7%) si kryesisht të suksesshëm, 4 QPS (13.8%) raportuan që ata nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit, 1 QPS (3.4%) e konsideron atë kryesisht të pasuksesshëm, dhe 1 QPS (3.4%) e përshkruan këtë bashkëpunim si shumë të pasuksesshëm.

7.9. Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq - Nga 30 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 11 QPS (34.4%) e konsiderojnë bashkëpunimin shumë të suksesshëm, 11 QPS (34.4%) kryesisht të suksesshëm, 6 QPS (18.8%) raportuan se nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit, 1 QPS (3.1%) e përshkruan atë si kryesisht të pasuksesshëm, dhe 3 QPS (9.4%) e vlerësojnë këtë bashkëpunim si shumë të pasuksesshëm.

7.10. Bashkëpunimi me mediat - Nga 29 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 2 QPS (6.9%) e konsiderojnë bashkëpunimin shumë të suksesshëm, 14 QPS (48.3%) si kryesisht të suksesshëm, 11 QPS (37.9%) raportuan se nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit, dhe 2 QPS (6.9%) e vlerësojnë atë kryesisht të pasuksesshëm.

7.11.11. Bashkëpunimi me institucionet e tjera (kryesisht me policinë) - Nga 16 QPS që u përgjigjën në këtë pyetje, 10 QPS (62.5%) e konsiderojnë bashkëpunimin shumë të suksesshëm, 4 QPS (25%) kryesisht të suksesshëm dhe 2 QPS (12.5%) raportuan se ata nuk e dinë cilësinë e bashkëpunimit.

8. Nevojat për përmirësim të mëtejshëm të QPS-ve në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

8.1. Lidhur me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, kur u pyetën **nëse e kanë emëruar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve**, 3 QPS nga 34 (8.3%) raportuan pozitivisht se e kanë emëruar këtë zyrtar, 12 QPS nga 34 (33.3%) raportuan që nuk kanë emëruar akoma por kanë planifikuar dhe 19 QPS nga 34 (52.8%) kanë raportuar se nuk e kanë emëruar zyrtarin. Sa për arsyen se pse ata ende nuk e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, 19 nga 34 QPS (52.7%) kanë dhënë si arsye faktin se ata nuk kanë numër të mjaftueshëm të punonjësve.

8.2. Sa për arsyen pse ata ende nuk kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, 13 nga 34 QPS (51.9%) kanë dhënë si arsye faktin se ata nuk kanë numër të mjaftueshëm të punonjësve.

8.3. Në fund, janë analizuar **opinionet e drejtorëve të QPS-ve mbi atë që duhet bërë për të përmirësuar më tej QPS-të në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**. Gjithsej 26 nga 34 QPS (72, 2%) raportuan se numri i të punësuarve në QPS për punën me fëmijë dhe të rinj duhet të rritet. Ajo që është shumë e rëndësishme të theksohet është që shumica e tyre e njohin nevojën për një numër më të madh trajnimesh për punonjësit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve si një bazë për zhvillimin e kujdesit të ardhshëm të fëmijëve. Gjithashtu, 25 nga 34 QPS (69.4%) njohin rëndësinë e bashkëpunimit midis të gjithë akterëve socialë në komunitet për të mirën e fëmijëve dhe i shohin fushatat e përqendruara tek fëmijët dhe të drejtat e tyre si një nga mjetet që mund të kontribuojnë në opinionin publik duke ngritur kuptimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të fëmijëve në mesin e popullatës së përgjithshme, veçanërisht duke rritur ndërgjegjësimin në lidhje me fëmijët nga grupet më të pafavorshme.

6. INTERVISTAT ME DREJTORËT KOMUNAL TË MIRËQENJES SOCIALE²⁸

Mënyrat aktuale të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në komunë

Intervistat përmes pyetësorëve gjysmë të strukturuar u zhvilluan me nëntë drejtorë komunalë për mirëqenie sociale (DMQ) dhe një zyrtar komunal për të drejtat e njeriut në (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Lipjan, Podujevë, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Mitrovicë). Intervista u organizua duke u përqendruar në katër shtylla kryesore që konsistojnë në:

1. *Kuadrin organizativ në komunë për mbrojtjen e fëmijëve,*
2. *Kompetencat profesionale të punonjësve në komunë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve,*
3. *Bashkëpunimin në komunitetin lokal në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve,*
4. *Rregullimin normativ të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në komunë.*

Proporcioni gjinor i DMQ-ve të intervistuar: 6 burra dhe 4 gra. Arsimi: 3 me diplomë bachelor dhe 6 me diplomë Master. Profesioni: Avokat (3 drejtorë), Ekonomistë (3 drejtorë) dhe Mjekë (3 drejtorë). Me përvojë pune duke filluar nga 5 vite ishin 3 drejtorë; Përvojë 15 vjeçare kanë pasur 2 drejtorë dhe 20 vite përvojë kanë pasur 4 drejtorë.

1. Kuadri organizativ në komunë me rëndësi për mbrojtjen e fëmijëve

Ekzistojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet drejtorëve të intervistuar në lidhje me perceptimin e parakushteve minimale që duhet të sigurohen në komunë në mënyrë që të ketë kapacitete të mjaftueshme për t'iu përkushtuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Në pyetjet ndihmëse DMS-ja mendon se përgjegjësitë më të rëndësishme të departamenteve komunale në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përcaktohen nga legjislativi i qeverisjes lokale dhe ligjet që rrjedhin nga MPMS-ja, që përcaktojnë rolin dhe përgjegjësinë e komunës dhe QPS-së. Ata zakonisht citojnë ligjet dhe se veprimet e tyre janë në përputhje me legjislativin. Sido-

²⁸ Përmbajtja dhe kronologjia e intervistave u bazuan gjithashtu në ligjin e ri për mbrojtjen e fëmijëve dhe rolin specifik të komunës siç përcaktohet në nenin 14 të ligjit: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Gjithashtu Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare neni 6 i ligjit: <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200909133926Ligji%20per%20Urdherin%20e%20punonjesve%20social.pdf>

qoftë, kjo ishte vetëm në aspektin administrativ të përgjegjësisë, kur diskutohej një analizë më e thellë e përgjegjësisë të mbrojtjes së fëmijëve, informacionet e marra nuk ishin të plota, mungonin detajet nga strategjitë e implementuara komunale dhe projektet e implementuara, kishte informacion të fragmentuar për numrin dhe kategoritë e fëmijëve në rrezik dhe njohuri të shpërndara për planifikimin dhe alokimin buxhetor specifik për veprimet e mbrojtjes së fëmijëve. Nuk kishte informacion të qartë për numrin e fëmijëve të arritur me projekte komunale në 3 vitet e fundit.

Në shumicën e rasteve, duke përfshirë disa komuna më të mëdha (Prishtinë, Prizren, Gjilan), DMS-ja konsideron se komuna nuk ka një strukturë të përshtatshme organizative dhe nuk mund të përbushë gjithmonë funksionin me numrin ekzistues të profesionistëve në komunën e tyre. Arsyet janë kryesisht për shkak të numrit të vogël të personelit, kryesisht me detyra administrative siç përcaktohet në përshkrimin e tyre të punës. Buxhet është i kufizuar për punësimin e më shumë personeli dhe implementimin e projekteve. Personel jo i specializuar në mirëqenien sociale (zakonisht me përgatitje juridike, ekonomike dhe shëndetësore). Si dhe mungesa e vullnetit politik për të investuar në mirëqenien sociale (në nivelin komunal).

DMS-ja e konsideron QPS-në si institucionin kryesor që ka detyrim në komunë të merret me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Komuna dhe stafi komunal në DMS konsiderojnë që detyrat e tyre janë kryesisht të mbështesin dhe monitorojnë në disa raste, ofrimin e udhëzimeve dhe jo të përfshihen në sfidat e përditshme brenda rasteve të QPS-së. Sidoqoftë DMS-ja konsideron që ata janë përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e projekteve më të mëdha siç janë: sigurimi i programeve të strehimit kolektiv dhe strehimi për familjet dhe individët në vështirësi socio-ekonomike, identifikimi dhe sigurimi i fondeve për OJQ-të lokale që ofrojnë shërbime të ndryshme sociale të blera përmes projekteve të financuara (nëse dhe kur është në dispozicion një buxhet modest për një financim të tillë të projekteve). Fatkeqësisht, këto projekte janë planifikuar dhe zbatuar me shumë pak ose aspak koordinim me QPS. Komuna është gjithashtu e përfshirë në situata emergjente siç ishte rasti me pandeminë Covid-19 me sigurimin e paketave emergjente për grupet më të rrezikuara (përsëri me shumë pak koordinim me QPS-në).

DMS-të e shohin rolin e tyre kryesisht në koordinimin e veprimeve të mirëqenies sociale në nivelin komunal, duke parë QPS-në si mekanizmin e tyre kryesor të ofrimit të shërbimeve (kryesisht tryeza të rrumbullakëta multidisiplinare për mbështetje në menaxhimin e çështjeve (TMR). Në disa raste, DMS-të janë përfshirë gjithashtu me ndërhyrje specifike në lidhje me arsimin, shëndetësinë dhe ndërhyrjet e zbatimit të ligjit dhe projekte që lidhen me masat e mbrojtjes së fëmijëve në nivelin komunal. Në këtë drejtim, në komuna janë krijuar organe dhe mekanizma të ndryshëm koordinues ndërmjet agjencive (në shumicën e rasteve të përfaqësuara nga QPS-të), por në shumicën e komunave ato janë rrallë funksionale dhe në disa komuna më të vogla nuk ekzistojnë. Ka mungesë në regresin koordinues në veprimet në kohë dhe gjithëpërfshirëse për masat e mbrojtjes së fëmijëve.

2. Kompetencat profesionale të punonjësve në komunë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Perceptimi i përgjithshëm i drejtorëve komunalë të intervistuar për mirëqenien sociale në vlerësimin e njohurive ekzistuese, aftësive dhe qëndrimeve të profesionistëve në komunë, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kategorizohet si i nivelit të dobët deri te i mesëm.

Konsiderohet se ka shumë pak profesionistë të komunave, të trajnuar mjaftueshëm për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Ky është rasti në shumicën e komunave që kanë një drejtor të integruar për shëndetin dhe mirëqenien sociale, ku zakonisht përparësi i jepet komponentit shëndetësor. Ka kufizime në numrin e personelit të angazhuar posaçërisht për aspektin e mirëqenies sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, personeli shpesh është në moshë të thyer dhe i pamotivuar për shkak të pagave të vogla që janë në përgjithësi në nivelin komunal në krahasim me nëpunësit e tjerë civilë. Personeli komunal ka kryesisht profil administrativ të përshkrimit të punës. Në disa komuna nuk kishte prova të qarta të planifikimit periodik. Menaxhimi i stafit përdor metodologjinë e vjetruar të strukturave organizative dhe funksionimit. Buxhet i alokuar i kufizuar për projekte më të mëdha dhe blerje të shërbimeve (buxheti specifik ekzistues për masat e mbrojtjes së fëmijëve). Ndarja akoma e paqartë e detyrave ndërmjet MPMS-së, Komunës dhe QPS-së.

Për të ndryshuar këtë situatë, drejtorët e DMS-ve, sugjerojnë që të ndërmerren hapa rrënjësorë në ri-organizimin dhe funksionalizimin e reformave për të adresuar kufizimet e sipërpërmendura. Veçanërisht me rritjen dhe përcaktimin e qartë të buxhetimit të mirëqenies sociale (përfshirë linjën specifike të buxhetimit për mbrojtjen e fëmijëve). Rritja e numrit të stafit profesional dhe ofrimi i trajnimeve profesionale për personelin ekzistues nga MPMS-ja dhe donatorët (kapacitetet e plota të burimeve njerëzore dhe sigurimi i ndërhyrjeve cilësore dhe në kohë në lidhje me veprimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe nevojat e grupeve të cenushme të fëmijëve). Financimi dhe funksionalizimi i tryezave të rrumbullakëta multidisiplinare për mbështetjen në menaxhimin e çështjeve (TMR)

3. Bashkëpunimi në komunitetin lokal në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Drejtorët komunalë të mirëqenies sociale tregojnë se ekziston një bashkëpunim solid me të gjithë akterët socialë në komunitet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kryesisht përmes tryezave të rrumbullakëta multidisiplinare për mbështetjen në menaxhimin e çështjeve (TMR).

Prapëseprapë, në këtë kontekst DMS-ja e sheh QPS-në si institucionin kryesor përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe organizimin e mekanizmave të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet akterëve të ndryshëm. Ekzistojnë disa struktura koordinuese të organizuara në komuna: Tryeza të Rrumbullakëta Multidisiplinare për Mbështetjen në Menaxhimin e Rasteve (TMR), komisioni për të drejtat e fëmijëve, grupi punues për parandalimin e dhunës në shkollë, grupi punues për parandalimin dhe ri-integrimin e fëmijëve që braktisin shkollën, grupet punuese komunale që synojnë personat me aftësi të kufizuara, 'Trezat e Rrumbullakëta Komunale për Menaxhimin e Rasteve' dhe mekanizmat e tjerë ndryshojnë nga komuna në komuna. Në shumicën e këtyre strukturave, DMS-të nuk kanë një rol udhëheqës. Në shumicën e rasteve institucionet ose drejtoritë e tjera kanë rol udhëheqës. DMS-ja zakonisht është vetëm si pjesëmarrës dhe ose në shumë raste përfaqësohet vetëm nga QPS-ja.

Shumë nga këto grupe pune janë iniciuar nga projekte të financuara nga ndërkombëtarët dhe agjencitë donatore. Pothuajse të gjitha grupet e krijuara të punës në komuna mbeten të varura nga donatorët dhe funksionale vetëm gjatë jetës së projekteve. Nuk ka financim dhe koordinim të qëndrueshëm pas përfundimit të projekteve dhe largimit të donatorëve pasi që nuk ka fonde të vazhdueshme të alokuara nga komuna dhe as marrje përsipër të duhur nga drejtoritë komunale. Drejtoritë e arsimit në një farë mase është më aktive dhe ka vendosur dy mekanizma në nivelin lokal: njëri '*kundër dhunës në shkollë*' dhe tjetri që lidhet me '*braktisjen e shkollës*'. Këto dy grupe pune përbëhen nga përfaqësues multidisiplinare dhe multi-agjencish duke përfshirë DMS-të dhe QPS-të (zakonisht të përfaqësuar nga QPS-të). Këto dy grupe pune në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në sektorin e arsimit janë gjithashtu të mandatuar ligjërisht me rregullore administrative nga Ministria e Arsimit.

Ligji i fundit për mbrojtjen e fëmijëve kërkon qartë krijimin e një strukture komunale që do të menaxhojë dhe koordinojë veprimet për rastet komplekse të fëmijëve në nevojë: Trezat e Rrumbullakëta Multidisiplinare për Mbështetjen në Menaxhimin e Rasteve (TMR). Gjithashtu, ndër të tjera në ligj kërkohet që secila komunë të punësojë dhe të emërojë një punonjës të caktuar që do të jetë përgjegjës për të gjitha veprimet e mirëqenies sociale në komunë dhe pikë qendrore për QPS për të gjithë rastet e lidhura me fëmijë.²⁹ Në të gjitha komunat që u vizituan asnjë nga veprimet e kërkuara nga ligji për mbrojtjen e fëmijëve nuk kanë ndodhur dhe nuk ka ndonjë tregues të qartë se kur do të fillojë ky proces.

4. Rregullimi normativ i promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Nga intervistat me drejtorët e DMS-ve, ka indikacione se strukturat komunale që janë të përfshira drejtpërdrejt në mbrojtjen e fëmijëve janë të strukturuar mirë por jo gjithmonë plotësisht funksionale dhe nuk ofrojnë përpjekje gjithëpërfshirëse, të larmishme dhe të qëndrueshme për të krijuar një mjedis të sigurt për fëmijët në komunë.

Ekzistojnë stimulime të kënaqshëm legjislativ për strukturimin dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes për fëmijët në nevojë. Sidoqoftë, zbatimi shpesh pengohet nga mungesa e stafit, mungesa e

²⁹ Nenet: 14, 15, 20, 21, 24, 31 dhe 35 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

qasjes profesionale dhe metodologjive të vjetruara në analizën e nevojave, planifikimin dhe sigurimin e shërbimeve, si dhe buxhetin e kufizuar të alokuar për mirëqenien sociale.

Edhe pse raportet ndërkombëtare mbi fuqinë punëtore të punës sociale³⁰ tregojnë trendin që vendet e punës në punës sociale do të rriten për 11.5% ndërmjet 2014 dhe 2024, DMS-të e intervistuar nuk e ndajnë këtë perspektivë.

7. DISKUTIMET KRYESORE TË FOKUS GRUPEVE MBI SHËRBIMET PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Tri fokus grupe u organizuan në rajone të ndryshme të Kosovës. Një në Prizren, Prishtinë dhe një me QPS-në që përfaqëson komunat me shumicë serbe (Virtualisht-përmes internetit). Në fokus grupe kanë marrë pjesë: zyrtarë të shërbimit social dhe drejtorë të QPS-ve me 6-8 pjesëmarrës për një grup të fokusit. Tema e diskutimit ishte vendosur në tre tema kryesore: a) Perceptimi i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve të ofruara nga QPS-ja; b) Sfidat në shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve të ofruara nga QPS-ja dhe koordinimi i partneritetit; dhe c) Rekomandim për modifikim në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve në QPS (çfarë duhet të ndryshojë dhe nga kush). Koha ishte 60 minuta për secilin grup dhe mbajtur në 8 dhe 9 shtator 2020.

Pjesëmarrësit treguan se ekzistojnë mbi 25 shërbime të ndryshme që u ofrohen fëmijëve nga QPS-ja³¹. Shumica e shërbimeve janë të rregulluara mirë dhe të strukturuar me udhëzime të qarta legjislative dhe sqarime të mëtejshme ofrohen me dokumente të standardeve minimale dhe dokumentacion tjetër administrativ përkatës. Ekziston gjithashtu një procedurë e dokumentuar qartë për secilin veprim të ndërmarrë dhe të depozituar në kopje fizike dhe elektronike në bazën qendrore të të dhënave. Shërbimet janë kryesisht këshillime dhe referime tek ofruesit e tjerë të shërbimeve (publiku dhe OJQ-të). Gjithashtu, veprimet e kujdestarisë janë të koordinuara dhe zbatuara mirë në bashkëpunim me familjen, shkollën, policinë, gjykatat dhe partnerë të tjerë të shtetit dhe shoqërisë civile.

Nga aspektet legjislative dhe administrative të ofrimit të shërbimeve gjithçka duket të jetë në rregull dhe plotësisht funksionale (procedurat, regjistrimi dhe anamneza e çështjes). Sidoqoftë, gjatë diskutimit të rasteve dhe shërbimeve specifike dhe cilësisë/rezultatit të veprimeve të ndërmarrura atëherë problemet filluan të lindnin. Zbatimi i kërkesave legjislative dhe administrative për veprimet dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve pengohen nga shumë faktorë. Ndryshimet reale në jetën e fëmijëve dhe familjeve të tyre janë të ngadalta dhe jo të plota.

Megjithëse ekzistojnë standarde të përcaktuara ndërkombëtarisht për numrin e punonjësve socialë për numrin e banorëve dhe numrin dhe llojin e rasteve për punonjës social - për fat të keq, këto standarde nuk u ndoqën kurrë dhe nuk u miratuan për QPS-t; në Kosovë, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik për të ndërmarrë reformat aq shumë të nevojshme të sigurimit të sistemit të mirëqenies sociale, mungesa e fondeve dhe mungesa e kapaciteteve profesionale. Punonjësit socialë, pjesëmarrës në grupin e fokusit, raportojnë se janë të mbingarkuar me një numër rastesh dhe se nuk kanë kohë të mjaftueshme për t'u kushtuar rasteve të caktuara. Ata duhet të merren me raste të shumta dhe me lloje të ndryshme të çështjeve në të njëjtën kohë. Ata caktohen gjithashtu në baza javore me metodën e rotacionit si zyrtarë 'në gadishmëri' (në thirrje) 24/7; dhe duhet të përgjigjen në çdo kohë, madje edhe në orët e vona dhe/ose gjatë fundjavave (për çka ata nuk kompensohen financiarisht, as me ditë pushimi shtesë). Çështja e të qenit të paguar pak dhe të diskriminuar si zyrtarë shtetëror përmendet në të gjithë pyetësorët, intervistat, si dhe në diskutimin në grup të fokusit. Nuk do të ketë diskutime për këto shqetësime në këtë pjesë; megjithatë, ky është një aspekt i rëndësishëm që duhet të konsiderohet si element që pengon motivimin personal, çon në një shuarje profesionale dhe si pasojë rënie të performancës në punë.

Kur pyeten se si ndihen në lidhje me shërbimet që ofrojnë, dhe nëse ata mund të bëjnë një vetëvlerësim mbi nivelin e kënaqësisë për shërbimet e ofruara; qartazi kishte dëshirë për më shumë dhe qasje të ndryshme. Siç u përmend më lart, kërkesat ligjore për veprimet e mbrojtjes së fëmijëve nuk

30 "Profili i FUQISË PUNËTORE TË PUNËS SOCIALE: Tetor 2017 Një raport për Këshillin mbi Edukimin e Punës Sociale dhe Komitetin Drejtues të Nismës Kombëtare të Fuqisë Punëtore, nga Instituti i Fuqisë Punëtore Shëndetësore i Universitetit George Washington dhe Shkolla e Infermierisë. Në dispozicion në lidhjen: <https://www.socialworkers.org/LinkClick.aspx?fileticket=wCttjrHqOgE%3D&portalid=0>

31 Shërbime për: fëmijët e braktisur; shtëpi tranziti; familje kujdestare; birësimet; bashkimi familjar; kujdestaria; risocializimi; rehabilitimi me programe psiko-sociale; këshillim individual dhe familjar etj.

janë përmbushur deri në fund për shkak të shumë faktorëve, si dhe mungesës së mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe monitorimit.

Punonjësit socialë ankohen se shërbimet e ofruara shpesh pengohen nga infrastruktura e dobët e zyrave të tyre. Si dhe mungesa e mjeteve të komunikimit dhe veçanërisht mungesa e transportit për të arritur klientët dhe partnerët në mënyrë që të koordinojnë shërbimet.

Ankesat kryesore të zyrtarëve të shërbimeve sociale për zyrat e QPS-së konsistojnë në: zakonisht zyrat ndahen ndërmjet dy ose më shumë zyrtarëve të shërbimeve sociale, pa privatësi kur marrin klientë dhe bisedojnë me ta çështje delikate dhe të ndjeshme. Nuk ka dhoma të përshtatshme për takime dhe intervista me fëmijë. Nuk ka dhoma të specializuara për takimin e fëmijëve me prindër që kalojnë procedurat e divorcit. Nuk ka lodra të vogla dhe/ose komoditete për fëmijë dhe në shumicën e rasteve pa ambiente të jashtme alternative të takimeve. Në shumë QPS ka gjithashtu mungesë të dhomës së pritjes dhe/ose karriges së vetme për t'u ulur dhe pritur. Kushtet e papërshtatshme të punës ulin performancën dhe cilësinë e shërbimeve për fëmijët.

Shumë nga QPS-të, kanë raportuar gjatë diskutimit në grup të fokusi, por gjithashtu edhe është parë gjatë vizitave për intervistë me drejtorët e QPS-ve, mungesa e qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara, kushtet e këqija higjienike dhe të papërshtatshme të ambienteve hidrosanitare në QPS.

Shumica e QPS-ve dhe ZSHS kanë sfida logjistike për transportin. Në disa raste, transporti duhet të kërkohet paraprakisht nga komuna (nga grupi i shoferëve). Disa QPS kanë një ose në raste të rralla dy automjete, zakonisht në gjendje të keqe. Vetëm disa QPS raportuan se transporti nuk paraqet vështirësi në punën e tyre.

Aspekti logjistik i ofrimit të shërbimeve, si dhe mungesat e personelit pa profile adekuate profesionale (shumë pak punonjës socialë dhe nganjëherë jo të lidhur fare me shkencën sociale, siç përcaktohet në ligjin për shërbimet sociale dhe familjare)³², përfaqësojnë një sfidë serioze dhe zvogëlojnë shanset për shërbime me cilësi të larmishme në kohë dhe si pasojë shërbime joadekuate të mbrojtjes së fëmijëve. Sa i përket masave parandaluese kishte shumë pak për të diskutuar, ka shumë pak veprime parandaluese; QPS-ja reagon vetëm kur rastet u referohen atyre ose vetë-referohen, zakonisht vetëm në fazë të përparuar të problemit ose rrezikut për familjet dhe fëmijën. Nuk ka mekanizma paralajmërues të hershëm dhe identifikues.

QPS-të dhe ZSHS-të konfirmojnë se QPS-të nuk kanë ndonjë dokument planifikimi për shërbimet dhe veprimet e ndërmarra (përveç planifikimit financiar për kostot e punës dhe pagat, të dorëzuara në DMS të komunës në bazë vjetore), nuk ka vizion dhe/ose plan për të organizuar stafin dhe aktivitetet e bazuara mbi numrin e rasteve të parashikuara dhe llojin e rasteve. Ato performojnë në baza rast pas rasti, kur shfaqen raste të reja dhe kërkojnë mbështetje në QPS. Nuk ka asnjë indikacion se ka ndonjë planifikim të personelit në lidhje me planifikimin e aktivitetit në baza vjetore ose i koordinuar me nivelin komunal dhe atë qendror. Nuk ka asnjë indikacion, në të dhënat e mbledhura nga pyetësorët dhe në diskutim me QPS-të, se ka njohuri në lidhje me numrin e saktë të kategorisë së fëmijëve në nevojë ose për llojet e ndryshme të shërbimeve që parashikohen për fëmijët në rrezik.

QPS-të ankohen se drejtorët komunalë të DMS-ve, janë të caktuar politikisht, shpesh ndërrohen, pa formim profesional mbi problemet/nevojat sociale të shoqërisë dhe zakonisht më të përqendruar në sektorin shëndetësor (pasi shumica e drejtorive komunale mbulojnë edhe shëndetësinë edhe mirëqenien sociale, përveç në komunat e Prishtinës, Prizrenit dhe Mitrovicës). Ata konsiderojnë se kanë shumë pak mbështetje nga autoritetet komunale dhe madje edhe më pak mbështetje dhe mirëkuptim nga niveli qendror dhe ministritë përkatëse. QPS-të ndjehen të parespektuar, të lënë pas dore dhe të tepërt së bashku me rastet me të cilat merren. Në raste emergjente nëse një nënë dhe/ose fëmijë viktimë e abuzimit dhe neglizhencës shfaqet në QPS, nuk ka mjete financiare për të ofruar një gotë ujë, çaj të ngrohtë ose ndonjë ushqim bazë (në shumicën e rasteve ZS-të sigurojnë në raste të tilla nga xhepi i tyre). Kërkohet që buxheti i emergjencës të jetë i disponueshëm në secilën QPS.

32 Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Dispozitat e Përgjithshme, Neni 1, i. Zyrtar i Shërbimeve Sociale do të thotë një profesionist i kualifikuar i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, në fushën e punës sociale, sociologjisë së psikologjisë, ligjit, pedagogjisë ose disiplinë tjetër e lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare të licencuara dhe të regjistruara në regjistrin e Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i QPS-ve me partnerët në nivelin lokal raportohet të jetë i drejtë dhe profesional (d.m.th. shkollat, policia, gjykatat, institucionet e shëndetit mendor, spitalet, strehimoret, qendrat rinore etj). Fatkeqësisht, në disa raste, QPS-të nuk marrin informata kthyesë nga partnerët me të cilët bashkëpunojnë, siç janë vendimet e gjykatave; pasi ato kanë nevojë për të përcaktuar veprimet e mëtejshme për rastet e caktuara. Disa nga partnerët nuk kanë gjithmonë një qasje adekuate të ndjeshme sociale (nuk bëjnë dëm) ndaj klientëve dhe nuk janë gjithmonë të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e QPS dhe punonjësve socialë; që çon në keqkuptim dhe ngecje të vogël të proceseve të bashkëpunimit dhe ofrimit të ndihmës së nevojshme për fëmijët. Rolet dhe përgjegjësitë e paqarta ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale gjithashtu ndikojnë në keqkuptimin dhe regresin e bashkëpunimit në nivelin lokal. Në këtë drejtim kërkohet nevoja për një koordinim më të qartë edhe ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Përfaqësuesit e QPS-ve në diskutimet në grupet e fokusit rekomanduan që disa institucione të punësojnë në personelin e tyre të përhershëm edhe punonjës socialë që mund të merren me aspektet e mirëqenies sociale të klientëve të tyre dhe të përfshijnë QPS-në vetëm me raste komplekse.

Për më tepër, kur komunat përcaktojnë buxhetin dhe projektet në lidhje me aspektet e mirëqenies sociale, QPS-ja kërkon që të përfshihet në planifikim dhe pjesën e panelit përzgjedhës për identifikimin dhe kontraktimin e jashtëm të shoqërisë civile - edhe ofruesit e shërbimeve të OJQ-ve. Gjithashtu, kur shërbimet kontraktohen nga niveli qendror dhe komuna, duhet të koordinohen me QPS-në. Ajo konsiderohet si thelbësore për sigurimin e cilësisë së shërbimeve dhe përfitimit të klientëve më të rrezikuar. Në disa raste, nga QPS-të kërkohet të ofrojnë mbështetje dhe shërbime për OJQ-të (numri i përfituesve, kategori specifike në rrezik, qasja në disa familje) dhe jo e kundërta.

Shërbimet e ofruara nga shoqëria civile dhe OJQ-të janë të kufizuara dhe jo gjithmonë ndajnë informacionin përkatës dhe japin informacion për QPS-në. Shërbimet e ofruara nga OJQ-të e licencuara janë mirë të pranuar por duhet të monitorohen dhe koordinohen si duhet me shërbimet shtetërore dhe të sigurojnë qasje në informacionin përkatës për menaxhimin e çështjeve. Është raportuar se prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta, në disa raste u janë kërkuar që të paguanin për shërbimet e kryera nga të paktën një OJQ që kishte përfitime të financimit publik.

Disa kategori specifike raportohet se diskriminohen nga sistemi i ofrimit të shërbimeve:

Kategorizimi i personave me aftësi të kufizuara është një proces i vështirë dhe kompleks që duhet të jetë më i ndjeshëm dhe më fleksibël pasi disa raste diskriminohen nga procedurat administrative shumë të ngurta dhe udhëzimet e kriterëve të kategorizimit të zbatuara nga komisioni i kategorizimit. Në këtë drejtim konsiderohet gjithashtu diskriminuese që fëmijët më të vegjël se 12 muaj nuk kanë të drejtë për ndihmë në skemat e aftësisë së kufizuar (vetëm pasi të mbushin një vit). Gjithashtu, provizioni aktual monetar kërkohet të rritet për të gjitha familjet e fëmijëve me sëmundje kronike pasi konsiderohet e pamjaftueshme për të mbuluar kostot për fëmijët dhe për të siguruar kujdesin e nevojshëm.

Skema e ndihmës sociale për familjet vetëm me fëmijë më të vegjël se 5 vjeç. Një qasje tjetër diskriminuese që kërkon reflektim pasi ka efekte të shumëfishta në arritjen e fëmijëve në nevojë dhe planifikimin familjar në mesin e përfituesve të shërbimeve.

Ndihma sociale e dobët dhe joadekuate për fëmijët që **abuzojnë me substancat**. Mungesa e shërbimeve të këshillimit profesional, mungesa e strehimit dhe/ose qendrave të kujdesit ditor, mungesa e mbështetjes materiale dhe programeve sociale të angazhimit në ndërmarrjet sociale, puna/mbështetja e komunitetit dhe programe të tjera rehabilituese. Shumë raste janë raste recidiviste.³³

Ndihma sociale e dobët dhe joadekuate për fëmijët viktime të **abuzimit seksual**. Mungesa e shërbimeve të këshillimit profesional, rehabilitimi dhe mbështetja psikologjike, mungesa e një strehe të specializuar (në veçanti nëse viktime është një djalë), mungesa e mbështetjes materiale dhe programeve sociale të angazhimit në ndërmarrjet sociale, puna/mbështetja e komunitetit dhe programe të tjera rehabilituese. Disa raste janë raste të recidivistëve.

Ndihma sociale e dobët dhe joadekuate për fëmijët e përfshirë **në punë të vështirë/të rrezikshme/të dëmshme**. Mungesa e veprimeve parandaluese si shërbimet e këshillimit profesional familjar, mungesa e mbështetjes materiale dhe programeve shoqërore të angazhimit në ndërmarrjet sociale, puna/mbështetja në komunitet; programe të riintegritimit të shkollës dhe të tjera të rehabilitimit. Shumë raste janë raste të recidivistëve.

Ndihma sociale e dobët dhe joadekuate për fëmijët në **situatë rruge**. Mungesa e punës me familjen, shërbimet e këshillimit profesional, mungesa e strehimit, mungesa e mbështetjes materiale dhe programeve sociale të angazhimit në ndërmarrjet sociale, puna/mbështetja në komunitet dhe programe të tjera rehabilituese. Shumë raste janë raste të recidivistëve.

Ndihma sociale e dobët dhe joadekuate për fëmijët në **konflikt me ligjin**. Mungesa e shërbimeve të këshillimit profesional, mungesa e strehimit, mungesa e mbështetjes materiale dhe programeve sociale të angazhimit në ndërmarrjet sociale, puna/mbështetja në komunitet dhe programe të tjera rehabilituese. Përveç shërbimeve këshilluese dhe referimeve, në QPS nuk ka pothuajse asnjë shërbim tjetër që mund të mbështesë fëmijën dhe familjen me aktivitete që mund të mbështesin rehabilitimin, rocializimin, riintegrimin dhe mbështetjen për një kohë të gjatë me ndërhyrje dhe mbështetje multidisiplinare. Shumë nga rastet e asistuar raportohet të jenë raste të recidivistëve.

Ndihma sociale e dobët dhe joadekuate për fëmijët viktime të **dhunës në familje**. Mungesa e shërbimeve të këshillimit profesional, mungesa e strehimit (sidomos kur është djalë), mungesa e mbështetjes materiale dhe programeve sociale të angazhimit në ndërmarrjet sociale, puna/mbështetja në komunitet dhe programe të tjera rehabilituese. Shumë raste janë raste të recidivistëve.

“Rasti i një djali 16-vjeçar që u përpoq të mbronte nënën e tij nga situata e dhunës në familje e shkaktuar nga babai i tij. Ne nuk kishim ku ta strehohim djalin pasi gjendja u përkeqësua në familje. Gjithashtu, nëna duhej të kthehej në familjen abuzive pasi nuk donte të ngrinte akuza dhe këmbënguli për të mbrojtur burrin e saj abuziv.”³⁴

Fëmija i braktisur me aftësi të kufizuara ka shumë pak mundësi të strehohet dhe të gjejë familje kujdestare dhe të birësohet. Nuk ka asnjë strukturë institucionale për të akomoduar raste të tilla. Shumë raste qëndrojnë në spital derisa të gjendet zgjidhja.

Fëmijë të familjeve konfliktuoze dhe në situatë të cënueshme ndaj dhunës që nuk arrijnë kritere për ndihmë ekonomike-sociale dhe/ose refuzojnë të bashkëpunojnë me QPS-të, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjykatat.

“Nëna me 4 fëmijë, burri mungon për arsye të njohura nga QPS-ja. Kishte indikacione se ajo abuzohej seksualisht brenda familjes nga një i afërm i burrit. Nuk u gjetën alternativa strehimi për të dhe fëmijët e saj, as të përshtatshme për ndihmë sociale! Kohët e fundit fëmijët e saj janë shumicën e kohës vetëm, pasi ajo mungon në shtëpi.”³⁵

Një nga sfidat më të shpeshta për ZSHS është gjetja e alternativave të përshtatshme, madje edhe të përkohshme të strehimit për fëmijët në rrezik dhe familjen e tyre.

Një ZSHS raporton çuditërisht për të ashtuquajturit **“fëmijë në errësi”** – raste të fëmijëve që nuk bëjnë asnjëherë të identifikohen dhe mbështeten kur rrezikohen dhe kur të drejtat e tyre shkelen. Ata zakonisht janë të izoluar dhe sistemi i mbrojtjes nuk ka njohuri për vendndodhjen e tyre. *‘Ne e dimë, ka raste që nuk mund t’i arrijmë’*. Disa nga ato raste supozohet të jenë viktime të dhunës në familje, gjithashtu raste të fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme dhe të vështira të punës brenda familjes ose në rrugë. Në këtë kontekst, u diskutua gjithashtu për mundësinë e diskriminimit të ofrimit të shërbimeve midis zonave rurale urbane dhe të largëta, kur rastet nuk kanë njohuri në lidhje me shërbimet në dispozicion dhe ose nuk kanë qasje në shërbime për shkak të habitatit të largët gjeografik dhe mentalitetit kulturor tradicional në familjet e tyre. Informacioni dhe masat parandaluese janë shumë të kufizuara dhe të përgjithshme.

Një sasi e madhe e shërbimeve dhe ndihmës ende menaxhohet nga niveli qendror (MPMS). Në anën tjetër dhe siç kërkohet edhe me ligjin e fundit për mbrojtjen e fëmijëve.; *Të gjitha shërbimet profe-*

34 Punonjësi social nga rajoni i Prizrenit, pjesëmarrës në diskutimin në grup të fokusit.

35 Punonjësi social nga rajoni i Prishtinës, pjesëmarrës në diskutimin në grupin e fokusit.

sionale janë të decentralizuara në nivelin lokal, ndërsa nuk ka kapacitet profesional dhe struktura të financuara për të trajtuar të gjitha kërkesat. Profili profesional dhe përvoja e punës e zyrtarëve të punës sociale nuk janë gjithmonë adekuate dhe të përgatitura mirë për raste komplekse të fëmijëve në nevojë³⁶. Ekzistojnë parakushte për një koordinim më të mirë midis nivelit qendror dhe atij lokal.

Gjithashtu, rastet e fëmijëve të prindërve të divorcuar ose në proces pajtimi, bëhen 'peng' të luftës ndërmjet çiftit duke mbështetur miratimin dhe/ose pëlqimin e ndryshëm të njërit prej prindërve. Në raste të tilla gjykatave u kërkohet të marrin vendime në interesin më të mirë të fëmijëve.

Tryezat e rrumbullakta multidisiplinare për mbështetje në menaxhimin e çështjeve (TMR) që kanë qenë funksionale në disa komuna për menaxhimin e çështjeve komplekse dhe ku QPS-ja kishte rol vendimtar në to janë mezi funksionale në komuna më të mëdha dhe mblidhen rrallë për disa raste. Edhe pse tani është kërkesë e nevojshme nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve.³⁷

Një përfaqësues i QPS-së theksoi një aspekt tjetër që u diskutua si element i abuzimit të fëmijëve: disa organizata dhe/ose individë të papërgjegjshëm që përfaqësojnë disa programe bamirësie dhe iniciativa përdorin situatën e vështirë të fëmijëve dhe familjeve të tyre për mbledhjen e fondeve.

Ishte marrëveshje e zakonshme ndërmjet pjesëmarrësve të grupeve të fokusit që fëmijët ekspozohen shpesh në mediat sociale dhe forma të tjera të paraqitjes publike që dëmtojnë mirëqenien dhe privatësinë e fëmijës. QPS-ja ka pak fuqi për të monitoruar dhe për të reaguar në raste të tilla. Statuti dhe pozicionimi ligjor i QPS-së dhe ZSHS-së nuk është i përcaktuar mirë (zakonisht i marginalizuar) dhe shpesh neglizhohet dhe ose keqkuptohet.

Sugjeruar si ndryshime prioritare në përditësimin e shërbimeve sociale:

Situata e fëmijëve me nevoja të veçanta kërkohet të rishikohet dhe skema e ndihmës sociale për QPS dhe familjen/kujdestarin e tyre kanë nevojë për një përmirësim financiar.

Kërkohen shërbime profesionale dhe qendra rehabilitimi dhe këshillimi për sigurimin e mbështetjes së specializuar afatgjatë për fëmijët që abuzojnë me substanca.

Shërbime më të specializuara siç janë alternativat e strehimit, shpërndarja e ushqimit, këshillimi, programet mbështetëse të mentorimit familjar dhe qendrat e kujdesit ditor kërkohen gjithashtu për fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijët në situatë rruge.

Fëmijët viktimë të dhunës seksuale kërkojnë shërbime më komplekse dhe profesionale veçanërisht të këshillimit dhe mbështetjes psikologjike, si dhe alternativave të strehimit në familjet strehuese.

Statusi ligjor/profesional i zyrtarëve të shërbimit social duhet të rishikohet dhe t'u jepet roli i duhur si punëtor profesional dhe jo si zyrtar.

Stimulimi financiar, rritja e pagave për zyrtarët e shërbimit social, siç konsiderohen të nënpaguar dhe nënvlerësuar si profesion. Kjo përfshin gjithashtu pagimin e orëve të punës jashtë orarit.

Sanksione ligjore më rigorozë dhe të qëndrueshme për prindërit dhe personat e tjerë që kanë fëmijë nën kujdestarinë e tyre, dhe ata neglizhohen, abuzojnë ose nuk sigurojnë mbrojtje adekuate për fëmijët. "Ligji i ri për mbrojtjen e fëmijëve kërkon shumë angazhim nga QPS-ja por nuk siguron fuqizim për QPS-në dhe profesionin e PS"³⁸. Edhe pse me legjislacionin sekondar do të ofrohen disa udhëzime dhe leje të tjera në mekanizmat e përgjithshëm të mbrojtjes së fëmijëve në lidhje me ligjin, megjithatë aspekti i statusit ligjor të QPS-së dhe punonjësit social si kategori e *profesionit profesional* dhe jo si *pozitë administrative* duhet të adresohet dhe implementohet nga ligjet e tjera. Mbrojtja e fëmijëve dhe QPS-ja si institucioni më i rëndësishëm në sigurimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, kanë nevojë për status të përshtatshëm ligjor dhe punonjës socialë të njohur si ofrues të shërbimit profesional për mbrojtjen e fëmijëve.

36 Drejtori i QPS-së nga Rajoni i Prizrenit, pjesëmarrës në diskutimin në grupin e fokusit

37 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Neni 21 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

38 Zyrtar i shërbimeve sociale nga rajoni i Prizrenit.

8. INTERVISTAT ME FAMILJET E FËMIJËVE QË MARRIN SHËRBIME SOCIALE

Për të marrë gjithashtu informacion për mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve nga perspektiva e përfituesit, u zhvilluan intervista me tri familje të ndryshme. Në koordinim me QPS-të dhe miratimin e drejtorëve të QPS-ve tri familje u zgjedhën rastësisht: fëmijët e kategorive të ndryshme të nevojave, mosha e ndryshme e fëmijëve, ndryshimi në vendndodhje (urbane dhe rurale), si dhe kohëzgjatja e shërbimeve të ofruara.

Edhe pse tri familje nuk përbëjnë shembull përfaqësues, megjithatë, qëllimi ishte që të vërtetohen disa nga gjetjet nga instrumentet e tjera të përdorur gjatë analizës së studimit.

Të tri rastet ose u referuan ose u referuan vetë në QPS për shërbime. Ky ishte një zbulim i pritshëm pasi QPS-të dhe PS kanë një metodologji mjaft statike të punës ku zakonisht janë klientë që i drejtohen QPS-ve për ndihmë dhe jo e kundërta. QPS-të siç tregohet kanë shumë pak veprime parandaluese dhe zakonisht rastet referohen në QPS-ve ose vetë-referohen nga klientët.

Asnjë nga rastet nuk kishte informacion paraprak për shërbimet e QPS-ve dhe vendndodhjen e QPS-ve. Një aspekt dhe tregues tjetër se QPS-të kanë nevojë për më shumë vizibilitet dhe vizita në terren në komunitetet në rrezik dhe veçanërisht në grupet e marginalizuara të fëmijëve.

Familjet e intervistuar njëllojërisht pajtohen se ata ishin pranuar mirë nga QPS-të dhe u ishin caktuar punëtorë socialë. Procedurat për marrjen e shërbimeve u prezantuan qartë edhe pse kërkojnë në disa raste shumë dokumente mbështetëse dhe zakonisht janë shumë të gjata (deri në gjashtë muaj). Gjithashtu në rezultate të tjera tregohet se disa procedura administrative për marrjen e shërbimeve janë komplekse dhe në disa raste rrezikojnë të mbajnë larg disa nga rastet më të neglizhuara të fëmijëve në nevojë.

Në diskutim me anëtarët e familjes u tregua se QPS-ja ka koordinuar gjithashtu me institucione të tjera dhe ofruesit e shërbimeve dhe i referoi ata për të marrë shërbime dhe mallra. Rëndësia e koordinimit dhe bashkëpunimit të QPS-së me partnerë të tjerë në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve në referim si dhe në ofrimin e shërbimeve është thelbësore dhe kërkon avancimin e mëtejshëm me mekanizmat e ndryshëm të koordinimit.

Lloji i shërbimeve të ofruara nga QPS-ja ndryshon nga referimi dhe regjistrimi në skema të ndryshme të ndihmës sociale monetare për aftësinë e kufizuar, fuqizimin ekonomik, akomodimin dhe strehimin, ushqime dhe artikuj jo-ushqimorë, si dhe në shumicën e rasteve këshillimi dhe vlerësimi i nevojave dhe referimi i mëtejshëm në institucionet përkatëse. Kjo tregon qartë se QPS-të dhe punonjësit socialë kanë më shumë si një rol lehtësues sesa ofruesit e shërbimeve. Sidoqoftë, QPS-të menaxhojnë mirë këtë aspekt të rolit dhe përgjegjësisë së tyre ligjore, edhe pse u kërkua nga diskutime të tjera me QPS-të që nevojiten më shumë rritje të kapaciteteve me burime njerëzore dhe alokim të buxhetit për të qenë në gjendje të zgjerojnë, diversifikojnë dhe rrisin cilësinë e shërbimeve të ofruara nga QPS-të.

Në dy nga tre raste ishte interesante të dihet se ata marrin një numër të konsiderueshëm të shërbimeve nga ofruesit e shërbimeve të OJQ-ve të shoqërisë civile. Jo vetëm që OJQ-ja luajti një rol si mekanizëm referimi në këto dy raste, por gjithashtu ofroi shërbime në koordinim të ngushtë me QPS-në. Ky ishte një fakt shumë pozitiv i bashkëpunimit ndërinstitucional në arritjen e disa kategorive më të rrezikuara dhe ofrimin e shërbimeve të koordinuara që i mundësojnë QPS-së në arritjen e standardeve minimale të kujdesit për përfituesit e tyre.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që u përmend është se ata i konsiderojnë QPS-të dhe PS si menaxher të çështjeve të tyre që po bëjnë maksimumin e mundshëm për plotësimin e nevojave të tyre dhe se ata ishin shumë mirënjohës për angazhimin dhe profesionalizmin e tyre.

Ankesa e tyre kryesore për shërbimet e marra është se ato janë të shkurtra, të pamjaftueshme dhe jo konsistente në plotësimin e të gjitha nevojave të tyre. Shërbimet nga OJQ-të varen nga fondet dhe nuk janë gjithmonë të disponueshme. Skemat e ndihmës monetare janë themelore dhe mezi mbulojnë disa kosto themelore. Koordinimi dhe referimi ndonjëherë janë të gjata dhe jo gjithmonë të suksesshme.

Së fundmi, mund të konkludojmë se përkundër mjaft elementeve pozitive që u treguan nga përfituesit në lidhje me shërbimet e marra nga QPS-të, ne gjithashtu mund të shohim se jo të gjitha nevojat janë mbuluar dhe ka disa boshllëqe dhe mungesa të konsiderueshme në disa shërbime thelbësore. Kjo situatë e vë QPS-të në situatë të vështirë dhe në disa raste nuk arrijnë të sigurojnë shërbime adekuate për mbrojtjen e fëmijëve. Shumica e atyre fëmijëve dhe familjeve të tyre qëndrojnë brenda sistemit të ndihmës/skemave të ndihmës për shumë vite dhe nuk janë në gjendje të dalin nga cikli i egër i varfërisë dhe të integrohen plotësisht në shoqëri.

9. KONKLuzionET

1. Nga shqyrtimi i të gjitha ligjeve përkatëse lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, mund të konkludojmë se ekziston një kornizë e kënaqshme legjislative për Qendrat për Punë Sociale, si dhe palët e tjera të interesit, të cilët i rregullojnë mekanizmat dhe shërbimet në mbrojtjen e fëmijëve. Ka procese të vazhdueshme të rishikimeve legjislative në disa segmente të ligjeve që do të mundësojnë dispozita më të mira për mbrojtjen e fëmijëve.
2. Më tej në shqyrtimin legjislativ dhe të paraqitur në disa intervista me QPS-të dhe në drejtoritë komunale të mirëqenies sociale, ka disa zbrazëtira në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në legjislacionin sekondar dhe aktet nënligjore të cilat duhet të: rregullojnë dhe ofrojnë udhëzime të qarta për rolin dhe përgjegjësinë e veprimeve ndërmjet palëve të interesit (në veçanti ndërmjet administratës qendrore dhe lokale, si dhe brenda nivelit komunal), llojit dhe frekuencës së shërbimeve të mbrojtjes sociale, modaliteteve të financimit, raportimit dhe monitorimit (sigurimit të cilësisë).
3. QPS-të si ofrues të shërbimeve ngritën shqetësime në lidhje me standardet minimale për kujdesin dhe procedurat e ofrimit të shërbimeve të zhvilluara nga MPMS. Ato argumentuan posaçërisht për udhëzimet e pamjaftueshme dhe të paqarta të dhëna në disa dokumente standarde minimale dhe forma të tjera mbështetëse për masat e mbrojtjes të fëmijëve për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar.
4. Përkundër tendencave ndërkombëtare mbi rritjen e fuqisë punëtore të punës sociale, përkundrazi, numri i punonjësve socialë në Kosovë është zvogëluar pasi shumë pozita të lira në QPS (për shkak të pensionimit, vdekjes ose dorëheqjes) në shumë QPS nuk janë zëvendësuar me personel të ri. Gjithashtu, nga QPS-të është raportuar se ka mungesë të profileve profesionale të stafit siç janë punëtorët social, psikologët dhe pedagogët special apo specialistë për këshillim për të punuar me raste komplekse. Gjithashtu ka ankesa për mungesë të stafit ndihmës (nëpunës administrativë në QPS-të më të mëdha, stafit për pastrim dhe stafit të sigurimit në ndërtesa). Vetëm në disa QPS është raportuar për angazhim/punësim periodik të personelit dhe shërbimeve profesionale për raste specifike.
5. Në të gjitha analizat gjatë gjithë procesit të hulumtimit nuk ka indikacione për iniciativa si angazhimi i vullnetarëve që mund të mbështesin për ta ulur barrën e disa detyrave administrative brenda QPS-ve, ose për të kryer ndonjë punë parandaluese me fëmijët në komunitet. Nuk ka dëshmi as për iniciativa dhe as për bashkëpunim me ndërmarrjet shoqërore (edhe pse ka shumë pak aktive në Kosovë). Gjithashtu, ka shumë pak stimulim për t'iu qasur, inkurajuar dhe angazhuar punonjësit e sektorit privat dhe të komunitetit në mbështetje të kategorive të cënueshme dhe familjeve të fëmijëve në rrezik.
6. Metodologjitë e vjetruara të qasjes organizative në mbikëqyrje, ndarja e ngarkesës të punës dhe menaxhimi i çështjeve brenda QPS-ve kanë nevojë për përmirësim. Rastet e reja u ndahen punonjësve social me sistem rotacioni (në disa raste pavarësisht nga profili specifik profesional, viti i përvojës dhe ngarkesa e punës së punonjësve social); punonjësit social nuk janë të specializuar në një ose në kategori të grupeve, d.m.th. fëmijë dhe të rinj, të moshuar, familje dhe shëndetësi, etj. Punëtorët social mund të angazhohen në kategori të ndryshme të rasteve në të njëjtën kohë. Nuk ka praktika të vendosura të kolegjiemeve profesionale ndërdisiplinare për menaxhimin e çështjeve komplekse brenda QPS-ve.
7. Ka qenë e pamundur të identifikohen të gjitha trajnimet e ofruara për të gjitha QPS-të. Nuk ka pasur të dhëna të qarta, gjithëpërfshirëse të trajnimit dhe asnjë vlerësim të duhur të nevojave për trajnimin e kryer në raportet e kaluara ose për ato të fundit për të gjitha QPS-të në Kosovë. Ka pasur dëshmi të shpërndara se personeli i QPS-ve ka marrë trajnime të special-

- izuara që synojnë kategoritë më të rrezikuara të fëmijëve (QPS-të kanë emëruar personel sipas rasti të cilët janë pajisur me trajnime të ndryshme 1-2-ditore dhe ose punëtori, por jo me module të specializuara akademike që mund t'i certifikojnë ata me ekspertizë në temë të veçantë); p.sh. punë me fëmijë dhe të rinj, fëmijë me aftësi të kufizuar, fëmijë që abuzojnë me substanca, fëmijë nga familjet jofunksionale, etj.
8. Analiza e nevojave sociale dhe çdo planifikim tjetër i shërbimeve si: masat parandaluese për kategoritë në rrezik, planifikimi buxhetor, koordinimi, partneriteti dhe iniciativat e lobimit në nivelin komunal nuk zhvillohen në baza të rregullta (vjetore), as në QPS dhe as në DMS. Në QPS nuk ka mekanizma të qëndrueshëm dhe të duhur të monitorimit për të mbështetur planifikimin dhe analizën e nevojave për kategoritë në rrezik, gjithashtu duke monitoruar frekuencën dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve për fëmijët. Në atë kontekst nuk ka ndonjë planifikim specifik buxhetor për fëmijët në nevojë as në QPS dhe as në DMS.
 9. Partneriteti i QPS-ve me organizata-institucione të tjera në përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve nuk është gjithmonë i koordinuar dhe efikas (veçanërisht për masat parandaluese dhe referim) ndërmjet QPS-ve dhe policisë, shkollave, gjykatave, ofruesve të tjerë të shërbimeve përfshirë OJQ-të. Jo gjithmonë ka kanale të qarta të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit.
 10. Në pjesën më të madhe infrastruktura e ndërtesave së QPS-ve raportohet të jetë në gjendje të dobët: mungesë e hapësirës dhe zyra të përshtatshme, TI e vjetruar dhe ose jofunksionale dhe pajisje të tjera komunikimi, mobile të vjetra dhe shumë pak ambiente miqësore për fëmijët. Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe sigurimin në kohë të komoditetit për fëmijët në nevojë për shërbime të QPS-së.
 11. Mungesa e mjeteve të transportit dhe komunikimit në QPS: transporti i punonjësve social për vizita në terren është një neglizhencë tjetër serioze nga komunat si organ i drejtpërdrejtë i mbikëqyrjes dhe menaxhimit të QPS-ve. Ka raportime nga QPS-të se ata kanë vështirësi në plotësimin e kërkesave ligjore për vizitat në terren të familjeve në nevojë. Në raste të veçanta të fëmijëve në rrezik që kërkojnë vizita shumë të shpeshta dhe ndonjëherë me urgjencë.
 12. Të gjitha transaksionet financiare janë të centralizuara në ministri dhe në nivelin komunal. QPS nuk posedon llogari të vet bankare, prandaj nuk mund të ndajnë fonde për shpenzime të urgjencës në rastet e fëmijëve në nevojë urgjente për ushqim, rroba dhe gjëra higjienike. QPS nuk mund t'i mbledhë as taksat dhe tarifën e paguara nga qytetarët për shërbimet administrative të sigurimit të dokumenteve të ndryshme në lidhje me statusin e familjes dhe varësinë e tyre, shërbime të ofruara nga QPS. Gjithashtu, është e pamundur për të aplikuar për fonde dhe projekte nga donatorët e jashtëm, përveç statusit ligjor si institucion publik.
 13. Në QPS ofrohen ekskluzivisht këshillime dhe shërbime referimi. QPS-të nuk kanë kapacitete (personel dhe buxhet) për shërbime të tjera direkte për fëmijë dhe të rritur/familjet në nevojë. Në rast nevojë për p.sh. strehim, ushqim dhe mbështetje tjetër urgjente për klientë, QPS-të nuk kanë kapacitete dhe asnjë stimulim financiar për të ofruar.
 14. Në disa raste dhe të ilustruara me raste konkrete, QPS -të u shprehën mbi alternativat shumë të ulëta të kapaciteteve të strehimit për fëmijët në nevojë. Ekziston vetëm një OJQ Strehimore për fëmijët në rrezik me kapacitete shumë të kufizuara. Shumë pak familje kujdestare në komuna dhe familje pothuajse jo ekzistuese të strehimit për fëmijët me aftësi të kufizuar. Strehimoret për viktimat e dhunës në familje pranojnë nëna dhe fëmijët e tyre (djem vetëm deri në moshën 12 vjeçare). Situata është shumë e rëndë për strehimin e çdo rasti të djemve më të moshuar se 12 vjeç. Nuk ka strehim të përkohshëm për strehimin afatshkurtër të fëmijëve në situatë të vështirë.
 15. Në disa rezultate të nxjerra nga analiza, është treguar se skemat e ndihmës sociale për familjet në vështirësi ekonomike, si dhe ndihma financiare për aftësinë e kufizuar dhe skemat e tjera të ndihmës financiare janë shumë të ulëta dhe nuk i mbulojnë nevojat themelore për ushqim dhe gjërat jo-ushqimore e kërkuara për përdorim ditor.
 16. Skemat sociale menaxhohen kryesisht nga MPMS të nivelit qendror. Sidoqoftë, QPS-të konsiderojnë se ekziston një buxhet mjaft i ulët në nivelin lokal për mbulimin e kostove të funksionimit të QPS-ve, personelit dhe nevojave të tjera emergjente për klientët që i bëjnë të disponueshme shërbimet për fëmijët në nevojë dhe gjithashtu kategoritë e tjera.
 17. Në të gjitha instrumentet kërkimore, pyetësorët dhe intervistat ka pasur tregues minimal të veprimeve parandaluese për mbrojtjen e fëmijëve, as nga QPS-të dhe as nga palët e tjera të

interesit. Masat parandaluese gjithashtu nuk janë të mundshme për shkak të ngarkesës së punës të zyrtarëve të shërbimit social dhe qasjes statike dhe metodologjisë të bazuar në zyrë të punës brenda QPS-së.

18. QPS-të dhe Zyrtarët e Shërbimit Social konsiderojnë veten si të lënë pas dore dhe të nënvlerësuar nga autoritetet në nivelin qendror dhe kryesisht në nivelin komunal për punën që bëjnë. Situata e QPS-ve dhe në veçanti statusi i Zyrtarëve të Shërbimit Social është kërkuar që të rishikohet dhe përmirësohet në shumë aspekte: si pozita në katalogun e profesioneve dhe nivelin e pagave. Gjithashtu, rregullimi i pagesës të orëve shtesë dhe ndërrimeve të natës për Zyrtarët e Shërbimit Social. Ka ngatërresa nëse këto ndryshime duhet të fillojnë nga niveli qendror apo komunal.
19. Ka pak dëshmi se QPS-ja ka përvojë dhe strategji për të komunikuar me mediat lokale dhe për t'i përdorur ato për shpërndarjen e informacioneve për masat parandaluese dhe, ose informacionet për shërbimet e ofruara dhe mekanizmat e referimit për të gjitha shërbimet dhe në veçanti për mbrojtjen e fëmijëve.
20. Monitorimi i ndjeshëm dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë në nivelin qendror dhe komunal me qasjen mbështetëse/këshilluese dhe rekomanduese për QPS-të. Nuk ka asnjë dëshmi të mekanizmave shumë të nevojshëm që do të sigurojnë mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës për QPS-të. Gjithashtu, nuk ka dëshmi të mekanizmave të vetë-monitorimit brenda QPS-ve dhe listave të kontrollit të sigurimit të cilësisë. Të gjithë përfituesit preken nga një qasje e tillë, por më së shumti fëmijët.
21. Në të shumtën e rasteve, QPS-ja nuk raportoi në pyetësorë një numër të saktë të fëmijëve nën juridiksionin e komunës ku vepron QMS-ja. Gjithashtu, asnjë shënim mbi numrin e fëmijëve në rrezik brenda zonës së tyre të përgjegjësisë.
22. Në përgjithësi ekziston një zbrastë e madhe në disponueshmërinë e të dhënave të ndara dhe lehtësisht të arritshme në lidhje me rastet dhe ndihmën e ofruar. Gjithashtu, shumë pak informata dhe raporte në lidhje me të dhënat e punonjësve të QPS-ve në nivelin qendror.
23. Në shumicën e QPS ve nuk ka kuti për ankesa dhe/ose mekanizma të qartë për t'i drejtuar klientët për ankesa dhe procedura eventuale.

Rekomandimet

- a. Meqenëse numri i zyrtarëve të shërbimit social është shumë më i ulët sesa që rekomandohet për numrin e banorëve, këshillohet që të rritet numri i zyrtarëve të shërbimit social në komuna. Të sigurohet punësimi i personelit të ri me profile të larmishme profesionale me kualifikim të shumëllojshëm akademik siç parashihet me ligj (5 kualifikime akademike), si dhe sigurimin e trajnimeve të specializuara të akredituara për zyrtarët e shërbimit social, duke mundësuar sigurimin e shërbimeve për kategori specifike në nevojë brenda QPS-ve, në veçanti për mbrojtjen e fëmijëve (përndryshe të punësohet/angazhohet personel i jashtëm i specializuar sipas nevojës).
- b. Infrastruktura e zyrës ka nevojë për përmirësim të madh. Ndërtoni ose merrni me qira më shumë hapësira për zyra të reja dhe ose riparoni zyrat ekzistuese të QPS-ve: duke siguruar qasje të plotë për të gjithë klientët (përfshirë personat me aftësi të kufizuar paraplegjik) dhe mundësoni hapësirë të mjaftueshme/të përshtatshme për personelin dhe klientët për të bashkëvepruar dhe për të siguruar/marrë shërbime. Caktoni dhe pajisni vende miqësore për intervista për fëmijë dhe bashkime familjare dhe lokale këshillimi. Kjo do të mundësojë shërbime më të qëndrueshme dhe cilësore duke siguruar plotësimin e nevojave të secilit fëmijë, sigurimin e ambienteve të sigurta dhe të rehatshëm, dhe respektimin e integritetit dhe konfidencialitetit.
- c. Në bashkëpunim me Universitetin e shtetit, Fakultetin Filozofik - Departamentin për Punë Sociale, në koordinim të MPMS-së dhe akterëve të tjerë, përfshirë agjencitë donatore, të krijohet një program gjithëpërfshirës i trajnimit akademik për trajnimin në punë të Punonjësve Social. Programet duhet të parashohin rritjen e cilësisë dhe shumëllojshmërisë të shërbimeve; mbi trajnimin për punë për t'i rritur kapacitetet ekzistuese të zyrtarëve të shërbimit social tashmë të punësuar në QPS; gjithashtu, zyrtarë të shërbimit social të angazhuar në shoqërinë civile; si dhe studentë të gatshëm të specializohen më tej në tema specifike. Program trajnimi modular me kurrikula të certifikuara dhe të akredituara në specializime të ndryshme të punës me kategori specifike si: Fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët që abuzojnë me substanca, fëmijët viktimë të dhunës seksuale, fëmijët viktimë të dhunës në familje, fëmijët e abuzuar dhe të lënë pas dore, fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët në situatë rruge, fëmijët refugjatë dhe aftësi të tjera specifike të këshillimit si: menaxhimi i çështjeve, bashkëpunimi ndër-institucional për koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, masat parandaluese për fëmijët në rrezik, mekanizmat e identifikimit dhe referimit, këshillimi ligjor, etj.
- d. Meqenëse Zyrtarët e Shërbimit Social shpesh janë të mbi-ngarkuar me punë dhe jo gjithmonë profesionalisht të specializuar për ndërhyrje komplekse, rekomandohet të merret parasysh struktura menaxheriale e personelit QPS-ve dhe metodologjia e menaxhimit të rasteve. Gjithashtu, për një punë më të mirë në ekip profesional, formoni ekipe profesionale të grupeve për fëmijë, familje dhe të moshuar, gjithashtu edhe nënkategori të tjera. Ndryshoni menaxhimin e rasteve komplekse përmes qasjes multidisiplinare dhe kolegjiut të ofruesve të shërbimeve të ekspertëve brenda QMS-ve, si dhe brenda komunës 'Tryezat e Rrumbullakëta Multidisiplinare për Mbështetje në Menaxhimin e Rasteve' siç kërkohet me ligjin e ri për Mbrojtjen e Fëmijëve – *Neni 21*).
- e. Përpjekjet e koordinuara të MPMS-së dhe komunave duhet të planifikojnë rritjen e kapaciteteve të strehimoreve dhe qendrave ditore të kujdesit për kategori të ndryshme të fëmijëve në nevojë. Komunitat më të mëdha duhet të koordinojnë dhe mundësojnë strehimin e fëmijëve nga komunitat më të vogla fqinje (strehimi regional dhe shërbimet e kujdesit ditore ose këshillimit nga ofruesit e OJQ-ve duhet të inkurajohen dhe të mbështeten financiarisht nga komunitat e ndryshme, pavarësisht se ku ndodhet strehimorja). Kjo do t'i mundësojë QPS-së zgjerimin e shërbimeve të strehimit për fëmijët dhe të sigurojë mbrojtje adekuate për kategoritë e fëmijëve në rrezik.
- f. Ofrimi i shembujve të formateve dhe trajnimeve të planifikimit për 'Raportin e Anketimit të Analizës së Nevojave Sociale' pranë autoriteteve komunale dhe planifikimin strategjik dhe planet vjetore të punës - identifikimin dhe shënjestrimin e kategorive dhe shërbimeve të nevojshme. Në veçanti, identifikimin e kategorive të fëmijëve në rrezik dhe burimet e nevojshme për QPS-të në ndërmarrjen e veprimeve të kërkuara dhe sigurimin në kohë të masave parandaluese.

- g. Të merret parasysh rritja e buxhetit për mirëqenien e fëmijëve në përgjithësi dhe për fëmijët në nevojë për shërbime sociale. Zbatimi i formulës së re të propozuar të buxhetimit për mirëqenien sociale në komuna. Sigurimi i udhëzimeve dhe trajnime për buxhetin bazuar në analizën e nevojave shoqërore dhe shërbimet e kërkuara për fëmijët. Kostot për veprimet e QPS-ve në lidhje me masat e mbrojtjes të fëmijëve të jenë të përfshira në planifikimin e ri të buxhetit.
- h. Vendosja dhe mirëmbajtja e mekanizmave funksional të ndryshëm komunal që do të sigurojnë bashkëpunim më intensiv ndërmjet agjencive të institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile përgjegjëse në veprimet e mbrojtjes të fëmijëve. QPS-të duhet të marrin një rol më proaktiv në koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve në nivelin komunal. Në shumicën e rasteve, QPS të duhet të kenë rol udhëheqës në thirrje për takime koordinuese, iniciativa të planifikimit komunal, mbikëqyrjen e shërbimeve të OJQ-ve, komunikimin me media në çështje të ndryshme që lidhen me veprimet e mbrojtjes të fëmijëve dhe të sigurojë përfshirjen dhe veprimet në kohë të akterëve të tjerë përkatës. QPS-ja është e mandatuar ligjërisht për veprime të tilla, por duhet të mbështetet nga komuna me veprime konkrete dhe staf.
- i. Përcaktimi i metodologjisë së monitorimit dhe mjeteve të vetë-vlerësimit brenda strukturave të QPS-ve dhe mekanizmave komunal dhe/ose qendror të cilat do të garantojnë sigurim cilësor të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve të dhëna nga QPS-të dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve. Mbikëqyrja dhe mbështetja nga MPMS dhe drejtoria komunale për mirëqenie sociale në arritjen e standardeve minimale të kujdesit duhet t'u ofrohet QPS-së dhe Zyrtarëve të Shërbimit Social në raste të ndërlikuara.
- j. Ndërtimi i kapaciteteve të QPS-ve për të komunikuar në mënyrë të duhur dhe në kohë me mediat dhe paraqitjet e tjera publike duke siguruar që komuniteti të kuptojë dhe veprojë në favor të identifikimit të hershëm dhe referimit të rasteve që rrezikojnë mirëqenien e fëmijëve, të promovojë masa parandaluese në komunitet, të veprojnë në mënyrë mbrojtëse për përfaqësim të sigurt të fëmijëve dhe familjeve të tyre.
- k. Krijimi i mekanizmave të qarta dhe lehtësisht të qasshme të ankesave për klientët dhe përfaqësuesit e tjerë të fëmijëve dhe ose individ/të pavarur, në mënyrë që t'i paraqesin ankesat dhe sugjerimet e tyre.
- l. Fuqizimi i mekanizmave ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të rinj për mbledhjen gjithëpërfshirëse dhe të veçuar të të dhënave. Gjithashtu, të sigurohet përdorimi i të dhënave për strategji të ndryshme dhe planin e punës të veprimeve, si dhe alokimin e buxhetit dhe burimet njerëzore të nevojshme.

SHTOJCAT

LISTA E TË INTERVISTUARVE NGA QENDRA PËR PUNË SOCIALE			
Nr.	QPS	Embi dhe Mbiemri	Pozita
1	DEÇAN	Islam Mustafaj	Drejtor
2	KLINË	Ilir Bacaj	Drejtor
3	ISTOG	Haki Ibrahimaj	Drejtor
4	GJAKOVË	Dervish Tahiri	Drejtor
5	RAHOVEC	Bilbil Oruçi	Drejtor
6	PRIZREN	Kumrije Bytyqi	UD Drejtorit
7	DRAGASH	Ibrahim Gashi	Drejtor
8	SUHAREKË	Sami Rrakaqi	Drejtor
9	PRISHTINË/QENDRA	Blerim Shabani	U.D. Drejtor
10	DRENASI	Ilmi Dobra	Drejtor
11	FUSHË KOSOVA	Abaz Xhigoli	Drejtor
12	OBILIÇI	Haki Mjeku	Drejtor
13	PODUJEVA	Naim Potoku	UD Drejtor
14	FERIZAJ	Ruzhdi Latifi	UD. Drejtor
15	LIPJAN	Makfirete Shamolli	Drejtor
16	KAÇANIK	Xhelal Gashi	Drejtor
17	HANI I ELEZIT	Amir Bushi	Drejtor
18	SHTIME	Hasan Avdyli	Drejtor
19	SHTERPCË	Jovica Markovic	Drejtor
20	GJILANI	Mursel Zymeri	Drejtor
21	KAMENICA	Rifat Hajdari	Drejtor
22	VITI	Demush Mehmeti	Drejtor
23	RANILLUG	Zoran Ristic	Drejtor
24	MITROVICA J	Gani Mustafa	Drejtor
25	MITROVICA V	Dejan Djinović	Direktor
26	VUSHTRI	Naime Krasniqi	Drejtoreshe
27	SKËNDERAJ	Halim Gecaj	Drejtor
28	LEPOSAVIÇ	Goran Milicevic	Drejtor
29	ZUBIN POTOK	Tatjana Kompirovic	Drejtor
30	GRAÇANICË	Dragan Načić	Koordinator
31	MAMUSHË	Esat Morina	Koordinator
32	JUNIK	Behar Fetaj	Zyrtar I SNS
33	Kodra e trimave PR	Valbona Makiqi	Udhëheqës i ShS
34	B.Diellit PR	Naim Gashi	Udhëheqës i ShS

Pyetësori 1.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Analizimi i nevojave dhe kapaciteteve të qendrave për punë sociale në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Pyetësor i strukturuar për drejtorët e QPS-ve

1. Të dhënat personale të të anketuarit/drejtorit (ose një menaxheri tjetër) nga qendra për punë sociale

- 1.1. Gjinia _____
- 1.2. Edukimi _____
- 1.3. Profesioni _____
- 1.4. Pozita e punës në QPS _____

2. Karakteristikat sociale dhe gjeografike të vetëqeverisjes lokale (komuna) të mbuluara nga QPS

- 1.1. Komuna (emri dhe rajoni):
- 1.2. Numri i banorëve nën juridiksionin e qendrës për punë sociale
- 1.3. Numri i fëmijëve nën juridiksionin e qendrës për punë sociale
- 1.4. Numri i punëtorëve profesional të punësuar në QPS në raport me numrin e banorëve në komunë
- 1.5. Moshë mesatare e popullsisë së komunës, në mes të cilëve:
 - a) Fëmijë nga 0 deri në 18 vjeç
 - b) të rritur deri në 65 vjeç.....
 - c) të moshuar mbi 65 vjeç.....
- 1.6. Karakteristikat ekonomike (zgjidhni një nga përgjigjet)
 - a) kryesisht përmbahen nga bujqësia
 - b) kryesisht të punësuar në aktivitete prodhuese
 - c) kryesisht të punësuar në shërbime
 - d) pjesa më e madhe e popullsisë në moshë pune është e papunë
 - e) diçka tjetër, farë?.....

- 1.7. Numri i vendbanimeve rurale brenda komunës
- 1.8. Karakteristikat gjeografike të komunës:
 a) kryesisht kodrinore
 b) kryesisht e rrafshët
 c) e përzier
- 1.9. Numri i institucioneve dhe organizatave që merren me fëmijët në komunë:
 (specifikoni numrin) ndër të cilat:
 a) shkolla dhe institucione parashkollore dhe institucione të tjera arsimore ...

 b) institucione të kujdesit shëndetësor.....
 c) institucione gjyqësore
- d) institucione të kujdesit shoqëror ndër të cilat:
 a. institucione për fëmijë pa kujdes prindëror
- b. institucione për fëmijë me aftësi të kufizuara.....
 c. institucione për fëmijë me probleme të sjelljes
- d. familje kujdestare/strehuese.....
 e. qendra të kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara.....
- e) organizata joqeveritare që punojnë me dhe për fëmijë dhe bashkëpunojnë me QPS
- f) Organizata e Kryqit të Kuq.....
- g) g) diçka tjetër, çfarë
-
- 1.10. Pasqyrë e shërbimeve sociale për fëmijë për të cilat ka nevojë dhe që ekzistojnë në komunë:

Nr.	Lloji i shërbimit	A Nuk ekzistojnë dhe nuk janë të nevojshme	B Nuk ekzistojnë, por janë të nevojshme	C Ka një shërbim, por nuk mjafton	D Ka një shërbim dhe mjafton
1.	Shërbime këshilluese për fëmijët me probleme të sjelljes dhe prindërit e tyre				
2.	Kujdesi në shtëpi				
3.	Qendra e kujdesit ditor				
4.	Strehim i mbështetur për fëmijët me aftësi të kufizuara ose për fëmijët pa kujdes prindëror (p.sh. komunitete të vogla të konvikteve)				
5.	Shërbime edukative				
6.	Diçka tjetër, çfarë				

2. Infrastruktura, pajisjet teknike dhe logjistike të QPS

- 1.1. Ndërtesa në të cilën funksionon QPS është: *(zgjidhni një nga përgjigjet e ofruara)*
- në pronësi të QPS
 - e marrë nga komuna
 - me qira, me një këst mujor të qirasë në shumën prej Euro / muaj
 - një objekt me qëllim të përkohshëm
 - diçka tjetër, çfarë
- 1.2. Ndërtesa në të cilën QPS operon është vendosur: *(zgjidhni një nga përgjigjet e ofruara)*
- në qendër të komunës
 - në qendrën më të gjerë të komunës
 - larg qendrës së komunës
- 1.3. Ndërtesa në të cilën operon QPS-ja është: *(zgjidhni një nga përgjigjet e ofruara)*
- e pajisur plotësisht teknikisht (instalime të shkëlqyera elektrike dhe hidraulike, kablllo, internet, pajisje kompjuterike dhe video)
 - pjesërisht i pajisur teknikisht - mungon/do të riparohet
 - nuk ka kushte, sepse
- 1.4. Për të kryer punën në terren QPS ka automjete: *(zgjidhni një nga përgjigjet e ofruara)*
- në pronësinë e tij
 - merr me qira automjete për të shkuar në terren
 - nuk ka automjet
 - diçka tjetër, çfarë
- 1.5. Për të punuar me fëmijë dhe familje, QPS ka: *(zgjidhni të gjitha që kanë të bëjnë me QPS-në tuaj)*
- QPS është plotësisht e qasshme për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara
 - QPS është pjesërisht e qasshme për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara (ofrohen ndihma të tilla si një rampë në hyrje të objektit)
 - dhoma të veçanta për seanca psikologjike me fëmijë
 - dhoma të veçanta për seanca psikologjike me çifte/terapi familjare
 - hapësirë/dhomë për aktivitete me fëmijë
 - hapësirë të mjaftueshme për trajnime profesionale për staf
 - diçka tjetër, çfarë

3. Struktura e punonjësve të QPS sipas arsimit, gjinisë dhe moshës

- 3.1. Struktura e punonjësve të QPS lidhur me moshën dhe pozitën profesionale në QPS

4.1. Struktura e punonjësve të QPS sipas moshës dhe pozicionit të tyre të punës në QPS									
Moshë	Pozita e punës në QPS								Gjithsej
	Stafi menaxhues		Zyrtarët e Shërbimeve Sociale		Administrata		Stafi teknik		
	M	F	M	F	M	F	M	F	
Deri në 29 vjeç									
30 - 39									
40 - 49									
50 - 59									
60 - 64									
65+									
GJITHSEJ									

- 3.2. Sa zyrtarë të shërbimeve sociale ka QPS në lidhje me përgatitjen e tyre akademike?
- Punonjës social
 - Psikolog
 - Pedagog
 - Defektolog
 - Sociolog
 - Avokat.....

4. Numri i përgjithshëm dhe lloji i rasteve të shqyrtuara dhe shërbimeve të ofruara nga QPS në vit

- 1.1. Numri i rasteve të shqyrtuara në 2019, ndër të cilat:
- Numri i rasteve në lidhje me fëmijët, ndër të cilat:
 - Numri i rasteve që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara
 - Numri i rasteve që lidhen me fëmijë me probleme të sjelljes.....
 - Numri i rasteve në lidhje me ndihmën sociale - përfituesit e skemave sociale
 - Numri i rasteve që lidhen me njerëz të moshuar
 - Numri i çështjeve të kujdestarisë.....
- 1.2. Përfitimet materiale (financiare) të siguruara
- Ndihma financiare e përhershme
 - Përfitime të rastit të parave të gatshme
 - Ndihma në natyrë (kuzhinë supe, ndihmë për blerjen e druve të zjarrit, ndihmë për energji elektrike dhe ujë, etj.)

- 1.3. Shërbimet e kujdesit social të ofruara
 - 1.3.1. Shërbime të kujdesit ditor.....
 - 1.3.2. Shërbime të kujdesit institucional.....
 - 1.3.3. Kujdestari
 - 1.3.4. Birësim
 - 1.3.5.

5. Kapacitetet profesionale dhe zhvillimi profesional i punonjësve në QPS

- 5.1. Numri i zyrtarëve profesionistë dhe bashkëpunëtorëve të shërbimit social që punojnë me fëmijë dhe të rinj
- 5.2. Sa herë në muaj zyrtari i shërbimeve sociale viziton një familje
- 5.3. Numri i trajnimeve për zyrtarët e shërbimit social të cilët punojnë me fëmijë dhe të rinj gjatë tre viteve të fundit.....
- 5.4. Trajnimi i zyrtarit të shërbimit social i cili është në përmbajtjen e tij ka kryesisht kujdesin për fëmijët (gjendja më e rëndësishme në 3 vitet e fundit)
 - 5.4.1. Programi (titulli i trajnimit)
 - 5.4.2. Kohëzgjatja e trajnimit
 - 5.4.3. Numri i stafit të arsimuar në QPS
- 5.5. Nevoja për forma të tjera të zhvillimit profesional në fushën e të drejtave të fëmijëve:
 - 5.5.1. mbikëqyrja
 - 5.5.2. mentorimi
 - 5.5.3. mbështetje teknike
 - 5.5.4. analizimi/matja e nevojave për trajnime specifike (lloji i trajnimeve të nevojshme)
 - 5.5.5. tjetër

6. Bashkëpunimi i QPS me aktorë të tjerë në komunitet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

- 6.1. A ekziston një bashkëpunim me institucionet dhe organizatat që merren me fëmijët në komunë dhe në çfarë aspekti/mënyre bashkëpunoni me këto institucione? (zgjidhni të gjitha ato të kanë të bëjnë me QPS-në tuaj dhe institucionin e deklaruar)

7.1. Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat që merren me fëmijët dhe aspekti/mënyra e bashkëpunimit		Lloji (aspekti/mënyra) e bashkëpunimit					
Institucioni/organizata Zhvillimi i politikave, përfshirë ngritjen e fushatave		Vlerësimi i nevojave, planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve për fëmijë ose grupe specifike	Zhvillimi profesional, përfshirë trajnimet për stafin	Zhvillimi dhe ndryshimi i kornizës ligjore	Aktivitetet humanitare në komunitet, përfshirë ndihmën humanitare për më të rrezikuarit	Financat, përfshirë ndihmën financiare për përfituesit	
1.	Vetëqeverisja lokale						
2.	Ministria kompetente						
3.	Institucionet arsimore						
4.	Institucionet e kujdesit shëndetësor						
5.	Gjyqësori (gjykatat kompetente)						
6.	Institucionet e kujdesit social						
	6.1. institucione për fëmijë pa kujdes prindëror						
	6.2. institucionet për fëmijët me aftësi të kufizuara						
	6.3. institucione për fëmijë me probleme të sjelljes						
	6.4. familjet kujdestare.						
	6.5. qendrat e kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara						
	6.6. QPS-të tjera						
7.	Prokuroria						
8.	OJQ që punon me dhe për fëmijë						
9.	Kryqi i Kuq						
10.	Media						
11.	Tjetër						

Aktori social (institucioni/ organizata) a) plotësisht i suksesshëm b) kryesisht i suksesshëm		Niveli i kënaqësisë me bashkëpunimin				
		c) nuk e di	d) kryesisht i pasuksesshëm	e) plotësisht i pasuksesshëm		
1.	Vetëqeverisja lokale					
2.	Ministria kompetente					
3.	Institucionet arsimore					
4.	Institucionet e kujdesit shëndetësor					
5.	Gjyqësori (gjykatat kompetente)					
6.	Institucionet e kujdesit social					
6.1.	institucione për fëmijë pa kujdes prindëror					
6.2.	institucionet për fëmijët me aftësi të kufizuara					
6.3.	institucione për fëmijë me probleme të sjelljes					
6.4.	familjet kujdestare.					
6.5.	qendrat e kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara					
6.6.	QPS-të tjera					
7.	Prokuroria					
8.	OJQ që punon me dhe për fëmijë					
9.	Kryqi i Kuq					
10.	Media					
11.	Tjetër					

Nëse ekziston një bashkëpunim me aktorë të ndryshëm shoqërorë (institucione dhe organizata që merren me fëmijë), si mund ta renditni cilësinë e këtij bashkëpunimi? (zgjdhni kolonën përkatëse për institucionin e deklaruar)

5.

**Nevojat për përmirësim të mëtejshëm të QPS në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
(rrethoni të gjitha përgjigjet me të cilat jeni dakord)**

5.1.

Në lidhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, a keni caktuar zyrtar specifik përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve? (rrethoni përgjigjen përkatëse për QPS-në tuaj)

- a) Po
- b) Akoma jo, por është planifikuar
- c) Jo

5.2.

Nëse përgjigjja është "Jo", çfarë konsideroni si arsye kryesore për moscaktimin e zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve? (rrethoni një përgjigje që e konsideroni si më të rëndësishme)

- a) nuk kisha kohë ende për të punuar në këtë aspekt
- b) nuk ka punonjës të mjaftueshëm
- b) nuk ka punonjës të arsimuar si duhet në QPS për këtë pozicion
- c) duhet të pres që Bordi të vendosë për të
- d) tjetër, çfarë

5.3.

Çfarë mendoni se duhet të bëhet për përmirësimin e mëtejshëm të QPS në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve? (rrethoni të gjitha përgjigjet me të cilat jeni dakord)

- a) të rritet numri i të punësuarve në QPS për punë me fëmijë dhe të rinj
- b) të ofrohet një numër më i madh trajnimesh për punonjësit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve
- c) të përmirësohet legjislacioni që rregullon mbrojtjen e fëmijëve
- d) të nxitet bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve socialë për të mirën e fëmijëve
- e) të zhvillohen fushata që përqendrohen në fëmijët dhe të drejtat e tyre
- f) të përmirësohet bashkëpunimi me mediat
- g) tjetër

Faleminderit

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Analizimi i nevojave dhe kapaciteteve të qendrave për punë sociale në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

UDHËZUES

për intervista gjysmë të strukturuar me profesionistë në qendrat për punë sociale (QPS)

mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Intervistë gjysmë e strukturuar, e cila synon të thellojë njohuritë në lidhje me mënyrat aktuale të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në qendrat për punë sociale dhe të mbledh sugjerime për një kuptim më të mirë dhe respektim të plotë të të drejtave të fëmijëve dhe për mbrojtjen e duhur të fëmijëve që janë përdorues të llojeve të ndryshme të shërbimeve për të cilat është përgjegjëse qendra për punë sociale.

HYRJE: arritja e pëlqimit të informuar të të anketuarve. Jepjani të anketuarit një formular për informim dhe për ta nënshkruar pëlqimin, ose regjistruar pëlqimin e tij/saj.

I. Të dhëna personale të të anketuarit/profesionistit nga qendra për punë sociale

1. Profesioni dhe edukimi

1.1. Gjinia _____

1.2. Edukimi _____

1.3. Profesioni _____

1.4. Pozita e punës në QPS _____

2. Përvojë profesionale me rëndësi për të kuptuar mënyrat e organizimit të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në përgjithësi dhe Qendrës për Punë Sociale

- a) Deri në 5 vite
- b) 6 – 10 vite
- c) 11 – 15 vite
- d) 16 – 20 vite
- e) mbi 20 vite

Data, koha dhe vendi i intervistës _____

Intervistuesi _____

II. Mënyrat aktuale të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në qendrën për punë sociale

1. Korniza organizative në qendrën për punë sociale me rëndësi për mbrojtjen e fëmijëve

Cilin shihni si parakusht minimal që duhet të sigurohet në qendrën për punë sociale në mënyrë që të keni kapacitete të mjaftueshme për t'iu përkushtuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve?

- *Pyetjet ndihmëse*
- Cili është mendimi juaj në lidhje me detyrimet e vendosura në Qendrën për Punë Sociale nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve?
- A mund të funksionojë qendra për punë sociale me numrin ekzistues të punëtorëve të kualifikuar dhe me problemet ekzistuese sociale në komunën tuaj? Nëse po, në çfarë mënyre? Nëse jo, çfarë mendoni se do të duhej të përmirësohej?
- Sa i përket kornizës ligjore, çfarë mendoni për kërkesat e deklaruara atje - a po zbatohen si duhet këto kërkesa dhe rregulla?
- A ka QPS një strategji specifike për mbrojtjen e fëmijëve, dokumente përkatëse dhe parakushte të tjera të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve?
- Nëse qendra nuk ka një numër të mjaftueshëm të punëtorëve të kualifikuar, kush e njeh nevojën për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve? Detyrimi i kujt është në qendrën për punë sociale të merret me këto çështje?
- Kush është përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në qendrën tuaj, dhe kush në komunë? Cili duhet të jetë roli i qendrës, cilët janë aktorët e tjerë në komunitetin lokal, cili është roli i familjes, cili është roli i shkollës, cili është roli i mediave? A duhet të marrë pjesë dikush tjetër dhe si?
A keni pasur ju dhe/ose punonjësit tuaj ndonjë vizitë studimore në një vend tjetër për të parë praktikat më të mira në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve? Çfarë mendoni për mundësinë për të mësuar në përvojat dhe praktikat e mira të tjerëve? A mund të jenë ato përvoja dhe praktika të zbatueshme në komunitetin tuaj?

2. Kompetencat profesionale të punonjësve në QPS për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Si i vlerësoni njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet ekzistuese të profesionistëve në qendrën për punë sociale në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?

- *Pyetjet ndihmëse:*
- Si e konsideroni rolin e QPS-së në politikat dhe masat e mbrojtjes së fëmijëve, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve?
- A janë profesionistët e QPS-ve, sipas mendimit tuaj, të trajnuar mjaftueshëm për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve?
- Nëse vlerësoni se ka nevojë për të përmirësuar kompetencat e tyre në fushën e të drejtave të fëmijëve, çfarë mendoni se do të ishte më mirë të organizohej?
- A keni pasur ju dhe kolegët tuaj trajnime specifike për mbrojtjen e fëmijëve? Nëse po, a kanë qenë brenda apo jashtë vendit?
- A ka trajnime të mjaftueshme profesionale për mbrojtje të fëmijëve? Nëse jo, çfarë mendoni e kush duhet të organizojë edukimin, trajnimin, seminarët profesionale....?
- A mendoni se ka kuptim të mjaftueshëm për rëndësinë e të drejtave të fëmijëve në mesin e punëtorëve profesionistë, dhe cilat janë qëndrimet e punëtorëve të aftë për të drejtat e fëmijëve dhe respektimin e tyre?

A ka nevojë për të punuar në ndryshimin e qëndrimeve të punonjësve në qendrat për punë sociale me temën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe në çfarë mënyre do të ishte mirë të organizoheshin këto aktivitete?

3. Bashkëpunimi në komunitetin lokal në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

A bashkëpunon qendra për punë sociale me aktorë të tjerë socialë në komunitet në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe në çfarë mënyre?

- *Pyetjet ndihmëse:*
- *Kush, sipas mendimit tuaj, është veçanërisht përgjegjës në komunë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?*
- *Si bashkëpunon qendra për punë sociale me aktorë të tjerë socialë në komunitet në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (me gjyqësorin, me institucionet arsimore, me institucionet e kujdesit shëndetësor, me policinë ...) dhe si e vlerësoni këtë bashkëpunim?*
- *Me kë është e nevojshme të vendoset një bashkëpunim i mirë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
Çfarë duhet të bëhet tjetër që të drejtat e fëmijëve të njihen si të rëndësishme dhe t'i kushtohet më shumë vëmendje mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve?*

4. Rregullimi normativ i promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Çfarë, sipas mendimit tuaj, është e rregulluar mirë, dhe çfarë mungon/jo e rregulluar mirë në mënyrën ekzistuese të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve?

- *Pyetjet ndihmëse*
- *Cilat janë problemet/pengesat kryesore në sistemin e mirëqenies sociale për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?*
- *Dhe çfarë në sistemet e tjera (arsimi, gjyqësori, shëndetësia, media)...?*

Çfarë mendoni se do të kontribuonte në tejkalimin e këtyre problemeve?

III. Vërejtje përmbyllëse

A ka ndonjë gjë që dëshironi të nënvizoni? A kemi harruar të ju pyesim ndonjë gjë që e konsideroni si shumë të rëndësishme për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve? A keni ndonjë pyetje për ne?

Për përfundimin e përshtypjes, le të imagjinojmë: nëse do të kemi mundësinë të pyesim familjet, përdoruesit dhe anëtarët e ndryshëm të komunitetit për punën e qendrës tuaj për punë sociale në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, çfarë mendoni se do të vlerësonin dhe çfarë nuk do e vlerësonin? Dhe për çfarë jeni veçanërisht kënaqur, me çfarë jeni veçanërisht të kënaqur në lidhje me të drejtat e fëmijëve në komunitetin tuaj?

Shprehni mirënjohje për pjesëmarrjen në intervistë, merrni kontaktin dhe ofroni informacione të mëtejshme nëse i anketuari shpreh interes për rrjedhën e mëtejshme dhe rezultatet e hulumtimit.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Analizimi i nevojave dhe kapaciteteve të qendrave për punë sociale në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

UDHEZUES

për një intervistë gjysmë të strukturuar me profesionistë në qendrat e punës sociale (QPS)
mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Intervistë gjysmë e strukturuar, e cila synon të thellojë njohuritë në lidhje me mënyrat aktuale të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në komunë dhe për të mbledhur sugjerime për një kuptim më të mirë dhe respektimin e plotë të të drejtave të fëmijëve nga të gjithë aktorët socialë në komunë

HYRJE: arritja e pëlqimit të informuar të të anketuarve. Jepjani të anketuarit një formular për të informuar dhe nënshkruar pëlqimin, ose regjistroni pëlqimin e tij/saj.

I. Të dhënat personale të të anketuarit/profesionistit nga komuna

1. Profesioni dhe arsimi

1.1. Gjinia

1.2. Edukimi

1.3. Profesioni

1.4. Pozita i punës në komunë

2. Përvojë profesionale me rëndësi për të kuptuar mënyrat e organizimit të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

- a) deri në 5 vite
- b) 6 – 10 vite
- c) 11 – 15 vite
- d) 16 – 20 vite
- e) më shumë se 20 vite

Data, koha dhe vendi i intervistës _____

Intervistuesi _____

II. Mënyrat aktuale të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në komunë;

1. Kuadri organizativ në komunën me rëndësi për mbrojtjen e fëmijëve

Cilin e shihni si një parakusht minimal që duhet të sigurohet në komunë në mënyrë që të keni kapacitete të mjaftueshme për t'iu përkushtuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve?

- *Pyetjet ndihmëse*
- Cilat mendoni se janë përgjegjësitë më të rëndësishme të departamenteve komunale në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
- A ka komuna një strukturë të përshtatshme organizative dhe a mund të funksionojë me numrin ekzistues të profesionistëve në komunën tuaj? Nëse po, në çfarë mënyre? Nëse jo, çfarë mendoni se do të duhej të përmirësohej?
- Detyrimi i kujt në komunë është të merret me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
- Në lidhje me nenin 14 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, nëse komuna ka filluar të ndërmarrë hapat e nevojshëm për: identifikimin e nevojave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve; përgatitja e planit vjetor duke përfshirë fondet për zhvillimin, qëndrueshmërinë dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve?
Si duhet të ndahet përgjegjësia për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivelin komunal? Cili duhet të jetë roli i qendrës për punë sociale, cili është roli i familjeve dhe të gjithë qytetarëve, cili është roli i shkollës, cili është roli i mediave? A duhet të marrë pjesë dikush tjetër dhe si?

2. Kompetencat profesionale të punonjësve në komunë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Si i vlerësoni njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet ekzistuese të profesionistëve në komunë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?

- *Pyetjet ndihmëse;*
- A janë profesionistë të komunës, sipas mendimit tuaj, të trajnuar mjaftueshëm për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve?
- Nëse vlerësoni se ka nevojë për të përmirësuar kompetencat e tyre në fushën e të drejtave të fëmijëve, çfarë mendoni se do të ishte më e mira për t'u organizuar?
- Kush duhet të organizojë arsim profesional, trajnime, seminare ...?
- A mendoni se ka kuptim të mjaftueshëm për rëndësinë e të drejtave të fëmijëve në mesin e punëtorëve profesionistë, dhe cilat janë qëndrimet e punëtorëve të aftë për të drejtat e fëmijëve dhe respektimin e tyre?

A ka nevojë për të punuar në ndryshimin e qëndrimeve të punonjësve në komunë në temën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe në çfarë mënyre do të ishte mirë të organizohen këto aktivitete?

3. Bashkëpunimi në komunitetin lokal në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Nëse dhe si komuniteti bashkëpunon me të gjithë aktorët socialë në komunitet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?

- Pyetjet ndihmëse;
- Kush, sipas mendimit tuaj, është veçanërisht përgjegjës në komunë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
- A ka komuna ndonjë strategji/plan për mbrojtjen e fëmijëve?
- Si bashkëpunon komuna me aktorët e tjerë socialë në komunitet në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (me gjyqësorin, me institucionet arsimore, me institucionet e kujdesit shëndetësor, me policinë ...) dhe si e vlerësoni këtë bashkëpunim?
- Me kë është e nevojshme të vendoset një bashkëpunim i mirë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
- A keni pasur ndonjë trajnim specifik ju dhe kolegët tuaj në komunë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve? Nëse po, nga kush? Nëse jo, a keni kërkuar ndonjëherë trajnim në një fushë specifike?
Çfarë duhet bërë që të drejtat e fëmijëve të njihen si të rëndësishme në mënyrë që t'i kushtohet më shumë vëmendje mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve?

4. Rregullimi normativ i promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Çfarë, sipas mendimit tuaj, është e rregulluar mirë, dhe çfarë mungon/jo e rregulluar mirë në mënyrën ekzistuese të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve?

- Pyetjet ndihmëse;
- Cilat janë problemet/pengesat kryesore në komunë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?
- Dhe cilat janë problemet në sisteme të ndryshme (arsimi, gjyqësori, shëndetësia, media) ...?
Çfarë mendoni se do të kontribuonte në tejkalimin e këtyre problemeve?

III. Vërejtje përmbyllëse

A ka ndonjë gjë që dëshironi të nënvizoni? A kemi harruar të ju pyesim ndonjë gjë që e konsideroni si shumë të rëndësishme për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve? A keni ndonjë pyetje për ne?

Nëse do të kishim mundësinë të pyesim qytetarët ose disa përfaqësues të organizatave dhe institucioneve në lidhje me aktivitetet e komunës suaj në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, çfarë mendoni se do të vlerësonin ata dhe me çfarë do të tërhiqeshin? Dhe për çfarë jeni veçanërisht krenar, me çfarë jeni veçanërisht të kënaqur në lidhje me të drejtat e fëmijëve në komunitetin tuaj?

Shprehni mirënjohje për pjesëmarrjen në intervistë, merrni kontakt dhe ofroni informacione të mëtejshme nëse i anketuari shpreh interes për rrjedhën e mëtejshme dhe rezultatet e hulumtimit

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Analizimi i nevojave dhe kapaciteteve të qendrave për punë sociale në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Fletëpëlqim për pjesëmarrje në hulumtim

Qëllimi i projektit: Projekti “Avancimi i kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve”- është një projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, i zbatuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë në partneritet me Handikos. Qëllimi i projektit është të kryejë një analizë të nevojave të kapaciteteve të Qendrave të Punës Sociale në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe të nxjerrë konkluzione, të bëjë rekomandime dhe të theksojë mësimet e marra për strategjinë e ardhshme dhe përmirësimet në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Hulumtuesi: Emri im ështëdhe unë jam
 [vendosni dy fjali për secilin hulumtues]

Për ndonjë pyetje ose shqetësim mund të më kontaktoni mua dhe/ose një anëtar të ekipit tim në: SOS, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë.

Përfitimet e të qenit pjesë e këtij projekti: Ajo që ne do të mësojmë në këtë projekt nga ju dhe kolegët tuaj do të përdoret për planifikimin e kapaciteteve ekzistuese për të gjithë aktorët socialë, por kryesisht për qendrat për punë sociale në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, për të kuptuar më mirë pozicionin aktual dhe për të krijuar rekomandime për përmirësimin e ardhshëm të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë.

Procedura: Pjesëmarrja do të përfshijë përfshirjen në aktivitete intervistuese brenda një dite.

Të gjitha rreziqet dhe shqetësimet e parashikueshme: Disa pyetje mund të shkaktojnë shqetësime nëse rastësisht reflektoni në një kujtesë të pakëndshme. Nëse ndiheni jo rehat në çdo moment në kohë mund të zgjidhni të mos i përgjigjeni një pyetjeje kërkimore dhe/ose të ndërprisni pjesëmarrjen tuaj përkohësisht ose përgjithmonë. Ju gjithashtu mund të zgjidhni të kërkoni që të gjitha përgjigjet tuaja të mëparshme të mos përdoren në projekt. Nëse jeni nxitur dhe/ose dëshironi, mbështetjen e mëtejshme ne do t’ju ofrojmë informacionin e kontaktit për shërbimet e mbështetjes dhe do kujdesemi që ju të gjeni mbështetjen.

Konfidencialiteti: Konfidencialiteti juaj do të ruhet dhe emri juaj nuk do të përmendet në këtë projekt kërkimor nëse nuk doni të përmendet. Nëse keni ndonjë shqetësim pas pjesëmarrjes tuaj, mund të kërkoni të rishikoni shënimet nga diskutimet tona. Pjesëmarrja juaj është vullnetare. Ju keni të drejtë të tërhiqeni në çdo kohë pa ndonjë pasojë. Nëse ndani ndonjë gjë që do e vë veten tuaj ose të afërmit tuaj në ndonjë rrezik ne do të punojmë së bashku për të vazhduar më tej për të gjetur mbështetje dhe për të raportuar situatën.

Kohëzgjatja e përfshirjes: Ju kërkohet të kontribuoni 0,5 ditë për aktivitetet.

Incizimi dhe transkriptimi: Diskutimi ynë do të incizohet dhe shkruhet.

Marrëveshja: Ju lutemi nënshkruani këtë formë për miratimin tuaj.

Emri i Pjesëmarrësit (ju lutemi me shkronja shtypi)

Nënshkrimi i Pjesëmarrësit

Data

Organet qeveritare që punojnë në ushtrimin e të drejtave të fëmijëve³⁹

Me "organ qeveritar" nënkuptohet mekanizmi i vendosur nga qeveria për të shqyrtuar ose vendosur çështjet, të cilat Qeveria i vendos nën kompetencat e organeve qeveritare. Qeveria gjithashtu përcakton përbërjen dhe mandatin e një organi qeveritar me vendim për krijimin e këtij organi. Në aspektin e krijimit të Organeve Qeveritare, dhe të cilat kryesisht kanë mandat të punojnë në ushtrimin e plotë të të drejtave të fëmijëve, kanë ndodhur disa përparime shumë të rëndësishme, duke bërë të mundur në këtë mënyrë krijimin e disa mekanizmave të tillë, të tilla si: a) Komiteti Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve, (b) Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda dhe të Rrezikshme të Fëmijëve, (c) Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, (d) Këshilli për Mbrojtjen dhe Drejtësinë e Fëmijëve, (e) Komiteti Kosovar për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës, (f) Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, (g) Komitetet Lokale të Veprimit për Monitorimin e Punës së Fëmijëve, (h) Grupet Qeveritare të Punës në institucionet e Republikës së Kosovës.

A. Komiteti Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve

Në kuadër dhe me qëllim të mbrojtjes dhe nxitjes së të drejtave të fëmijëve në Kosovë, si dhe vendosjen e fëmijës në fokusin e përpjekjeve të Qeverisë, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 03.12.2008 nxori Vendimin nr. 07/46 për të krijuar Komitetin Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve. Ky komitet është gjithashtu organi më i lartë qeveritar brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Komiteti Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe në përbërjen e tij përfaqësohet në nivelin e Ministrave, nga ministrinë më të rëndësishme. Gjithashtu, Shefi i Zyrës së UNICEF në Kosovë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile janë pjesë integrale e Komitetit. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë shërben si Sekretariati i Komitetit. Ndërsa, Komiteti parashikohet të takohet dy herë në vit. Përgjegjësitë e Komitetit Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve janë: të analizojë dhe të mbajë të informuar anëtarët e aktiviteteve ekzistuese, rregullorëve, ligjeve, programeve të ministrive dhe organeve të tjera në lidhje me çështjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë; për të ndarë të dhënat, raportet dhe dokumentet e tjera përkatëse në fushën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë; mban kontakte dhe bashkëpunon ngushtë me organizatat që përfaqësojnë fëmijët dhe me faktorë të tjerë të rëndësishëm në fushën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë; analizon rregullisht çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijëve dhe të drejtat e tyre; harton raportin vjetor për gjendjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë; përcakton përparësitë dhe masat e nevojshme që duhet të ndërmerren për të përmirësuar situatën aktuale në lidhje me të drejtat e fëmijëve në secilën Ministri; lehtëson dhe monitoron zbatimin e politikave, programeve dhe masave të tjera të miratuara që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve; krijon grupe të nevojshme pune për çështjen e të drejtave të fëmijëve; ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informacionit publik dhe përpjekjeve të tjera dhe projekteve promovuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi standardet e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu janë përgjegjës për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit brenda ministrive dhe të sigurohet që këshillat, rekomandimet dhe masat e tjera që burojnë nga Komiteti Ndërmnistror, të kenë ardhur në Ministri ose zyrën përkatëse.

B. Komisioni për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda dhe të Rrezikshme të Fëmijëve

Për të vendosur politika dhe përparësi programore për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës, për të monitoruar situatën e punës së fëmijëve në vend, si dhe për të koordinuar të gjitha marrëveshjet e nevojshme, Qeveria e Republikës së Kosovës më 12 shtator 2005 me Vendimin nr. 5/166 ka themeluar Komitetin e Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve. Ndërsa, me Vendimin 04/37, me datë 15.09.2011, Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton fushën e veprimit, përbërjen dhe funksionimin e Komitetit. Ky Organ Qeveritar drejtohet nga Ministri i MPMS-së dhe në përbërjen e tij ka përfaqësues të institucioneve më relevante qeveritare dhe joqeveritare, të cilët përfaqësohen në nivelin e Drejtorëve ose Shefave të Divizioneve. Ndërsa, Njësia e Punës në ISP në MPMS, luan rolin e Sekretariatit të Komitetit. Ky organ vendimmarrës parashikohet

39 Përmbledhje e ligjeve që mbrojnë të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës.. Autore: Qëndresa Ibra-Zariqi Janar 2012 http://tdh-europe.org/upload/document/5123/1411_Summary_Of_Laws_That_Protect_Children_original.pdf

të takohet të paktën katër herë në vit. Funkcionet kryesore të Komitetit janë: të japë udhëzime mbi politikat dhe programet që synojnë eliminimin e punës së fëmijëve dhe të përcaktojnë fushat me përparësi më të lartë për programet e drejtpërdrejta që synojnë tërheqjen e menjëhershme të fëmijëve të përfshirë në format më të rrezikshme të punës dhe parandalimin e përfshirjes të fëmijëve në rrezik; për të monitoruar situatën e punës së fëmijëve në vend dhe koordinon veprimet kundër saj; të bëjë propozime për të modifikuar dhe kompletuar legjislacionin për eliminimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve; të kërkojë mbështetjen e nevojshme nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë, veçanërisht nga Programi Ndërkombëtar i ILO për Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe të sigurojë integrimin e ndërhyrjes së suksesshme në angazhimet qeveritare për luftimin e punës së fëmijëve; të mbështesë Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e tjera të ngarkuara për përmbushjen e objektivave dhe synimeve të përcaktuara nga standardet dhe konventat e BE-së dhe ILO-s në fushën e punës së fëmijëve.

C. Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara

Për të përfaqësuar interesat e personave me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar hapësirën e tyre për të qenë pjesë aktive në procesin e hartimit të politikave që ndikojnë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 07.09.2001 nxori një vendim nr. 04/36 për krijimin e Këshillit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ky Organ Qeveritar drejtohet nga Zëvendës Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe në përbërjen e tij ka Zëvendës Ministra të pesë ministrive më të rëndësishme. Një rol të rëndësishëm në përbërjen e Këshillit kanë edhe tetë përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët në mënyrë aktive punojnë në ushtrimin plotësisht të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ndërsa ZQM/ZKM shërben si Sekretariati i Këshillit. Ky organ qeveritar ka një mandat të punojë në sigurimin e mundësive të barabarta, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara. Për të siguruar që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara merren gjithmonë në konsideratë kur Qeveria nxjerr vendime për diçka që ndikon në situatën e personave me aftësi të kufizuara. Rekomandimet e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar do të jenë në përputhje me Rregullat Standarde të Kombeve të Bashkuara për Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut.

D. Këshilli për Mbrojtjen dhe Drejtësinë për Fëmijët

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të përcaktojë përparësitë dhe masat e nevojshme që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës aktuale në lidhje me Mbrojtjen e fëmijëve në pikëpamje drejt Mbrojtjes dhe Drejtësisë së Fëmijëve, më 25 gusht 2011 mori Vendimin (nr. 09/34) për të krijuar "Këshillin për Mbrojtjen dhe Drejtësinë e Fëmijëve. Këshilli, në përputhje me Vendimin për themelimin, përbëhet nga: Kryetari, dy Nënkrjetarë, tetëmbëdhjetë (18) anëtarë; Në cilësinë e anëtarëve Konsulentët e Jashtëm janë dy anëtarë që vijnë nga Zyra e UNICEF në Kosovë, ndërsa në cilësinë e anëtarëve si Vëzhgues janë katër anëtarë që përfaqësojnë institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës, siç janë Ombudspersoni dhe OJQ-të si koalicion i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve dhe Terres des Homes. ZQM/ZKM shërben si Sekretariati i Këshillit, për të koordinuar, monitoruar, zhvilluar dhe mirëmbajtur aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit. Mandati dhe përgjegjësitë e Këshillit janë si më poshtë; Përcaktimi i përparësive dhe masave të nevojshme që duhet të ndërmerren për të përmirësuar situatën aktuale në lidhje me mbrojtjen dhe drejtësinë e fëmijëve; Lehtësimi dhe monitorimi i zbatimit të politikave, programeve dhe masave të tjera të miratuara që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe drejtësinë e fëmijëve në nivelin qendror dhe lokal; Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave dhe legjislacionit në zhvillim që kanë të bëjnë me përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe drejtësisë për fëmijët.

E. Komiteti Kosovar për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës

Bazuar në treguesit e lartë të vdekshmërisë për nënat dhe fëmijët, si dhe duke u nisur nga shumë pakënaqësi në fushën e shëndetit të nënave dhe fëmijëve në Kosovë, Ministri i Shëndetësisë më 15.05.2003 nxjerr Vendimin për krijimin e Komitetit Kosovar për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës.

Ky organ multidisiplinar qeveritar është i përbërë nga ekspertë të fushave përkatëse në fushën e shëndetësisë.. Gjithashtu, në përbërjen e tij ka përfaqësues të OBSH, UNICEF dhe UNFPA. Koordinimi i përpjekjeve dhe burimeve përkatëse, profesionale dhe shkencore për të përmirësuar dhe ulur vdekshmërinë në atë kategori të asaj popullsie, si dhe rritjen e cilësisë së shëndetit ndaj fëmijëve dhe nënave.

F. Koordinator Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore

Zëvendës Ministri i Punëve të Brendshme të Grupit Punues me Vendimin e Kryeministrit (nr. 029) të datës 10.04.2008 u emërua Koordinator Kombëtar kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore. Mandati i Koordinatorit është të koordinojë, monitorojë dhe raportojë mbi zbatimin e politikave kundër trafikimit me qenie njerëzore, si dhe të drejtojë takime me grupe pune ndër-ministore.. Ndërsa, Grupi i Punës, është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve më relevante dhe kryesisht kanë mandatin për të koordinuar zbatimin e politikave, për të monitoruar dhe raportuar mbi arritjet, në institucionet që përfaqësojnë.

G. Komitetet lokale të veprimit për monitorimin e punës së fëmijëve.

Në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës është themeluar Komiteti Lokal i Veprimit. Komitetet përbëhen nga zyrtarë të lartë të autoriteteve lokale, përfaqësues të sindikatave të pavarura të Kosovës si dhe përfaqësues të OJQ-ve lokale që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve.. Ky organ institucional drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në komunat përkatëse.. Mandati i Komiteteve është që të zbatojnë drejtpërdrejt politikat dhe prioritetet e programit për; Mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje, mbrojtja e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës, për të monitoruar situatën e punës së fëmijëve, si dhe për të ofruar rekomandime për përmirësimin e politikave që kanë të bëjnë me Eliminimin e Punës së Fëmijëve.

H. Grupet Qeveritare të Punës në institucionet e Republikës së Kosovës.

Në nivelin qendror dhe lokal janë vendosur "Grupe të tjera pune" të ndryshme që merren me lehtësimin e ushtrimit të të drejtave të fëmijëve, të tilla si: Grupi i Punës për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve; Grupi Punues për hartimin e Raportit Shtetëror për Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës dhe përmbushjen e detyrimeve, të cilat adresohen nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve në KB. Grupi punues për trajtimin e braktisjes së shkollës nga studentët; Grupi Punues për rishikimin e listës për Format e Rrezikshme të Punës së Fëmijëve; Grupi Këshillëdhënës për arsimin parashkollor; Grupi i punës për parandalimin e dhunës në arsimin parauniversitar; Tryeza të rrumbullakëta multidisiplinare për mbështetje në menaxhimin e çështjeve.

Lista e referencave

- Government of Kosovo. (2013). Direction Administrative (MPMS) No.13 / 2013 on Licensing of Providers of Services Social and Family. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10351>
- Government of Kosovo. (2008). Administrative Instruction (MLSW) no. 17/2008 on the prevention and elimination of hazardous labor for children in Kosovo : In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7650>
- Government of Kosovo. (2013). Strategy for Decentralization of Social Services 2013-2020. Pristina: National Advisory Commission for Decentralization of Social Services.
- Kosovo. (2012). Law no. 04 / L -081 on Amending and Supplementing the Law no. 02 / L-17 for Services Social and Family , In available at : <https://mpms.rks-gov.net/linqe/legjislacioni/>
- Kosovo. (2012). Law no. 06 / L-084 Law for the protection of the child, Newspaper official of Kosovo / No. 14/17 July 2019 Pristina. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>
- Kosovo. (2008). Law on Local Self- Government, no. 03 / I-040. Official Gazette of Kosovo / year III / no. 28/04 June Prishtina. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>
- Kosovo. (2008). Law on Finance and Government Local, no. 03 / L-049. Official Gazette of Kosovo / year III / no. 27/03 June Prishtina. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2525>
- Kosovo. (2008). Constitution of Kosovo
- Kosovo. (2006). Law on Family of Kosovo no. 2004/32. Official Gazette of Kosovo
- Kosovo. Law no. 2003/15 on the Social Assistance Scheme in Kosovo and Law no. 04 / L-096 on amending and supplementing the Law on social assistance scheme. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2460>
- Kosovo. Code no. 06 / L-074 Criminal Code of Kosovo. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>
- Kosovo. Law no. 03 / L -212 of work. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>
- Kosovo. Law no. 04 / L -032 on Pre- University Education. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>
- Kosovo. Law no. 04 / L-161 on Occupational Safety and Health. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>
- Kosovo. Code no. 06 / L -006 Juvenile Justice Code. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18019>
- Kosovo. Law no. 04 / L-218 on Preventing and Combating Trafficking in Human Beings and Protecting Victims of Trafficking. In available at : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8875>
- Kosovo. (2019). Program for the implementation of the law for the protection of the child 2019-2021, <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/plani%20i%20veprimit%20shq.pdf>

- Ministry of Labor and Social Welfare. Department of Social and Family Policy. Concept Paper on Services Social and Family. (2019): In available at : http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/05/shq-Koncept-Dokumenti-per-Sherbimet-Sociale-dhe-Familjare-_compressed.pdf
- Ministry of Finance. (2019) Concept Paper for the finances of government local. In Available at : <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40447>
- Ministry of Labor and Social Welfare. (2014). Sector Strategy 2014-2020. Prishtina. Ministry of Labor and Social Welfare. (2014). Plan of Action 2014-2016 for the Strategy Sector 2014-2020. Prishtina
- Ministry of Labor and Social Welfare(nd). Standards Minimum of Quality for Providers of Services Social. Prishtina
- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation. Plan Strategy of Education in Kosovo. (2016), Prishtina. In available at : http://www.kryeministriks.net/repository/docs/plani_strategjik_i_arsimit_ne_kosove.pdf
- Context legal and tax as and capacity of providers of services social in Kosovo, Save the Children in Kosovo Center European for research and politics of welfare social (2018). In dispositions : <https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/SHQ%20Analiza%20e%20Situates.pdf>
- Agency of Statistics of Kosovo (2019). Statistics of Welfare Social 2019. Prishtina: Agency of Statistics of Kosovo . In available at : <https://ask.rks-gov.net/media/5336/statistikat-e-mirëqenies-sociale-tm4-2019.pdf>
- [Avdiu . Nature . 2014. Analysis of the situation of children on the move in Kosovo . At your disposal :](#)
- Coalition of NGO ve for the Protection of Children (KOMF) (2017). Financing of Social Services in Kosovo . Prishtina : KOMF. In available at : <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2017/05/Financimi-i-sherbimeve-sociale.pdf>
- Coalition of NGO ve for the Protection of Children (KOMF) (2020). Report to influence the process of decentralization of services social in Kosovo . Prishtina : KOMF. In available at : <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-i-decentralizimit.pdf>
- Coalition of NGO s for the Protection of Children . (2016). Index of Protection of Children . Prishtina : KOMF. In available at : <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2018/01/Raporti-shqip.pdf>
- Coalition of NGO s for the Protection of Children . (2016). Do you manage the money of taxpayers to children in need ? Analysis of the short budget on the policies social for the protection of children in Kosovo . Prishtina : KOMF. In available at : <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/02/Analiza-Buxhetore.pdf>
- Dr. E. Tahiraj , the future of children our : mapping of protection social in Kosovo , UNICEF, February 2016
- Ministry of Education , Science , Technology and Innovation , Report on the contribution of MEST in the implementation of Policies for Prevention and Prohibition of Dangerous Forms of Child Labor in Kosovo, November, 2019.
- UNICEF, Analysis of the situation of children and women in Kosovo " October , 2017

Financuar nga:



Implementuar nga:

